



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 26 NËNTOR dhe 3 DHJETOR 2009

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
26. NOVEMBRA i 3. DECEMBRA 2009. GODINE

NËNTOR – NOVEMBRA
2009

Seancën e kryesoi, **Xhavit HALITI**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

I nderuar Kryeministër, zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 63 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për punë.

Ju njoftoj se pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit i ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Para se t'ia fillojmë me rendin e ditës, në emër të Grupit Joformal të Grave të Kuvendit është kërkuar që të lexohet një deklaratë që ka të bëjë me dhunën kundër gruas në Kosovë.

Zonja Flora e ka fjalën.

FLORA BROVINA: Faleminderit, kryesues!

Përhëndetje, zoti Kryeministër, zëvendëskryeministra,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë dhe kolege,

Në emër të Grupit Joformal të Grave të Kuvendit, propozoj Rezolutën për nxjerrjen e Ligjit kundër dhunës në familje. Ne përfaqësueset e zgjedhura të Republikës së Kosovës konsiderojmë se dhuna në familje është një fenomen i papranueshëm për shoqërinë tonë. Kërkojmë që ky fenomen negativ të luftohet me përkushtim dhe atë menjëherë.

Synimi ndaj proceseve të integritimeve euroatlantike na obligon që të përmbushim edhe detyrën ndaj viktimave të dhunës në familje. Pranojmë se ka nevojë urgjente që t'i fuqizojmë mekanizmat që do të trajtojnë dhunën në familje, në mënyrë që të ofrohet përkrahje e vazhdueshme dhe bazë e nevojshme ligjore për parandalimin, ndjekjen ligjore, mbrojtjen dhe përkrahjen e viktimave të dhunës, më shumë se që është bërë deri më tani.

Për këtë propozojmë rezolutë që fton nxjerrjen e Ligjit kundër dhunës në familje. Familja kosovare dhe qytetarët tanë meritojnë këtë dinjitet.

Në emër të Grupit Parlamentar të Grave. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

Mendoj që për një çështje të tillë për rezolutë dihen rregullat që janë sipas Rregullores së Punës së Kuvendit dhe besoj që Kuvendi nuk ka asgjë kundër për nxjerrjen e një rezolute të tillë.

Atëherë, fillojmë me të vetmen pikë të rendit të ditës, që është:

- **Debat për Raportin e Komisionit Evropian për Progresin në Kosovë për vitin 2009, sipas kërkesës së Komisionit për Integritime Evropiane dhe të Grupit Parlamentar të LDD-së**

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës së Kuvendit, ka kërkuar nga Kryesia e Kuvendit, që në seancë plenare të debatohet për Raportin e Komisionit Evropian për Progresin në Kosovë për

vitin 2009. Komisioni për Integrime Evropiane ka rekomanduar që të diskutohet në seancë plenare Raporti i Komisionit Evropian për Progresin në Kosovë për vitin 2009, si dhe ka proceduar për shqyrtim dhe miratim në Kuvend, Propozim- planin e veprimit të Kuvendit për integrim evropian.

Kryesia e Kuvendit, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës së Kuvendit, i ka proceduar kërkesat në fjalë. Materialet u janë shpërndarë deputetëve.

Ftoj përfaqësuesin e LDD-së, Lulzim Zenelin, që ta marrë fjalën lidhur me debatin në fjalë.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zotëri kryesues!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Duke cilësuar se Raporti i Progresit të Komisionit Evropian është parametër i rëndësishëm për të kuptuar dhe për të pasqyruar nivelin e progresit të institucioneve të Kosovës në procesin e integrimeve Evropiane, Grupi Parlamentar i LDD-së ka kërkuar debat parlamentar për këtë temë, duke konsideruar të domosdoshëm që Kuvendi i Kosovës, si organi më i lartë përfaqësues të reflektojë përgjegjësinë e vet në koherencë me nevojën që shtron procesi politik.

Të nderuar deputetë,

Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2009, vlerëson se nga viti i kaluar deri në shtator të këtij viti në Kosovë janë shënuar ngecje të mëdha, trendë negativ dhe përkeqësim të gjendjes në fushat kryesore që identifikojnë frymëmarrjen e funksionimit të shtetit dhe demokracisë. Për aq kohë sa ne dimë se Kosova ka filluar të vlerësohet nga ana e Bashkimit Evropian me anë të Progres raportit, asnjëherë nuk ka ndodhur të hartohet një raport i tillë me kaq nivel të madh të kritikës për punën e institucioneve në vend, duke i përdorur sektorët secilën veç e veç. Dhe, kjo nuk si të përkufizohet ndryshe, përveç se Kosova ka marrë një regres- raport, që tregon për gjendjen reale në të cilën gjendet Kosova dhe për qeverisjen e keqe që është instaluar nga partnerët e koalicionit aktual. Duke ditur se ky raport reflekton vlerësime të cilët janë bazuar në parametra matës të verifikuar dhe këto vlerësime ndikojnë drejtpërdrejt në imazhin e përgjithshëm të Kosovës në botë, atëherë themi se ky raport paraqet një njollë të zezë për Kosovën.

Dhe, këtu nuk është faji i qytetarëve të Kosovës, zotërinj qeveritarë, është faji juaj që në këto vite nuk arritët ta ruanit dhe ta zhvillonit shkallën e demokracisë në vend. Pra, nuk arritët ta ruani dhe të garantoni lirinë e shprehjes së mediave, nuk krijuat kushte dhe premisa për një gjyqësor të pavarur dhe efikas dhe nuk bëtë punën më të vogël për të luftuar të keqën më të madhe në vend, korrupsionin.

Në vitin 2006 Kosova kishte bërë progres në përmbushjen e obligimeve të saja ndërkombëtare dhe atyre regjionale, por që nga atëherë progresi është ndalur. Në fushën e demokracisë dhe sundimit të ligjit, situata në Kosovë është përkeqësuar nga viti 2007. Raporti nënvizon probleme rreth implementimit të ligjeve, probleme rreth pavarësisë së institucioneve nga influenca e ashpër e Qeverisë dhe për mungesën e kapaciteteve brenda institucioneve.

Qeveria e Kosovës kritikohet për ndërhyrje politike në caktimin e posteve kyçe në Shërbimin civil, si emërimi i njerëzve në poste të larta civile brenda ministrive, në bordet e ndërmarrjeve publike, në Zyrën e Avokatit të Popullit, si dhe në Gjykatën Kushtetuese.

Zotërinj të nderuar deputetë,

Kjo ka dëmtuar kredibilitetin e institucioneve të Kosovës, që të menaxhohet një proces të emërimeve në mënyrë korrekte dhe transparente. Aty ku ndërhyjnë politika dhe deri në nivel të shërbyesve civilë dhe stërngarkohet me partizanë partiakë, në atë vend ku ndërhyhet në gjykata dhe në Zyrën e Avokatit të Popullit, mund të themi lirisht se demokracia është në rrezik, sepse me këtë raport, me këto fakte veç se konfirmohet një konstatim yni kamotshëm se Qeveria ka degraduar shtyllat dhe themelet e një demokracie funksionale.

Për gjetjen e raportit nuk ndalet vetëm me kaq. Konstatohet se korrupsioni mbetet dominues në shumë fusha në Kosovë dhe vazhdon të jetë çështje shumë shqetësuese. Ne e dimë se në Ballkan korrupsioni dominon ende dhe në vendet tjera, megjithatë në raportet e progresit të Komisionit Evropian, së paku premtohet, së paku përmendet dhe vlerësohet angazhimi dhe lufta që ndërmarrin institucionet për luftimin e korrupsionit, mirëpo, tek ne kjo nuk ndodh. Në raport citohet se korrupsioni mbetet shqetësim në fushën e doganave, raporti thekson se licencat për të fluturuar në dhe nga Aeroporti i Prishtinës lëshohen në mënyrë jo transparente, përderisa ka shqetësime serioze në fushën e aviacionit.

Sa i përket prokurimit publik, raporti thekson se situata është keqësuar krahasuar me vitin paraprak dhe implementimin e Ligjit për prokurimin publik, ngreh shqetësime serioze. Zyrtarët e prokurimit në Kosovë mbeten të luhatshtëm karshi ndërhyrjeve dhe kërcënimeve, gjë që ka ndikuar me impakt negativ për mos zbatimin e ligjit rreth prokurimit publik.

Përdorimi apo dhënia e tenderëve me një burim është rritur nga 50 milionë euro në 164 milionë, që do të thotë se 164 milionë euro të parasë së taksapagueseve u është dhënë kompanive pa asnjë garë, çka, kjo nuk mund të quhet ndryshe përpos korrupsion klasik.

Krimi i organizuar, thuhet në raport, mbetet çështje tjetër shumë shqetësuese. Kosova nuk ka strategji për zvogëlimin e krimit. Kosova ka mungesë të resurseve për të luftuar këtë fenomen, ndërsa çështja tjetër tejet shqetësuese përmendet në raport është shpërlarja e parasë.

Shqetësimi tjetër i cili theksohet në këtë raport ka të bëjë me mbikëqyrjen e dobët. Organet mbikëqyrëse nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, deri te institucionet e pavarura rregullative nuk po i kryejnë obligimet e tyre për të vënë në llogari ekzekutive. Dhe, krejt në fund dua të theksoj se Raporti i Progresit të Komisionit Evropian konkludon se Kosova është shumë larg anëtarësimit në Schengen, listën e bardhë të BE-së.

Ndërsa, me këta trendë negativ dhe tejet brengosësh dëshmohet se nuk ishin institucionet ndërkombëtare ato që nuk ofruan shansin për prosperitet, por ishte puna joserioze, mungesa e vullnetit politik dhe kriteret e paplotësuara nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës për të garantuar dhe për t'iu qasur lëvizjes së lirë të qytetarëve të Kosovës dhe perspektivën e liberalizimit të vizave, si dhe çështja tjetër që mbetet, promovimin e mëtejme të agjendës Evropiane për Kosovës.

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, ftoj të gjithë deputetët të marrin pjesë aktive në këtë debat, ndërsa në fund të debatit do ta shfrytëzojmë të drejtën për të dalë me rekomandime konkrete. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Sipas radhës, kryetarja e Komisionit për Integritet Evropian, zonja Zylfije Hundozi, si propozuese për të debatuar për Raportin e Komisionit Evropian për Progresin e Kosovës në vitin 2009.

ZYLFIJE HUNDOZI: Zoti kryesues,
Zoti Kryeministër,
Ministra prezentë,

Dy ditë pas bërjes publike të Raportit të Progresit për Kosovën, Komisioni për Integritet Evropian e mbajti mbledhjen e rregullt dhe mbledhjen me përfaqësuesit e Komisionit Evropian, zotëri Kalldun Sino, i cili e prezantoi zyrtarisht para Komisionit, Raportin e Progresit për Kosovën. Mbajtën dëgjim publik me shoqërinë civile si edhe punëtori dy ditore me ç'rast u debatua për gjetjet e raportit të progresit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2009, si edhe rrugët të cilat Kosova duhet t'i ndjekë që sa më shpejtë të integrohet në Bashkimin Evropian.

Komisioni duke u nisur nga fakti që Kuvendi i Kosovës ka përgjegjësi domethënëse në realizimin e agjendës evropiane si trup legjislativ i vendit, detyra kryesore e të cilit është të miratojë ligje të cilat janë në harmoni të plotë me aquì communautaire, Komisioni ka kërkuar përkrahje nga Komisioni Evropian, të cilën përkrahje edhe e ka marrë me anë të ekspertit ndërkombëtar që ta ndihmojë punën e këtij Komisioni. Që të sigurohet se të gjitha institucionet kanë përkushtim për anëtarësim në Bashkimin Evropian, Kuvendi duhet t'i shqyrtojë me kujdes të gjitha veprimet e Qeverisë, kështu që Komisioni për Integritet Evropian, pas debateve dhe propozimeve për punën e mëtejme, nga këto takime e ka përpiluar një strategji dhe plan veprimi për Kuvendin e Kosovës, dokument, i cili është sot para jush dhe nëse aprovohet nga seanca plenare, Komisioni duhet t'i raportojë Kuvendit çdo tre muaj për të arriturat në mbikëqyrjen e Qeverisë në përmirësimin e fushave në të cilat jepet vërejtje në raport.

Gjetjet e këtij viti tregojnë që ka pak progres në fusha për të cilat ka pasur vërejtje në raportin e progresit të vitit të kaluar, e në disa fusha ka përkeqësim. Dhe, Komisioni Evropian e vlerëson situatën si shqetësuese sidomos në fushat e prokurimit publik dhe transportit ajror, në fushën e demokracisë dhe sundimit të ligjit, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, korrupsionit, krimit të organizuar. Por, si gjetje kyçe gjithashtu janë edhe mosvënja në veprim e vullnetit politik dhe koordinimit më efikas të agjendës për integritet evropian nga Qeveria e Kosovës, cenimi i lirisë së të shprehurit dhe pavarësisë së mediave.

Mungesa e strategjisë për zhvillim ekonomik, i cili për shkak të kësaj mungese edhe pse ishte prioritet në programin e Qeverisë, pak ka zhvillim në krahasim me katër raportet e kaluara që janë dhënë për Kosovën.

Ekonomia kosovare ende nuk është e aftë që t'i përballojë konkurrencës që është në tregun evropian, papunësia e madhe e qet edhe më tepër në pah ngecjen në zhvillimin ekonomik. Raporti i progresit për vitin 2009 prezanton të arriturat e Kuvendit, sidomos në miratimin e rezolutës për prioritetet dhe strategjitë e Kosovës për integritet evropian, si edhe planin e veprimit. Vërejtje i jepet Kuvendit për mungesë të kapaciteteve për të

shqyrtuar propozim-ligjet dhe monitoruar implementimin pas aprovimit të tyre. Gjithashtu jepet vërejtje për mbikëqyrje të dobët. Dhe, e cek me fjalë të raportit mbikëqyrja e degës së ekzekutivit nga Kuvendi ka nevojë për përmirësim të mëtejshëm.

Zbatimi i strategjisë dhe planit të veprimit për Kuvend në plotësi do të ishte një mekanizëm i mirë për përmbushjen e kësaj sfide të Kuvendit ndaj Qeverisë, si edhe përkrahja e shtuar financiare ndaj komisioneve parlamentare për kryerjen e punës së tyre. Pos retorikës për konsensus të gjitha institucioneve të Kosovës se dëshirojmë të anëtarësohemi në Bashkimin Evropian, pak është bërë në këtë drejtim. Nëse e analizojmë përmbushjen e planit për integrim evropian të Qeverisë për vitin 2008 – 2010 ku përcaktohen strukturat përgjegjëse për procesin e integritimeve evropiane në të gjitha nivelet e institucioneve siç është struktura më e lartë politike i ashtuquajtur i Këshilli për Kooperim të lartë, i përbërë prej Kryetarit të shtetit, Kryeministrit, Kryetarit të Kuvendit, zëvendëskryeministrit për integritime evropiane, si edhe ministrit për Punë të Jashtme, do të shohim se ky këshill nuk është takuar asnjëherë. Nëse merret parasysh që procesi i integritimeve evropiane është proces kompleks, kërkon koordinim nga strukturat më të larta institucionale nga të cilat do të dalin vendime strategjike, në mënyrë që të kenë përkrahjen e të gjitha forcave politike në vend dhe nëse merret parasysh që ky këshill nuk është takuar asnjëherë, kjo ka qenë një porosi indirekte për Komisionin Evropian se nuk ka vullnet politik për t'u shtyrë sa më shpejtë proceset për anëtarësimin në Bashkimin Evropian.

Njëri prej rekomandimeve të ardhshme do të ishte që ky këshill, i cili përfshinë autoritetet më të larta politike, duhet urgjentisht të takohet, në mënyrë që të kontribuojë sa më shumë në këtë proces.

Strukturë tjetër me rëndësi e krijuar sipas planit për integrim evropian nga ana e Qeverisë është Këshilli Ndërmintor për Integrim Evropian, i cili krijon strategji dhe politika që ndikojnë në punën e strukturave tjera të integritimeve evropiane për të cilin në raportin e progresit thuhet se nuk është funksional, është takuar vetëm dy herë, por pa agjendë specifike dhe pa listë paraprake të vendimeve që kërkohet nga ky Këshill.

Komitetet punëse për integritime evropiane gjithashtu nuk janë funksionale. Nëse merret parasysh që Greqia ka shprehur vullnet politik që gjer në vitin 2014 t'i anëtarësojë të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, a do të jemi ne të gatshëm për katër vjet t'i përmbushim kriteret e Kopenhagës apo do të jemi i vetmi shtet i cili do të mbetet jashtë Bashkimit Evropian?

Nga eksperiencia e vendeve që janë kandidate potenciale për Bashkimin Evropian dhe ato që janë anëtarësuar kohëve të fundit, kuptojmë se anëtarësimi është një proces i gjatë, i cili, me gjithë vendosmërinë e institucioneve dhe ndihmës së miqve ndërkombëtarë, do të zgjasë, me gjithë punën intensive, 8 deri 10 vjet. Por, megjithatë ne duhet ta kemi një plan afatgjatë për procesin e integritimeve evropiane, jo afat shkurtër, siç e kemi pasur 2008 – 2010, t'i caktojmë vetit afate kohore se kur do të arrijmë cakun tonë, të gjejmë mjete financiare dhe të sigurojmë resurse të mjaftueshme njerëzore, këtu po e nënkuptoj reformën e administratës publike. Kohën që e kemi në disponim ta shfrytëzojmë në mënyrë sa më efikase që t'i forcojmë institucionet, të bëjmë reforma sociale dhe krijojmë prosperitetin ekonomik.

Në ndërkohë mund të pritët që zhvillimet politike në shtetet fqinje dhe në Bashkimin Evropian, do t'i eliminojnë apo reduktojnë pengesat politike, specifike që tash i qa

Kosova, shtetet që nuk e kanë njohur ende Kosovën dhe ta reduktojnë rezistencën e përgjithshme ndaj politikës së zgjerimit që është evidente në disa vende të Bashkimit Evropian. Krijimi i këtyre parakushteve, ndoshta, do të ishte një impuls që të punojmë më me përkushtim në zbatimin e reformave të nevojshme me të cilat jeta e qytetarëve të Kosovës do të përmirësohet, por edhe të plotësohen kriteret për anëtarësimin në Bashkimin Evropian.

Rruga e ardhshme e Kosovës drejt të ardhmes Evropiane varet nga udhëheqja sot, nga kryetari i shtetit, nga Qeveria dhe nga Kuvendi i Kosovës. Kuvendi i Kosovës ka përgjegjësi domethënëse, prandaj i ftoj deputetët që sot ta miratojnë planin e veprimit të Komisionit për Integritet Evropian, zbatimi i të cilit do të jetë njëri prej kontributeve të Kuvendit të Kosovës drejt anëtarësimit të shtetit tonë në Bashkimin Evropian.

Njëkohësisht do t'i kisha lexuar rekomandimet që kanë dalë prej mbledhjes së Komisionit.

Kërkohet nga Kryesia e Kuvendit të Kosovës dhe administrata e Kuvendit, që të bëjnë shtimin e përkrahjes profesionale dhe financiare ndaj komisioneve parlamentare në shqyrtimin e propozim- ligjeve dhe aktiviteteve mbikëqyrëse ndaj Qeverisë dhe institucioneve të pavarura.

Kërkohet mbështetje nga të gjitha trupat e Kuvendit për forcimin e mëtejshëm të agjendës Evropiane në Kuvend, duke zbatuar plotësisht obligimet nga plani i veprimit. Për përmbushjen e aktiviteteve të parapara në planin e veprimit të Kuvendit të Kosovës kërkohet nga të gjitha komisionet parlamentare ta përfshijnë në agjendën e takimeve të tyre të rregullta pikën e veçantë të rendit të ditës- agjenda evropiane, ku do t'i shqyrtojnë sfidat e identifikuar në raportin e progresit për vitin 2009 dhe veprimin në planin e veprimit.

Informacionet e mbledhura nga komisionet parlamentare duhet t'i dërgojnë Kryesisë dhe pastaj Komisionit për Integritet Evropian. Komisioni për Integritet Evropian të ngarkohet, të përgatisë raporte të rregullta me rekomandime për zbatimin e planit të veprimit të cilat ia dorëzon për shqyrtim seancës plenare çdo tre muaj. Gjatë shqyrtimit dhe miratimit të agjendës legjislative për vitin 2010 Kuvendi do të marrë parasysh të gjeturat rreth mungesës së kuadrit ligjor në raportin e progresit për Kosovën për vitin 2009. Faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka Kryeministri i Kosovës, zoti Hashim Thaçi.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Dëshiroj, duke ju përshëndetur që në fillim, të theksoj se edhe unë si Kryeministër i Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, ka mirëpritur shumë publikimin e Raportit vjetor të progresit për vitin 2009, ... i publikuar në vitin 2009 dhe studimin e fizibilitetit. Raporti i Progresit është tanimë një mënyrë e rregullt e komunikimit të Republikës së Kosovës me Komisionin Evropian për progresin e arritur brenda periudhës njëvjeçare. Unë, por edhe gjithë Qeveria e Kosovës e mirëpresim këtë debat, idetë, këshillat, sugjerimet, rekomandimet e Parlamentit të Kosovës dhe agjendën tonë të ardhshme evropiane.

Dëshiroj të theksoj se Raporti i progresit, por edhe suksesi për studimin e fizibilitetit është një përmbledhje e Kosovës dhjetëvjeçare të pasluftës dhe hapjes së perspektivës evropiane. Pra, është një vlerësim për punën e gjithë neve që kemi bërë në dhjetë vjetët e kaluara. Raporti si i tillë është pasqyrim i progresit dhe sfidave në Kosovë brenda periudhës që e përmenda, njëkohësisht është udhërrëfyes për institucionet e Republikës së Kosovës në implementimin e agjendës evropiane.

Dua të potencoj që në fillim se raportin duhet ndarë në tri pjesë. Pjesën e vlerësimit të punës së shkëlqyeshme që është bërë, vlerësimin dhe paraqitjen e sfidave që kemi përballë nesh e që janë sfida edhe të institucioneve të Republikës së Kosovës, tash të përfshira edhe në raportin e Komisionit Evropian dhe pjesën tjetër atë të perspektivës, pra studimin e fizibilitetit apo perspektivës evropiane.

Sfidat e Raportit të progresit janë në përputhje të plotë me prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, institucioneve të Kosovës të cilat prioritetet ne i trajtojmë përmes Planit të Veprimit për Partneritet Evropian dhe dokumente të tjera Strategjike.

Gjetjet e Raportit të Progresit janë plotësisht në pajtim me pozicionin dhe qëllimet për zhvillimet politike dhe institucionale shtetërore të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe institucioneve tjera: në fushën e sundimit të ligjit, reformës së administratës publike, reformës së gjyqësorit, përmirësimit të prokurimit publik, luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, zhvillimin ekonomik të vendit dhe zgjerimin e dialogut dhe pajtimit të komuniteteve, por, edhe zgjerimin e dialogut dhe komunikimit, e marrëdhënieve më të mira me vendet e rajonit.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka funksionalizuar strukturat për integrim Evropian, të cilat nuk kanë ekzistuar theksueshëm më parë, tanimë jo vetëm që janë themeluar, por janë funksionalizuar plotësisht dhe është ndërtuar partneriteti i qëndrueshëm me Komisionin Evropian.

Këshilli Ministror për Integrim Evropian është takuar tri herë deri më tani, ndërsa Komiteti Punues për Integrim Evropian ka mbajtur takime të rregullta.

Intensifikimin e procesit të integrimit ne do ta adresojmë me forcimin e mëtutjeshëm të strukturave, të cilat janë bartëse të procesit të integrimit Evropian, dhe në këtë drejtim dëshiroj të potencoj edhe mundësinë e diskutuar dhe nevojën e krijimit të ministrisë së re, pra të Ministrisë së Integrimi Evropiane.

Jemi të vetëdijshëm se shteti i Kosovës ka hyrë në fazë të re në procesin e Integrimit dhe po përgatitemi që në këtë fazë ta trajtojmë me ngritjen e nivelit institucional që merret drejtpërdrejt me procesin e integrimit.

Të nderuar deputetë të Parlamentit të Republikës së Kosovës, publikimi i studimit të fizibilitetit paraqet një epokë të re për ne dhe avancim të Republikës së Kosovës në procesin e Integrimit në strukturat e Bashkimit Evropian.

Më këtë rast, dëshiroj t'ju siguroj se Qeveria e Republikës së Kosovës është plotësisht e angazhuar për të hyrë në fazën tjetër të procesit dhe përsëris që agjenda evropiane është dhe do të mbetet prioriteti ynë i parë.

Sfidat që dalin nga këto dy dokumente, Raporti i progresit dhe Studimi i fizibilitetit, janë prioritet i vazhdueshëm i Qeverisë së Republikës së Kosovës për përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe zhvillimin e reformave si përgatitje për integrim në strukturat Euro-Atlantike.

Vendosja e marrëdhënieve kontraktuale me Bashkimin Evropian është objektivë sublimë e shtetit të Kosovës dhe si të tillë mirëpresim udhëzimet dhe këshillat e Komisionit Evropian rreth procesit të liberalizimit të vizave dhe avancimin e raporteve tregtare me Bashkimin Evropian.

Rekomandimet e studimit të fizibilitetit në lidhje me procesin e liberalizimit të vizave janë një para hyrje dhe përgatitje e Republikës së Kosovës, si dhe publikimin e udhërrëfyesit zyrtar nga Komisioni Evropian për inkadrimin e Kosovës në procesin e liberalizimit të vizave, në kuadër të procesit të liberalizimit të vizave të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Në mesin e vitit të ardhshëm Kosova do ta ketë një udhërrëfyes zyrtar nga Komisioni Evropian, i cili obligim përcakton standardet dhe obligime tjera të caktuara.

Përmbushja e këtyre kriterëve do t'u mundësojë qytetarëve të Republikës së Kosovës të udhëtojnë, pa viza, në vendet e Bashkimit Evropian.

Përmbushja e këtyre kriterëve do të trajtohet me seriozitetin më të lartë institucional, duke marr parasysh tanimë se Qeveria e Republikës së Kosovës ka përgatitur udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave në mënyrë të njëanshme dhe ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e këtij udhërrëfyesi.

Të nderuar deputetë, dëshiroj të potencoj se kjo fushë do të trajtohet me prioritet më të lartë, numër një dhe se Kosova nuk do të jetë prapa shteteve tjera të Ballkanit Perëndimor.

Vetë publikimi i studimit të fizibilitetit që dialogu i liberalizimit të vizave të fillojë sa më parë është sinjal që Kosova do të vazhdojë të ecë përpara, e sigurt drejt integritit në strukturat e Bashkimit Evropian, krahas vendeve tjera të Ballkanit Perëndimor.

Andaj, këtu dëshiroj të theksoj, por edhe ta falënderoj Komisionin Evropian për përkrahjen e vazhdueshme që i ka dhënë shtetit të Kosovës, jo vetëm në fushën e liberalizimit të vizave, por edhe në mundësinë e arritjes së një marrëveshje tregtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Pra, avancimi i marrëdhënieve tregtare me Bashkimin Evropian paraqet një zhvillimin shumë të rëndësishëm ku prodhimet e Kosovës dhe komunitetit të biznesit kosovar do të mund të kenë qasje më të lehtë në tregun e Bashkimit Evropian dhe të trajtohen si partnerë të barabartë, si çdo pjesë tjetër e familjes evropiane.

Falënderoj Komisionin Evropian që i ka mundësuar Kosovës të përfitojë deri më tani nga preferencat autonome tregtare që nga viti 2000. Për këtë Qeveria e Kosovës mirëpret iniciativën e Komisionit Evropian për të thelluar raportet tregtare me Republikën e Kosovës.

Kjo do të shërbejë në hapjen e tregut dhe zhvillimin e mëtejshëm të lëvizjes së lirë të mallrave, personave dhe kapitalit.

Qeveria e Kosovës gjithashtu mirëpret thellimin e dialogut të procesit të stabilizim-asocimit, nga mekanizmi përcjellës i stabilizim -asocimit në dialogun për stabilizim-asociim.

Ky është një sinjal tjetër shumë i rëndësishëm të përkushtimit të Komisionit Evropian për integrim sa më të shpejt të Kosovës në Bashkimin Evropian.

Në anën tjetër, Komisioni në studimin e fizibilitetit ka shprehur gatishmërinë e tij për t'i ofruar Kosovës përfshirje më të madhe në programet e asistencës së komunitetit.

Kjo do të mundësojë që Kosova si çdo shtet tjetër i rajonit të përfitojë në mënyrë të shumëllojshme nga qasja në këto programe të komunitetit.

Dëshiroj të theksoj se perspektiva evropiane e shtetit të Kosovës është mbështetur në mënyrë unanime nga i gjithë Bashkimi Evropian, Komisioni Evropian edhe nga vendet që ende janë në proces të njohjes së pavarësisë së Kosovës. Pra, perspektiva evropiane e Kosovës është një perspektivë konsensuale e mbështetur në Bruksel.

Gjithashtu, dëshiroj të përshëndes edhe qëndrimin e Qeverisë së Spanjës e cila ka deklaruar se gjatë presidencës së ardhshme të Këshillit Evropian, në pjesën e parë të vitit 2010, do të forcojë konsensusin në mesin e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian për qasjen e pjesëmarrjes së Kosovës në të gjitha aktivitetet e procesit të integritetit të Ballkanit Perëndimor.

Si edhe më herët, Raporti i Progresit do të shërbejë si dokument orientues për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në vazhdimin e reformave të gjithmbarshme sektoriale, me qëllim të përshpejtimit të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

E dimë të gjithë se një proces i tillë është sfidues, është kompleks dhe për këtë arsye i kemi marrë të gjitha masat e nevojshme për të lehtësuar sa më shumë këtë angazhim.

Vendimtare në këtë rrugë është vullneti i Qeverisë së Republikës së Kosovës, i gjitha institucioneve relevante të Kosovës që t'i marrë këto sfida dhe t'i inkorporojë në agjendën e vet duke paraparë aktivitete konkrete drejt adresimit të tyre.

Kjo edhe është nënvizuar qartazi në Këshillin Ndërmintor për Integrim Evropian, ku të gjithë ministrat të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe udhëheqësit e agjencive të tjera kanë raportuar rreth sfidave për sektorët përkatës dhe është me rëndësi të theksohet se Qeveria ka vendosur të bëjë prioritizimin e sfidave më urgjente të cilat duhet të arrihen gjatë vitit 2010.

Si rrjedhojë, këto sfida janë përkthyer në prioritetet konkrete dhe do të inkorporohen drejtpërdrejt në planin e punës së Qeverisë për vitin 2010.

Të nderuar deputetë, dëshiroj të theksoj para juve që në procesin e integritetit evropian do të ketë llogaridhënie dhe përgjegjësi nga çdo ministër dhe udhëheqës i dikasterit, prandaj ju bëj thirrje juve ta monitoroni këtë proces, në mënyrë që bashkërisht të kontribuojmë në

arritjen e qëllimit final, pra të anëtarësimit të shtetit të Kosovës sa ma shpejtë në Bashkimin Evropian.

Është e vetmja agjendë e cila, apo agjenda kryesore e cila na bashkon dhe duhet të jetë e vetmja agjendë që na motivon, pavarësisht nga dallimet politike, të punojmë bashkërisht.

Të nderuar deputetë, agjenda Evropiane nuk nënkupton vetëm plotësimin e kriterëve dhe standardeve që parashtrihen nga Komisioni Evropian për anëtarësim, por këtë agjendë duhet ta kuptojmë edhe si përmirësim të gjithëmbarshtëm të standardit të jetesës së qytetarëve të Kosovës, përmirësim të sistemit arsimor, infrastrukturës, administratës publike dhe gjitha fusha tjera.

Dëshiroj të ritheksoj se Qeveria e Kosovës do të bëjë, veç e ka përfunduar analizimin e thellë të progresit të Raportit dhe të studimit të fizibilitetit dhe sfidat që dalin nga to ka përfshijë gjatë procesit të rishikimit të Planit të Veprimit të Partneritetit Evropian, me rezultate konkrete, të matshme ku secili veprim do të përmbushet.

Për të bërë këtë gjë gjatë periudhës në vijim do të kujdesemi që përveç Planit të veprimit për partneritet evropian t'i sinkronizojmë në mënyrën më të mirë dokumentet më të rëndësishme të Qeverisë si Kornizën afatmesme të shpenzimeve, Planin vjetor të punës, Planin për investime publike dhe Buxhetin e konsoliduar të Republikës së Kosovës.

Vetëm në këtë mënyrë mund të kemi një politikë unike dhe të qëndrueshme për integrim sa më të shpejt në Bashkim Evropian. Dhe, nëse është standardi politik, standardi prej më kryesorëve për perspektivën evropiane, dëshiroj të theksoj edhe argumentin tjetër së këtë standard ne të gjithë e arritëm si institucione, si parti politike, si qytetarë, me zgjedhjet lokale, ku instaloim standardin shumë të qëndrueshëm, demokratik të zgjedhjeve të lira, fer, demokratike me shumë përfaqësim apo përfaqësim shumë etnik.

Po ashtu, këtë vit procesi i programimit të instrumentit të para-anëtarësimit Ipo 2010 do t'i vazhdojmë t'i kushtojmë vëmendje të veçantë adresimit të sfidave që dalin nga Raporti i progresit. Të gjitha projektet e instrumentit të para-anëtarësimit, do të jenë në përputhje të plot me sfidat e dala nga Raporti i progresit.

Shteti i Kosova gjatë kësaj periudhe ka vazhduar punën mjaft sfiduese drejt konsolidimit të institucioneve demokratike, reforma në fushën e administratës publike dhe gjyqësorit.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe të komuniteteve pakicë në Kosovë, edhe mbrojtjes, por edhe respekt timit afirmativ në përputhshmëri të plotë me dokumentin e Presidentit Ahtisari dhe shembulli më i mirë është tash me pjesëmarrjen unike në zgjedhjet e 15 nëntorit.

Integrimi dhe kthimi i të zhvendosurve është një sfidë e veçantë për Qeverinë e Republikës së Kosovës, ose një dialog i vazhdueshëm me të gjithë aktorët, përfshirë edhe vendet e rajonit, është jashtëzakonisht i rëndësishëm për të gjetur zgjidhjen e kësaj çështjeje edhe të kthimit të zhvendosurve, pronave jo aq pak të rëndësishme, pastaj edhe zgjidhjen e çështjeve të personave të pagjetur, që është një prioritet shumë i rëndësishëm edhe i Qeverisë, edhe drejtpërdrejt edhe zëvendëskryeministri është i ngarkuar që të merret më këtë çështje. I dini edhe mundësitë, potencialet, angazhimet në koordinim me bashkësinë ndërkombëtare në këtë drejtim, por edhe gjithë nga ju i dini edhe kufizimet sa i përket kësaj çështjeje.

Qeveria e Kosovës, është e përkushtuar në vendosjen e plotë të ekonomisë së lirë të tregut, që do të jetë në shërbim të gjithë qytetarëve të Kosovës, prandaj ka marr me prioritet vërejtjet dhe rekomandimet e Komisionit Evropian në çështje që kanë të bëjnë me kontrollin financiar, ndihmën shtetërore, vendosjen e infrastrukturës ligjore dhe rregullimin e ndërmarrjeve publike.

Qeveria e Kosovës vlerëson lartë përkrahjen e vazhdueshme të Komisionit Evropian dhe donatorëve të tjerë në procesin e reformave dhe zhvillimeve institucionale.

Qeveria e Republikës së Kosovës vlerëson kontributin e Komisionit Evropian në mbështetje të përpjekjeve integruese të Kosovës dhe konsideron se po krijohet një partneritet shumë i fuqishëm.

Në këtë drejtim, ekspertiza dhe rekomandimet e mëtutjeshme të Komisionit Evropian do të na ndihmojë në ndërmarrjen e reformave tjera demokratike- institucionale.

Duke parë kompleksitetin e integritit evropian, Qeveria e Republikës së Kosovës, në bazë të vendimeve për përfundimin e strukturave dhe mekanizmeve, ka vazhduar në mënyrë intensive me funksionalizimin e këtyre strukturave të cilat do ta lehtësojnë dhe përshpejtojnë këtë proces.

Ky mekanizëm duhet të veprojë në nivelin politik dhe operacional. Bashkëpunimi me shoqërinë akademike, mediat, shoqërinë civile është qëllimi ynë i drejtë, një procesi që të jetë sa më gjithëpërfshirës.

Me krijimin e mekanizmeve, strukturave për integrim në Bashkim Evropianë, janë marrë parasysh parime shumë të rëndësishme.

Zotimi politik dhe i fuqishëm si sinjal për kapacitetet demokratike dhe përkushtim për interesat madhore strategjike.

Qëndrueshmëri të mekanizmit me të kuptuarit se mënyra më e mirë dhe më e shpejtë për t'i zhvilluar kapacitetet administrative është të ndërtohet më tej mbi rezultatet e arritura, në vend se të zëvendësohen strukturat ekzistuese duke humbur investimet në kapitalin njerëzor.

Llogaridhënia e paraqitur si parim i menaxhmentit të mekanizmit që bart përgjegjësitë për funksionimin e tij ose dështimin eventual.

Qartësia me qëllim që të kuptohen dhe monitorohen lehtë, ndarja e përgjegjësisë me objektiva të qarta, rezultate dhe indikatorë të matshëm.

Transparenca të jetë bazë për marrëdhëniet në nivel të strukturave politike, administrative, bizneseve dhe publikut më të gjerë, gjithmonë duke pasur parasysh se çdo qytetar ka të drejtë të plotë të jetë i informuar dhe të dijë se si po lëviz shteti drejt caktuar, anëtarësisë së plotë në Bashkimin Evropian.

Për të përfunduar këtë mekanizëm janë ndërmarrë edhe këto masa. Zëvendëskryeministri përgjegjës për Integritet Evropianë ka vazhduar intensivisht dialogun me Komisionin Evropian dhe ka ndihmuar në shtyrjen e procesit të integritit

brenda institucioneve të Republikës së Kosovës, në krye dhe në bashkëpunim me Agjencinë për Koordinimin e Zhvillimit dhe Integrim Evropian.

Këshilli Ministror për Integrim Evropian, që përbëhet në mënyrë të përhershme nga unë, zëvendëskryeministrat, ministri i Ekonomisë dhe Financave, ministri i Shërbimeve Publike dhe ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal ka mbajtur takime të rregullta. Në këtë organ marrin pjesë edhe të gjithë ministrat tjerë, varësisht nga agjenda. Detyrë e këtij organi ka qenë diskutimi dhe vendosja e strategjisë së Qeverisë dhe prioritetëve, do të thotë, politika, përcaktimi i prioritetëve, pozita e Qeverisë në procesin e integritimit.

Komiteti Punues për Integrim Evropian, i cili udhëhiqet nga zëvendëskryeministri, si dhe të gjithë sekretarët permanentë si anëtarë permanentë të Komitetit, ka mbajtur takime të rregullta. Ky organ shqyrton të gjitha çështjet relevante në procesin e integritimeve, në veçanti marrëdhëniet me Komisionin Evropian, realizimin e të gjitha prioritetëve afatshkurta dhe afatmesme, përfshirë çështjet ligjore, institucionale dhe investuese, programimin dhe realizimin e asistencës së Bashkimit Evropian dhe shfrytëzimin e instrumenteve të Bashkimit Evropian.

Të nderuar deputetë,

Grupet punuese për integrim evropian janë funksionalizuar në tërësi, një sërë takimesh janë mbajtur gjatë këtij viti. Grupet punuese në mënyrë specifike merren me çështje të orientuara në kapitujt e veçantë në harmoni me mekanizmin përcjellës të stabilizim - asocimit. Puna e këtyre grupeve ka të bëjë me zgjidhjen konkrete të problemeve lidhur me koordinimin dhe implementimin e agjendës për integrim evropian.

Gjithashtu, në shkurt të këtij viti me vendim të Qeverisë është formuar Grupi Punues për analizimin dhe evoluimin e aspektit fiskal të veprimeve të planit të veprimit të Partneritetit Evropian. Shumë shpjegime Qeveria do të bëjë riorganizimin dhe ristrukturimin e grupeve punuese duke reflektuar ndryshimin e kornizës së dialogut me Komisionin Evropian.

Të nderuar deputetë,

Si rezultat i shkrirjes së Agjencisë për Integrim Evropian me Qendër për Koordinim të Donatorëve në Agjencinë për Koordinim të Zhvillimit dhe Integritimit Evropian, kjo e fundit është plotësisht funksionale. Në këtë aspekt ne do t'i koordinojmë politikat tona drejt Bashkimit Evropian, me asistencën e vendeve jo anëtare në një sistem ku Republika e Kosovës do të fitojë në rrugën e saj drejt Bashkimit Evropian dhe zhvillimit në përgjithësi.

Të nderuar deputetë,

Duke vlerësuar lartë këtë mundësi për të diskutuar këtë agjendë dëshiroj të theksoj se në kuadër të tri ndarjeve apo kapitujve të Raportit të progresit si dhe Studimit të fizibiliteti nga Komisionit Evropian, Raporti i progresit përfshinë punën e gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës. Përfshinë pra Kuvendin, Qeverinë, Presidencën, sistemin e gjyqësorit, pushtetin komunal dhe gjitha agjencitë e pavarura.

Dëshiroj edhe të theksoj se në Raport- progresin përfshihet edhe Gjykata Kushtetuese, Avokati i Popullit edhe bordet.

Gjykatën Kushtetuese e ka zgjedhur Parlamenti i Republikës së Kosovës. Avokatin e Popullit e ka zgjedhur Kuvendi, bordet të gjitha janë zgjedhur me pëlqimin dhe nënshkrimin e zotit Piter Fait.

Në anën tjetër, gjykatat nuk i menaxhojmë ne, as agjencitë e pavarura. Edhe sa i përket fenomenit numër një, prioritet të luftës së Qeverisë së Republikës së Kosovës korrupsioni dhe krimi të organizuar, ju e dini në vitin 2007 Kosova ishte e para në ranglistën e vendeve të rajonit, ndërsa në raportin e Transparency International të vitit 2009 Kosova është e fundit në nivel të rajonit. Prandaj, duke u nisur nga këta parametra pozitiv të shtetit të Kosovës më lejoni që të vazhdojë me përmbledhje të arriturve të dala në Raportin e Progresit të vitit 2009.

Kriteret politike, demokracia dhe sundimi i ligjit.

Janë vendosur strukturat kryesore të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe funksionojnë në harmoni me dispozitat relevante kushtetuese.

Është mbajtur dhe fuqizuar stabiliteti politik dhe ka vazhduar konsolidimi i mëtejshëm i Qeverisë me formimin e Ministrisë së Forcës së Sigurisë, Ministrisë së Jashtme, Këshilli Kosovar për Siguri si dhe Agjencisë Kosovare të Inteligjencës.

Është miratuar Ligji për Shërbimin Diplomatik dhe Konsullor.

Qeveria ka vazhduar me ngritjen e kapaciteteve për përafrim në Bashkimin Evropian dhe fuqizimin e Agjencisë për Koordinim të Zhvillimit dhe Integritetit Evropian. Në gusht të këtij viti është miratuar Plani i rishikuar i Veprimit të Partneritetit Evropian 2009.

Qeveria ka vazhduar të bëjë progres në fushën e reformës së qeverisjes lokale dhe decentralizimit. Janë formuar grupet punuese për reformën legjislative, krijimin e komunave të reja dhe shpërndarjen e kompetencave dhe burimeve.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka miratuar strategjinë afatmesme 2009-2012.

Qeveria ka miratuar ligjet bazike për reformën e Administratës Publike, Ligji për Qeverinë, Ligji për shërbimin civil, dhe Ligji për pagat e shërbyesve civilë.

Administrata Publike

Është kompletuar rishikimi i detyrave dhe përgjegjësi në kuadër të administratës publike (rishikimi funksional) dhe shumica e këtyre rekomandimeve janë zbatuar.

Janë kompletuar rishikimet specifike për Ministrinë e Shërbimeve Publike, tani Ministria e Administratës Publike, Ministrinë e Pushtetit Lokal, Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe kadastrat e Kosovës.

Janë formuar grupe punuese për mbikëqyrjen e procesit të reformës së Administratës Publike, ato i raportojnë Komisionit Ndërmënyor, të Kryesuar nga zëvendëskryeministri.

Sistemi gjyqësor

Është miratuar Ligji për Gjykatën Kushtetuese.

Gjashtë gjyqtarë kosovarë, përfshirë dy përfaqësues të komuniteteve pakicë janë nominuar në maj nga Kuvendi dhe emëruar nga Presidenti, në qershor.

Janë miratuar një numër i ligjeve të rëndësishme që kanë të bëjnë me gjyqësorin:

- Ligji për noterinë,
- Ligji për Procedurën Kontestimore,
- Ligji për avokaturën,
- Ligji për ndërmjetësimin,
- Ligji për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit Penal të Kosovës,
- Ligji për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës,
- Ligji për përbërjen e përkohshme të Këshillit Gjyqësor të Kosovës,
- Anëtarët e Këshillit Gjyqësor janë emëruar në dhjetor.

Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e afirmimi i minoritarëve

Në dhjetor të vitit 2008, Qeveria ka miratuar Strategjinë dhe Planin e veprimit për të drejtat e njeriut për periudhën 2009-2011. Dëshiroj të theksoj se respektimi i drejtave të njeriut është një vlerësim i lartë i gjithë bashkësisë ndërkombëtare për Kosovën, por është realitet në Kosovë. Mbrojtja dhe afirmimi i minoritarëve është i garantuar me Kushtetutë dhe është me standardet më të avancuara bashkëkohore të botës moderne.

Të drejtat civile dhe të drejtat politike

Është publikuar raporti i Kosovës në lidhje me Raportin e Komitetit Evropian për parandalimin e torturës dhe trajtimin apo ndëshkimin degradues ose jonjerëzor të vitit 2007.

Rekomandimet e këtij raporti janë marr parasysh nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Hetimet për shkeljet serioze, përfshirë edhe rastet e qendrave të paraburgimit të policisë kanë vazhduar të kryhen nga ana e Inspektoratit të Policisë së Kosovës.

Ministria e Drejtësisë ka ndërmarr hapa për adresimin e ankesave për keqpërdorim në burgje dhe qendra të paraburgimit.

Divizioni për Këshilla dhe Ndihmë të Viktimave në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë vazhdon të ofrojë asistencë për viktimat e dhunës në familje dhe trafikimit.

Ka vazhduar zhvillimi i kapaciteteve të Zyrës për Personat e Pagjetur me mbështetje nga EULEX-i.

Kanë vazhduar takimet e rregullta të Grupit punues për persona të pagjetur, të përbërë nga delegacionet e Prishtinës dhe Beogradit, të kryesuar nga

Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq.

Në fillim të vitit 2009, Komisioni Qeveritar për Persona të Pagjetur ka krijuar një sekretariat, i cili është duke u funksionalizuar gradualisht.

Zyra e Koordinatorit për Ndihmë Juridike ka vazhduar aktivitetet e saj duke zhvilluar një ueb sajt në bazë të dhënave.

Gjatë periudhave tetor 2008 – nëntor 2009, më shumë se 1 mijë e 400 persona kanë përfituar nga ndihma juridike.

Zyra ka nënshkruar një memorandum të mirëkuptimit me Odën e Avokatëve për të përmirësuar përfaqësimin juridik për personat që kanë nevojë.

Sa i përket sistemit të burgjeve, Shërbimi Korrektues i Kosovës, në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, është funksional dhe janë ndërmarr masa të forcimit të sigurisë në objektet e sigurisë së lartë, si dhe janë përmirësuar pajisjet teknike, përfshirë edhe makinat për përcjelljen e të burgosurve.

Është miratuar Ligji për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare. Ligji për mbledhje publike është miratuar në dhjetor të vitit 2010.

Të drejtat ekonomike dhe sociale

Të nderuar deputetë,

Agjencia për Barazi Gjinore vazhdon të bëjë monitorimin dhe lehtësojë zbatimin e Programit kornizë për barazi gjinore 2008-2013, në pajtim me Ligjin për barazi gjinore.

Ka vazhduar ngritja e kapaciteteve të Agjencisë për Barazi Gjinore. Është përmirësuar përqindja e përfaqësimit të femrave në pozitat vendimmarrëse, në më shumë se 20%.

Janë formuar njësitë kundër dhunës në familje në kuadër të Policisë së Kosovës.

Në qershor të vitit 2009, Komisioni Ndërqeveritar për të Drejtat e Fëmijëve, i kryesuar nga Kryeministri, ka miratuar Strategjinë dhe Planin e veprimit për të drejtat e fëmijëve.

Zyra për Qeverisje të Mirë ka caktuar një zyrtar për të drejtat e fëmijëve. Ministria e Drejtësisë ka prioritet reformën e sistemit të ndëshkimeve të miturve.

Plani i veprimit për personat me aftësi të kufizuara është miratuar në prill të vitit 2009, inkorporon të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara në seksionin për arsim, mbrojtjen e fëmijëve dhe shëndetësi.

Në dhjetor, Qeveria ka miratuar vendimin për riaktivizimin dhe riorganizimin e Këshillit për personat me aftësi të kufizuara.

Sa i përket të drejtës pronësore në prill të vitit 2009 është miratuar Ligji për eksproporimet e pasurisë së paluajtshme

Në korrik, Agjencia Kosovare për Prona ka nënshkruar një memorandum të mirëkuptimit me Agjencinë Kadastrale të Kosovës për qasje në bazë të dhënave të kadastrave.

Në gusht të vitit 2009, Agjencia Kosovare për Prona ka nënshkruar një memorandum të mirëkuptimit me Komitetin e Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, për të lejuar fillimin e aktiviteteve në Serbi, të drejtat e minoriteteve, të drejtat kulturore dhe mbrojtja e minoriteteve.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka vazhduar aktivitetet në përmirësimin e mbrojtjes, integritetit dhe përfaqësimit të komuniteteve pakicë.

Këshilli Konsultativ i Komuniteteve është inauguruar dhe takohet rregullisht. Ky këshill, pra është me një përfaqësim shumë etnik, ku komuniteti serb përfaqësohet me pesë

anëtarë, nga tre komuniteti turk, boshnjak, nga dy anëtarë komuniteteve rom, ashkalinj, egjiptas dhe një anëtar i komunitetit malazez.

Ministria e Kulturës ka formuar një forum për shkëmbimin teknik të informatave për trashëgiminë kulturore në Kosovë.

Është bërë progres i madh në rindërtimin e objekteve ortodokse përmes Komisionit për zbatimin e rindërtimit.

Kodi i ri doganor i miratuar në nëntor të vitit 2008, përcakton dispozitat për lirimin nga taksat doganore dhe akciza për aktivitetet ekonomike të Kishës Ortodokse Serbe.

Vazhdon sigurimi i objekteve religjioze dhe të trashëgimisë kulturore nga ana e Policisë së Kosovës të mbështetur nga KFOR-i.

E drejta për edukim në të gjitha nivelet për komunitetet pakicë në gjuhën që ta zgjedhin, është e garantuar me ligj.

Kryeministria ka miratuar vendimin për formimin e Fondit për mediat e minoriteteve.

Qeveria ka bërë përpjekje të vazhdueshme për furnizimin me energji elektrike për pjesët e banuara edhe me komunitetin serb.

Rreth 850 të zhvendosur janë kthyer në mënyrë vullnetare këtë vit, në gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit ka vendosur një bazë të dhënave për regjistrimin e personave të zhvendosur brenda dhe jashtë Kosovës.

Disa komuna kanë miratuar strategjitë e tyre për kthim.

Në dhjetor 2008, Qeveria ka miratuar Strategjinë për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas për periudhën 2009 - 2015.

Kam emëruar dy koordinatorë për adresimin e çështjes së kampeve të kontaminuar. Në këtë drejtim është formuar një Komitet drejtues, ndërsa komuna e Mitrovicës ka ndarë parcelat për ndërtimin e shtëpive për familjet e prekura.

Çështjet rajonale dhe obligimet ndërkombëtare.

Ka vazhduar bashkëpunimi ndërmjet Kosovës dhe Gjykatës së Hagës për krime në ish-Jugosllavi. Kosova ka vazhduar të marrë pjesë në iniciativa të ndryshme të bashkëpunimit dhe integritit rajonal, me gjithë vështirësitë që dalin nga disa vende, në veçanti nga Serbia.

Kriteret ekonomike

Të nderuar deputetë,

Qeveria ka miratuar Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, për periudhën 2010-2012.

Në mars të vitit 2009, është mbajtur takimi i parë i mekanizmit për mbikëqyrje fiskale me Komisionin Evropian.

Gjatë këtij viti Kosova ka arritur të anëtarësohet në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore.

Është mbajtur konsensusi politik për fondamentet e politikave ekonomike të orientuara nga tregu i lirë.

Stabiliteti makroekonomik

GDP për vitin 2008 është rritur nga 5% në 5.4%.

Aktiviteti ekonomik në vitin 2008 dhe në pjesën e parë të vitit 2009 është udhëhequr kryesisht nga shpenzimet e kapitalit publik.

Konsumi publik është rritur me 3%, ndërsa investimet publike janë rritur gjithashtu. Në vitin 2008 ka pasur rritje të eksportit në 20.2%, që arrin rreth 5.3% të GDP-së.

Zhvillimet në fushën e eksportit dhe importit janë ndikuar nga zhvillimet e gjithëmbarshme të ekonomisë globale. Kosova vazhdon të ketë deficit tregtar me vendet e rajonit dhe ato të Bashkimit Evropian.

Banka Qendrore e Kosovës ka ngritur fushën e mbikëqyrjes së sektorit financiar dhe ka luajtur rol pozitiv në menaxhimin e rreziqeve lidhur me krizën ndërkombëtare financiare.

Ka prezantuar një monitorim më të shpeshtë të bankave komerciale. Këshilli i konkurrencës ka filluar zbatimin e politikës antitrust.

Agjencia Kosovare e Privatizimit ka filluar të punojë në përshpejtimin e procesit të privatizimit dhe suksesshëm.

Qeveria ka vazhduar dhe do të vazhdojë në përmirësimin e sistemit ligjor për të reflektuar një ekonomi të hapur të tregut.

Sektori financiar në Kosovë ka vazhduar të rritet me tetë banka komerciale, dhjetë kompani sigurimi dhe dy fonde pensionale.

Si reagim ndaj krizës globale financiare, Banka Qendrore e Kosovës ka formuar komitetet për përgatitjen ndaj krizës dhe ka nënshkruar një memorandum mirëkuptimi për mbrojtjen e stabiliteti financiar me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave.

Është arritur progres në kapitalin njerëzor dhe fizik, në veçanti në sektorin e shëndetësisë lidhur me akreditimi dhe kualifikimet, si dhe në konsolidimin e universiteteve.

Ka vazhduar funksionalizimi i autoriteteve të pavarura dhe rregullatorëve. Vendet anëtare të BE-së dhe CEFTA mbesin partnerët kryesorë tregtarë për Kosovën.

Standardet evropiane, tregu i brendshëm, lëvizja e lirë e mallrave, doganat dhe taksat, punësimi dhe politikat sociale, arsimi dhe hulumtimet, industria dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, bujqësia dhe peshkataria, mjedisi, politikat e transportit, energjia janë pikat që do ta prezantoj në vijim.

Të nderuar deputetë, qytetarë të Republikës së Kosovës,

Standardet Evropiane, tregu i brendshëm dhe lëvizja e lirë e mallrave, dua të theksoj se është arritur progres në fushën e standardizimit.

Këshilli për standarde profesionale është funksional dhe janë themeluar nëntë komitete teknike në fushën e ndërtimit, pastaj: naftës, gazit, sistemeve të menaxhimit të cilësisë, shërbimet e transportit dhe shërbimet postare, elektroteknika, metrologjia, kujdesi shëndetësor, energjia dhe përpunimi i drurit.

Deri më tani janë miratuar më shumë se 1 mijë 200 standarde.

Ligji për akreditim është miratuar në dhjetor të vitit 2008 dhe janë miratuar dispozitat implementuese të këtij ligji.

Katër organe për vlerësimin e konformitetit janë akredituar deri më tani. Është formuar një drejtori për akreditim, në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Janë nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi me institucionet simotra të rajonit. Ligji për mbrojtjen e konsumatorit është miratuar në prill.

Anëtarët e Këshillit për mbrojtjen e konsumatorit janë caktuar duke përfshirë edhe përfaqësues të organizatave joqeveritare.

Doganat dhe taksat

Kodi Doganor dhe i akcizës është aprovuar plotësisht në harmoni me standardet evropiane.

Doganat e Kosovës funksionojnë në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave që nga dhjetori vitit 2008.

Njësitë kundër kontrabandës kanë filluar të patrollojnë në të gjitha rrugët. Shkëmbimi i informatave ndërmjet Doganave të Kosovës me ndihmën e EULEX-it ka rezultuar në hetimin e disa rasteve kriminale nga të dyja anët.

Në shkurt të vitit 2009 është krijuar Njësia për të drejtat e pronës intelektuale për të zbatuar rregulloren për krijimin e procedurës së doganave.

Është krijuar Sektori për inspektim të brendshëm për të luftuar korrupsionin, në bashkëpunim me Agjencinë Kosovare Kundër Korrupsionit.

Në janar ka hyrë në fuqi reforma tatimore dhe norma të reja janë aplikuar. Ligji për Administratën Tatimore dhe Procedurat është miratuar në shkurt të vitit 2009.

Administrata Tatimore e Kosovës ka nënshkruar një memorandum të mirëkuptimit me Doganat e Kosovës, Policinë e Kosovës, dhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale për të përmirësuar mbledhjen e taksave.

Komisioni i konkurrencës është formuar në nëntor të vitit 2009 dhe Kuvendi ka emëruar anëtarët e tij.

Sa i përket politikës antitrust, Komisioni ka nënshkruar një memorandum të mirëkuptimit: me Odën Ekonomike, Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave dhe Doganat.

Komisioni i Konkurrencës është bërë anëtar i plotë i rrjetit ndërkombëtar të konkurrencës.

Punësimi dhe politikat sociale

Këshilli trepalësh këshillëdhënës është takuar, është riemëruar si Këshilli Socio-ekonomik është takuar në korrik.

Në fushën e përfshirjes sociale, është miratuar plani i veprimit për personat me aftësi të kufizuara.

Janë ofruar shërbime të kujdesit shtëpiak për personat me çrregullime mentale dhe psikike nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Punës e Mirëqenies Sociale.

Nëntë qendra të kujdesit shëndetësor mental dhe shtatë njësi të banimit janë formuar nën autoritetin e Ministrisë së Shëndetësisë.

Ka filluar fushata promovuese për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave ka filluar rishikimin e skemës së asistencës sociale.

Programi për punësim të qëndrueshëm është miratuar në korrik nga partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë.

Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale kanë ofruar shërbime të përkujdesjes shtëpiake për persona të prekur nga çrregullimet mendore dhe psikiatrike.

Nën autoritetin e Ministrisë së Shëndetësisë janë hapur nëntë shtëpi të komunitetit për shëndet mendor dhe shtatë shtëpi rezidente.

Ligji për shëndetësi është amendamentuar në dhjetor të këtij viti.

Deri më tani janë licencuar 563 ofrues privat shëndetësor.

Arsimi dhe angazhimet tjera hulumtuese

Të nderuar deputetë,

Janë shpërndarë për 380 mijë nxënës kosovarë tekstet shkollore gratis për të gjithë nxënësit e shkollave. Gjatë periudhës raportuese janë ndërtuar 45 shkolla dhe shkollat do të operojnë me më së shumti në dy ndërrime që nga shtatori.

Është krijuar Këshilli për licencimin e mësimdhënësve.

Fondi për pagat e mësimdhënësve është rritur në vitin 2009 për 4.5 milionë euro, dhe mund të them se sa i përket raporteve dhe reformave në arsim, Kosova definitivisht është e para në rajon.

Kosova ka konsoliduar pjesëmarrjen e saj në programet e Bashkimit Evropian, në programet arsimore më të avancuara ndërkombëtare dhe kjo ka rezultuar edhe me hapjen e Zyrës së Tempusit në Universitetin në gjuhën serbe në Mitrovicën veriore, ku Universiteti ka pasur mundësinë të aplikojë për grantet e Tempusit.

Këshilli Kosovar për plan- programe është funksional.
Agjencia Kosovare për Akreditim dhe bordi i tij janë funksional.

Ka përfunduar procesi i akreditimit të ofruesve të arsimit të lartë publik dhe privat në maj të këtij viti me ndihmën e ekspertëve vendorë dhe atyre ndërkombëtarë. Agjencia gjithashtu ka konfirmuar akreditimin institucional të Universitetit të Prishtinës dhe të disa kolegjeve private, ndërsa ju e dini se është marrë vendim për hapjen e Universitetit të dytë publik në Republikën e Kosovës, që do të fillojë punon në tetor të vitit të ardhshëm në qytetin e Prizrenit.

Gjithashtu janë bërë reforma edhe në industri edhe në ndërmarrjet e vogla edhe të mesme. Është miratuar Ligji për zonat ekonomike dhe reforma të tjera të ndërmarrësisë që përfshihet në kuadër të Kartës Evropiane për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, edhe sa i përket bujqësisë, por duke mos e harruar edhe peshkatarinë.

Gjithashtu në muajin mars Qeveria ka aprovuar ligjin duke pasur si prioritet jashtëzakonisht të rëndësishëm mjedisin.
Ligjin për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe Ligjin për vlerësimin strategjik mjedisor.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka siguruar pajisjet mobile për monitorimin e cilësisë së ajrit.

Në muajin mars, Qeveria ka aprovuar Ligjin për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes.

Në fushën e zhurmës janë aprovuar disa udhëzime administrative për implementimin e Ligjit për mbrojtje nga zhurma.
Janë bërë disa përpjekje për ngritjen e vetëdijesimit të publikut për çështjet mjedisore.

Qeveria, Ministria ka investuar edhe për mbjelljen e 2 milionë fidanëve, për çdo qytetar, do të thotë, nga një fidan. Qeveria e Kosovës ka bërë përpjekje për përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve, në veçanti sa i përket pozitës së Agjencisë së Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit. Fidanët kanë filluar të mbillen, po rriten, natyrisht duke i ujitur.

Politikat e transportit

Kosova ka vazhduar të participojë në mënyrë aktive në implementimin e memorandumit të mirëkuptimit të vitit 2004 për zhvillimet e SET Evropës Juglindore në rrjetin e transportit regjional, veçanërisht përmes angazhimeve dhe implementimit të planit shumëvjeçar 2009-2013.

Ligji për eksproprijimin apo shpronësimin e pronës së paluajtshme, i adoptuar në prill vuri bazën ligjore për Ministrinë e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit që të kujdeset për shpronësimin e tokës dhe aktivitetet përmes të cilave financohen projektet e infrastrukturës së transportit.

Këshilli për Sigurinë Rrugore, i drejtuar nga Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit është themeluar ne tetor të vitit 2008, kurse sekretariati i tij u bë funksional në janar. Një instruksion administrativ për teknikat e inspektimit ishte lëshuar në dhjetor si pjesë e implementimit të Ligjit për siguri në rrugë. Është e arritur të nxjerrët një vëllim substancial i legjislacionit të dalë nga Marrëveshja për hapësirën e përbashkët ajrore evropiane, EKA. Këshilli për Sigurinë Rrugore, i drejtuar nga Ministria e Transportit dhe e Postë- Telekomunikacionit është themeluar në tetor të vitit 2008, kurse ... në janar. Dëshiroj të theksoj se vetëm për këtë periudhë kohore në Kosovë kanë filluar, është duke punuar dhe janë në përfundim rreth 600 km rrugë të reja të asfaltuara, qoftë në nivel lokal, qoftë në nivel regional dhe me karakter gjithashtu edhe ndërkombëtar, por duke vazhduar edhe projektet nacionale të lidhjes së kryeqytetit dhe në drejtim të Vushtrrisë, Mitrovicës edhe në drejtim të Fushë Kosovës, Aeroportit, Klinës, Pejës e tutje, e gjithashtu edhe në drejtim të Ferizajt, në drejtim të Shkupit që duhet të përfundojë studimi. Ndërsa, në anën tjetër, dëshiroj të theksoj se në ditët e ardhshme pritet edhe hapja e ofertuesve për fituesit e fillimit të ndërtimit të autostradës së ëndrrave të qytetarëve të Kosovës dhe gjithë neve asaj Vermicë, Morinë, Prizren, Therandë, në drejtim të Prishtinës.

Energjia

Në korrik Qeveria vendosi që t'u ofrojë investitorëve paketën e termocentralit "Kosova e Re" dhe minierën e re. Çdo hap i cili është ndërmarrë në sektorin e energjisë e është ndërmarrë në koordinim të plotë me të gjitha autoritetet këshilluese, ndërkombëtare edhe të Komisionit Evropian edhe të faktorëve tjerë relevant, edhe këshillues, edhe ndihmues edhe orientues. Prandaj, dëshiroj të theksoj, nëse dëshironi të bëni paralele se këtë vit Kosova ka 35% më tepër furnizim me rrymë se sa në vitin 2007, ndërsa ka prodhim mbi 13% më tepër se në vitin 2007. Por, edhe falë vetëdijesimit dhe angazhimeve tona në debat publik me qytetarët është rritur edhe përqindja e pagesës së qytetarëve, ndërsa jemi duke investuar me të gjithë donatorët ndërkombëtarë për modernizimin e shpërndarjes që është jashtëzakonisht i rëndësishëm për procesin në të cilin po kalojmë edhe rregullimin definitiv të çështje së energjisë në Republikën e Kosovës.

Edhe në të ardhmen do të vazhdojmë që të punojmë ngushtë sipas standardeve më të larta në këtë drejtim edhe sa i përket fillimit të ndërtimit të termocentralit të ri "Kosova e Re", por edhe në angazhimet tjera të cilat janë të domosdoshme të respektohen në veçanti kur të fillojë ndërtimi i këtij termocentrali, standardi i ambientit, i cili është shumë i rëndësishëm për jetën tonë.

Do të thotë këtu edhe Rregullatori i ka kryer obligimet e veta, ndërsa sa i përket angazhimeve tjera edhe të shoqërisë informative edhe raportit media-politik, mendoj se, sa i përket këtyre angazhimeve, Qeveria e Kosovës edhe për pakica ka filluar të ndajë donacione për 14 media. Janë 110 transmetues të licencuar, 41 media reprezentuese për minoritete, 32 serbe, 3 turke, 2 boshnjake, 2 gorane dhe një rome, ndërsa së shpejti, apo veç është marrë vendim definitiv edhe për hapjen e programit të dytë të Radiotelevizionit të Kosovës.

Zhvillime pozitive mund të raportohen si lidhjet mes të Shoqatës së Transmetuesve Medial të Pavarur të Kosovës me mediat për minoritete, gjithashtu, në gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Edhe në Raportin e Progresit parashihet apo përmendet raporti politik, media, siç përmendi çdo raport të progresit të vendeve të rajonit, por edhe të Bashkimit Evropian, politikë ne jemi të gjithë dhe nuk përmendet vetëm një adresë.

Ndërsa, te drejtësia, liria dhe siguria ka pasur një sukses të jashtëzakonshëm e theksoj edhe prej autoriteteve tona shtetërore të formuara dhe të funksionalizuara. Sipas standardeve me të larta ndërkombëtare janë miratuar një varg strategjish që adresojë çështje edhe në angazhime tjera për diasporën, që do të thotë për migracionin, azilin, luftimi edhe i krimit të organizuar edhe rajonal edhe ndërkombëtar.

Qeveria e Kosovës ka vazhduar negocimin e marrëveshjes për riatdhesim dhe deri me tani ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh. Janë bërë përpjekje të vazhdueshme në luftimin e krimit të organizuar, sidomos në fushën e trafikimit. Është rritur numri i rasteve të hetuara dhe të zbuluara të personave dhe personave të arrestuar e të ndjekur. Në qershor është miratuar strategjia dhe plani i veprimit kundër narkotikëve. Këshillat komunal për siguri te komuniteti janë formuar për të fuqizuar raportin ndërmjet policisë, autoriteteve komunale dhe komuniteteve tjera lokale. Janë kthyer në shërbim shumica për shkak të përmirësimit të gjendjes të policëve që e kishin lënë shërbimin pas deklarimit të pavarësisë. Në shtator është miratuar Ligji për armët, kurse në janar 2009, është miratuar legjislacioni sekondar për armët e vogla.

Kosova ka miratuar Udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave si dhe planin e veprimit për implementimin e tij.

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Duke qenë kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe me vullnetin më të mirë për t'i kontribuar këtij diskutimi të përgjithësive të përbashkëta, por edhe të përgjegjësive përkatëse, dëshiroj të theksoj se procesi i integritetit të Republikës së Kosovës dhe i të gjitha vendeve tjera natyrisht, në strukturat e bashkimit Evropian, ka qenë, është dhe do të jetë plot sfida. Kemi arritur sukses të vlerësuar, një sukses ky i cili është duke u prezantuar dhe lavdëruar edhe nga ky vend i shenjtë ku po flas unë edhe prej personaliteteve më të rëndësishme botërore, ku secili nga ne duhet të ndihet mirë dhe krenar me suksesin që kemi arritur, por edhe të marrë përgjegjësi të reja për të punuar edhe më tepër.

Procesi i integritetit të një vendi, në strukturat e Bashkimit Evropian nuk arrihet për një vit, as për dy-tri vjet, por ndërtohet baza e qëndrueshme për sukses të mirëfilltë. Këtë bazë, duke punuar të gjithë në mënyrë konstruktive e kemi arritur dhe në suksesin e Kosovës, në procesin e integritetit Evropian askush nuk mund të rrijë anash, përkundrazi secili e ka luajtur rolin e vet aktiv e të rëndësishëm dhe synimin tonë integrues euroatlantik të politikës kosovare, të shtetit kosovar, të vullnetit të qytetarëve të Kosovës, të mbështetjes ndërkombëtare. Nuk duhet të na ndajnë këtu flamuj partiak apo synimet partiake, qoftë edhe procesi elektoral tash, përkundrazi duhet të jetë një proces unifikues, gjithëpërfshirës, shumë përgjegjës, duhet të jetë një proces shoqërues në kuptimin edhe integrues edhe afrues me të gjithë, sepse kriteri politik vazhdon të mbetet kriteri kryesor për suksesin tonë, por dëshiroj edhe një herë të theksoj se edhe në debatin që do të zhvillohet dhe që ju inkurajoj në këtë drejtim, secili t'i adresojë këshillat, rekomandimet në institucionet përkatëse, qoftë për punën e Parlamentit, qoftë në punën e Presidencës, qoftë për punën e Qeverisë së Kosovës, qoftë për sistemin gjyqësor, qoftë për pushtetet komunale apo për agjencitë e pavarura, ndërsa në raport përmenden edhe tri çështje që përsëri dëshiroj për hir të opinionit t'i sqaroj edhe Gjykatën Kushtetuese, edhe Avokatin e Popullit, i ka zgjedhur Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe jo Qeveria e Republikës së Kosovës. Edhe në angazhimet tjera, të cilat përmenden në raport edhe sa i përket bordeve. Çdo emërim në bordet përkatëse është emërim i

aprovuar, edhe i nënshkruar prej ICO. Edhe qartësime tjera agjencitë janë të pavarura, gjykatat janë me rolin e vet kushtetues, prandaj mos të përzihet politika, synimet politike dhe përgjegjësitë e ndara pushtetore. Pra, më e rëndësishmja prej gjithë këtij diskutimi dhe Raporti të progresit, sfidave që dalin aty, vlerësimeve që dalin dhe angazhimeve për të ardhmen, është se shteti i Kosovës për vetëm një vit e gjysmë arriti të përfitojë në mënyrë meritore të drejtën për hapjen e perspektivës për liberalizimin e vizave për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës dhe këtë të drejtë, disa vende të rajonit për 18 vjet s' e kanë fituar. Kjo është e arritur e jashtëzakonshme dhe historike e të gjithë neve, si politikë, si institucione, si shtet, si qytetarë dhe të arriturën tjetër, hapjen e perspektivës për marrëdhënie tregtare, pra të dialogut me vendet e Bashkimit Evropian dhe dialogun për stabilizim asocim dhe procesit të stabilizim-asocimit.

E vlerësoj edhe një herë para jush, Raporti i progresit dhe studimi i fizibilitetit përfshihet në tre, i ka tri qasje me një qëllim, vlerësimet e të arriturave më të larta evropiane të Republikës së Kosovës, sfidat që dalin para nesh, janë edhe sfida të Qeverisë dhe të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës dhe vizionin e perspektivës evropiane të Republikës së Kosovës.

Ju faleminderit për vëmendje dhe do të jem edhe unë jashtëzakonisht i angazhuar në këshillat, rekomandimet dhe debatet tuaja. Ju faleminderit nga të gjithë.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Sipas radhës, fjalën e kanë kryetarët e grupeve parlamentare ose të ngarkuarit. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, jam i informuar, që Hydajet Hyseni, do të flasë për raportin.

Zoti Hyseni, e keni fjalën.

HYDAJET HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar Kryeministër,

Të nderuar ministra,

Zonja e zotërinj deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, në parim mirëpret dhe përshëndet nismat për debat parlamentar, qoftë nga pozita, qoftë nga opozita, duke i konsideruar ato si instrument të rëndësishëm të funksionimit të ndërlidhur dhe të balancuar midis trupit ligjdhënës dhe atij ekzekutiv.

E mirëpresim edhe nismën e Grupit Parlamentar të LDD-së, sado që e konsiderojmë që çështjet e karakterit të përgjithshëm dhe gjithëpërfshirës, siç është Raporti i progresit, duan shtruar në procedurë të rregullt parlamentare, siç ka bërë komisioni, me propozim për rendin e ditës në Kryesinë e Kuvendit dhe jo të futen në kornizën e raporteve pozitë-opozitë.

Nisma e kolegëve tanë që është kërkesë për debat i referohet nenit 25 të Rregullores, e cila ka të bëjë me interpelancën parlamentare. Pa dashur të stërhollojmë me procedurat, megjithatë debati dhe interpelanca parlamentare nuk janë e njëjta gjë. Interpelanca ka të kufizuar kohën, dy orë, aq më tepër interpelanca mund të parashtrohet tekstualisht për një çështje që ka të bëjë me punën e Qeverisë, kurse në rastin tonë, kërkohet një debat sipas referencës – interpelancë për Raportin e progresit të Komisionit Evropian.

Ky raport ka të bëjë gjithsesi edhe me punën e Qeverisë, por jo ekskluzivisht me të dhe, sërish, qasja më e mirë do të ishte procedimi i rregullt jashtë terrenit pozitë-opozitë.

Përkushtimi për integritet evropian në Kosovë është, padyshim, njëra ndër çështjet për të cilat Kosova ka pasur dhe ka një pajtueshmëri të deklaruar dhe të dëshmuar plebishitare midis të gjitha forcave politike në Kosovë, gjë që do mbajtur parasysh. Edhe për kundër kësaj, Grupi parlamentar i PDK-së e çmon dhe e respekton rolin e opozitës dhe e kupton edhe motivimin për t'u shfaqur me një qasje më partikulariste dhe më kritike e herë – herë edhe kritizuese. Vërejtjet dhe sugjerimet, qofshin ato edhe të sforcuara, i kuptojmë si ndihmesë për reflektim, korrigjime, përmirësime e avancime në një segment me rëndësi vërtet të jashtëzakonshme. Grupi ynë parlamentar është jo më pak i motivuar për një qasje serioze, të përgjegjshme dhe kërkuese, atje ku është kjo e nevojshme edhe kritike, por pa e injoruar edhe nevojën për në qasje korrekte e afirmative, atje ku bëhet fjalë për suksese dhe të arritura që vlerësohen pozitivisht edhe në raport dhe gjithandej. Pa lejuar rënien në pozitë apologjete, thjeshtëzuese e ilustruese të realitetit, e konsiderojmë joadekuate qasjen e sforcuar nihiliste, negativiste në segmentet e karakterit gjithëpërfshirës, siç janë integritet evropian.

Nuk konsiderojmë se Raporti i progresit ka paraqitur vetëm, citoj: “aspekte negative, ngecje dhe keqësim të punës në disa institucione të Kosovës”. Nuk e kontestojmë faktin se çështje si korrupsioni, krimi i organizuar, gjendja në sistemin e drejtësisë dhe media, që janë apostrofuara në kërkesë, janë brengose, por nuk mund të kontestohet as fakti se po aq ... dhe po aq brengosëse, mbase edhe më shumë janë çështje si aspektet ekonomike të zhvillimit, problematika sociale, faktorët dezintegruues dhe instrumentalizimi i tyre, bllokadat politike, diplomatike, ekonomike, tregtare, kulturore, sportive e tjera, papunësia e lartë, problemet e mjedisit, ndotja e ajrit mbi 70 herë më shumë se sa normalja. Në të gjitha këto fusha, ashtu si edhe në segmentet tjera, ka probleme dhe Raporti i progresit i thekson ato me të drejtë dhe kjo nuk mund të mos jetë brengë e të gjithëve, por pothuaj se në të gjitha këto janë konstatuar edhe lëvizje përpara dhe kjo do të duhej të ishte edhe kënaqësi e të gjithëve. Një vlerësim korrekt dhe i përmbledhur i raportit si dhe i komunikatës së Komisionit Evropian për Parlamentin Evropian dhe Këshillin e Evropës, do të ishte i ngjashëm me vlerësimin të cilin e hasim të përsëritur në këtë dokument: “Në Kosovë ka progres, por ka edhe mjaft sfida edhe punë për të bërë”.

Madje, po të numërohen lëvizjet pozitive, unë e kam bërë një përlllogari të përafërt, nuk janë më të pakta ato pozitive se mangësitë dhe sfidat, pa mohuar faktin se ka edhe mangësi e sfida që nuk janë përfshirë në raport. Është fakt që dihet se ka shumë më shumë të arritura pozitive të cilat nuk janë përfshirë edhe për shkak të mos prezantimit adekuat të tyre, siç ka edhe mangësi e sfida të fryra e të egzagjeruara si pasojë e influencave të ndryshme jo gjithmonë dashamirëse, e madje edhe e qasjeve mbase jo gjithmonë qëllim këqija, por servile, denoncuese, anakimuse e profitore. Nuk ndodhë në vende tjera që nga vendorët të plasohen deklarata pompoze për mungesë vullneti për luftë antikorruption, madje edhe për mungesë vullneti për integritet evropian, në kohën kur nga një raport neutral ndërkombëtar konstatohet përkushtimi i fortë edhe për njërën, edhe për tjetrën, duke konstatuar edhe progres të caktuar në këto drejtime. Nuk ndodhë që shoqëria civile të konstatojë ngecjen e institucioneve të Kosovës në kohën kur raportet konstatojnë, pos mangësive dhe sfidave, edhe progres evidentë. Nuk ndodhë që të trumbetohet me aq forcë nga zëdhënës vendorë e ndonjë ndërkombëtarë se gjëja Qeveria bëka agjendën e Kuvendit dhe përsëritet kjo deri në absurd. Ndërsa në raport thuhet tekstualisht se “Plani i punës së Kuvendit është në përputhje me strategjinë ligjvënëse të Qeverisë”, aq më tepër kur është edhe normale, madje edhe ideale kur Qeveria me strategjinë ligjvënëse në programet, projektet dhe ofertat e veta praktikisht bën agjendën e Kuvendit. Nuk ka ndodhur në vende të tjera që në raport të përvidhen

me hir ose pa hir edhe konstatime të padrejta, të paqëndrueshme ose shifra të fryra dhe, në vend që të reagohet, dalin vendorë që u duartrokas. Merrni me mend shifrat prej 200 e sa mijë të zhvendosur jashtë Kosovës dhe po thuaj aq brenda Kosovës dhe krahasoni me statistikat e para 10-15 vjetëve. Nuk ndodhë që në vend se të reagohet, iu duartrokitet edhe konstatimeve në të cilat fajësohet Kosova dhe institucionet e saj edhe për fenomenet që nuk janë prodhim kosovar dhe mbahen edhe më tutje në duar të tjetërkujt. Bëhen krahasime me vende tjera në fusha ku objektivisht nuk mund të ketë krahasime, por jo edhe në fusha ku mund të bëhen krahasime, por nuk bëhen dhe aplikohen kushtet, kutet e ndryshme që për pasojë edhe nxjerrin vlerësime, përfundime të padrejta e të paqëndrueshme. Krahasuar me vendet përreth, në procesin e integritetit evropian Kosova është shumë prapa dhe kjo është e vetëkuptueshme, është starti i vonuar dhe nuk do të duhej ta befasonte askënd. Kosova do krahasuar me vendet përreth në stadin e tyre të fillimit të procesit, madje edhe atëherë duke pasur parasysh specifikat e realitetit kosovar. Është një nismë e mbarë, prandaj do të thosha është përcaktim plebishitar dhe përkushtim i fortë. Ka të arritura, por ato nuk janë në përputhje as me nevojat, e madje as me mundësitë ekzistuese. Këtu mendojmë ne, duhet të bashkohen edhe vlerësimet tona, por edhe përpjekjet dhe energjitë tona në funksion të realizimit të synimit të përbashkët.

Raporti i progresit është jo vetëm një skanim i gjendjes në të cilën ndodhemi, është jo vetëm një diagnostifikim në përgjithësi i saktë i proceseve, por është edhe një shtegdalje me udhëzime, rekomandime, oferta konkrete për sanim dhe progres të mëtutjeshëm. Problemet që janë apostrofuat në kërkesën për debat, janë po ashtu probleme të përbashkëta dhe si të tilla duhen adresuar. Sado që raporti i vlerëson lëvizjet pozitive në luftën kundër korrupsionit dhe atë në disa vende, fenomeni i korrupsionit mbetet vërtet shqetësues dhe imponon nevojën e mobilizimit të përgjithshëm shoqëror për t'i dalë vendosmërisht përpara. Duke mbështetur lëvizjet pozitive, sidomos në fillim të mandatit, e mbështesim përcaktimin e Qeverisë dhe të kryeministrit për zero tolerancë ndaj çdo forme të korrupsionit. Në mënyrë të veçantë do marrë seriozisht apostrofimin në raport, mbase i vetmi që shprehimisht konstaton keqësim në raport me një vit më parë, i problemeve me prokurimin. E inkurajojmë Qeverinë dhe mekanizmat përkatës që të ndërmarrin masa imediate, energjike dhe efikase në këtë fushë. Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës e konsiderojnë agjendën evropiane si prioritet mbi të gjitha prioritetet dhe po ndërmarrin hapa konkrete në drejtim të konsolidimit të tyre. Krijimi i Ministrisë së Integritetit Evropian është një hap i qëlluar dhe premtues. Plani i veprimit i Qeverisë dhe ai i Kuvendit të Kosovës duan harmonizuar edhe midis tyre dhe me segmente të tjera shoqërore, veçmas me gjyqësinë si dhe me shoqërinë civile, duke respektuar pavarësinë dhe përgjegjësinë në secilën fushë. Raporti ka të bëjë me të gjithë Kosovën dhe me të gjitha segmentet shtetërore e shoqërore të saj. Secila ministri dhe secili komision do të duhej të shqyrtojnë pjesët përkatëse të raportit, t'i analizojnë, të nxjerrin detyrat, t'i kthejnë në plane e projekte konkrete dhe në këtë mënyrë të ndërtohen raporte të përgjegjshme komunikimi, bashkëpunimi e partneriteti. Integriteti evropian është interes dhe përcaktim i përbashkët dhe mund të realizohet vetëm bashkërisht...

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Sabri Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Zoti kryetar i Kuvendit dhe ju ministra që keni durimin më të madh se të tjerët,

Ne po bisedojmë sot një pikë të rendit të ditës të formuluar nga Kryesia me kërkesë të një grupi parlamentar dhe të një komisioni të parlamentit. Kjo nuk është interpelancë, por është një seancë kushtuar një dokumenti, një problemi themelor, besoj që kjo duhet të jetë e qartë. Kjo i bie që seanca vazhdon aq sa njerëzit kanë dëshirë të flasin dhe ju nënshtrohet rregullave të një seance të Parlamentit, me Rregullore. Desha, se m'u duk se pati pak a shumë jo qartësi rreth këtij problemi. Është seancë për këtë çështje që është vu dhe këtë Kryesia me konsensus e ka caktuar kështu.

Unë mendoj që sot ne kemi përpara tri dokumente, të cilat është menduar se duhet të diskutohen dhe janë të lidhura në mes veti. Një, është Raporti i progresit për vitin 2009 për Kosovën, tjetri është deklarata, që është në dokument i dytë për perspektivën evropiane të Kosovës dhe, i treti, është një draft program, që Komisioni për Integritet Evropian i Kuvendit të Kosovës i ofron Kuvendit lidhur me obligimet e Kuvendit dhe të institucioneve të Kosovës për rrugën e deklaruar në mënyrë koncesuale të Kosovës evropiane, do të thotë të Kosovës që pretendon të krijojë standarde ose norma evropiane, në mënyrë që t'i ofrohet këtij bashkimi.

Unë jam përpjekur pak a shumë t'i shohë të lidhura këto tri dokumente dhe të nënvizoj gjithnjë në lidhje me to edhe tri-katër pika, që unë i shoh themelore. Nuk ka dyshim se ndërtimi i një raporti për Kosovën është një e dhënë e rëndësishme, interesante, që Kosovën e futë në radhën e vendeve që aspirojnë të shkojnë kah Evropa dhe, e dyta, sepse në një shikim, ta quajmë ne neutral, me një kriter shikohet gjendja jonë edhe institucionale, edhe zhvillimore, qoftë politike, ekonomike ose sociale. Prandaj, po e them menjëherë konstatimin që duhet të vinte edhe në fund të kësaj fjale timen, në emër tim, por edhe të Grupit të Lidhjes Demokratike, mendoj që institucionet e Kosovës, më së pari Kuvendi ku ne jemi aktor e përfaqësues, duhet t'i ketë rekomandimet e këtij progres raporti dhe rekomandimet e Deklaratës për perspektivën Evropiane të Kosovës, si pika referimi për punën orientuese institucionale dhe zhvillimore në të ardhmen dhe, menjëherë, këtu afate nuk ka, se ju e dini që herën tjetër, pas një viti do ta kemi raportin e analizave dhe të vlerësimeve të tilla. Pra, afate nuk ka. Kjo është prej sot, prej dje, për çdo ditë.

Unë kam nënvizuar dy-tri probleme themelore. Vlerësimi i Parlamentit është përafërsisht gjysmë-gjysmë, do të thosha unë, ku jemi ne, vlerësohet ana procedurale e Parlamentit, por nuk vlerësohet ana e mbikëqyrjes së duhur të ekzekutivit të Qeverisë. Kjo është pak a shumë ajo që thuhet, do me thënë proceduralisht Parlamenti ynë punon mirë, me rregullore, me planifikime, të gjitha, mirëpo fuqia e kontrollit qeveritar duhet të përmirësohet. Sa i përket Qeverisë, prapë në mënyrë përmbledhëse ne kemi disa konstatime. I pari, është që nuk ekziston koordinimi i mirë ndërministror, për të mos thënë me fjalët e raportit – ky koordinim ndërministror është i dobët. E dyta, në kuptimin legjislativ janë dy vërejtje themelore: mungesa e ligjit për Qeverinë dhe mungesa e Ligjit për Prishtinën, sa i përket legjislativit. Kjo është në faqen 8, teksti shqip.

Tutje, flitet për problemet e emërtimeve politike, të cilave iu referua kryeministri në fjalimin e tij të gjatë, të cilat ai i arsyeton, sepse janë emërtime që janë bërë në Kuvend dhe, e dyta, janë emërtime që kanë marrë njëfarë vule të këtij përfaqësuesi tash, Peter Feith, çfarë funksioni ka, mbikëqyrësi a çka është ky, administrator, qysh të doni ta quajnë, me fuqi administratori, i emëruar si mbikëqyrës dhe probleme të tjera lidhur me mosfunksionimin e Komitetit për Emërtime të Larta, që do të duhej të ishte, nëse ekziston një, ta quajmë ne arbitraritet i emërtimeve politike, nëse janë, atëherë faji është pse ky institucion kushtetues nuk funksionon dhe këtë raporti e ka vë në dije. Problemi

është edhe i sigurisë në Veri, e cila quhet shqetësuese dhe pika të tjera. Unë po përpiqem, pra, ti lidhë edhe një herë këto probleme legislative, sepse e kanë një adresim, do me thënë, shihen si probleme aktuale edhe në Kuvend, edhe në Raportin e progresit dhe në Raportin ose propozimin e veprimit që e paraqet Komisioni për Integritet Evropian. Pra, janë këto dy ligje, edhe Ligji i Qeverisë, edhe Ligji i Prishtinës, por unë kisha thënë që caktimi i afateve, jo tremujori i parë, jo tremujori i dytë i vitit të ardhshëm, është gabim nga Komisioni i Integritetit dhe unë mendoj se ai afat duhet të fshihet. Të dyja këto nuk kanë afat, duhet të mbërrijnë sa më shpejt. Nuk ka afat një gjysmë viti, një vit, është gabim dhe ky është sugjerim, menjëherë po e them, në atë planifikim të Propozim-planit të veprimit të Kuvendit të Kosovës që e keni deklaruar.

Në pjesën tjetër të dokumentit që është perspektiva evropiane, ne i kemi disa pika rekomandimesh. Unë për vete i shoh të rëndësishme tri: hapet perspektiva që për Kosovën të nxitet procesi i stabilizim-asocimit me një formulë që këta i thonë “Dialogu për procesin e stabilizim-asocimit”, ofrimi i një kontrate që ka të bëjë me raportet ekonomike me BE-në dhe, e treta, është një perspektivë e mundshme e liberalizimit të vizave. Po, unë po ju them që këto janë pa ndonjë specifikim date, kushtesh, por janë si një, hajde ta quajmë, dritë e gjelbër e komunikimit evropian të organeve të Kosovës, të shoqërisë së Kosovës.

Tash, unë dua të nënvizoj dy-tri çështje themelore, që i shoh edhe në raport me këtë Raport të progresit, por edhe me ato që duken në shoqërinë tonë. Problemi i parë është sundimi i ligjit. Kjo është formulë që e thonë të gjithë, do të dëgjohet edhe këtu shumë herë dhe ka të bëjë me ne konkretisht me luftën kundër korrupsionit, që është dukuri e njohur edhe në Kosovë, edhe në vendet përreth dhe nuk themi asgjë të re nëse e përsërisim këtë formë edhe sot këtu. Edhe lufta kundër krimit të organizuar, në plan të parë këto të dyja, dhe këtu ka një rrënjë të problemit, që është mirë në Kuvend ta themi, se këto fenomene nuk kanë si nuk duken më të ashpra në Kosovë, në një vend të varfër, në një vend ku në të vërtetë Qeveria është punëdhënësi më i madh, ende Qeveria e Kosovës është institucioni i punëdhënësit më të madh numerikisht në Kosovë dhe, e dyta, ku politika ende akceptohet si zanat i përfitimit, jo i përgjegjësisë dhe kjo është në Kosovë, për fat të keq, ende, është edhe në rrethinë, por kjo nuk ka pse na ngushëllon. Ende nuk është përgjegjësi, por është privilegj, sepse është dëshmuar e pavërtetuar ose e vërtetuar që ka sot të cilët udhëheqin, pasurohen pak si shpejt.

Kjo, pak a shumë nënvizohet edhe në Projekt-raport dhe sidomos në pjesën ku ka të bëjë me tenderime dhe me atë pjesën që e quajmë – blerjesh ...

KRYETARI: Mirë, regjia i vazhdoni edhe dy minuta!

SABRI HAMITI... pra, kemi të bëjmë me..., nëse thuhet zero tolerancë, si vullnet politik i deklaruar, në Kosovë ka çka të punohet shumë që të ndalet korrupsioni. E dyta, ka të bëjë me lirinë e shtypit ose mediat, që është prapë një problem që këtu tëhollohet edhe në raport theksohet shumë, por edhe në media dhe në mënyrën tonë të komunikimit me to. Unë e kam një formulë klasike edhe si njeri që kam punuar në..., për kah natyra, në pjesë ku flitet për..., shprehja është e lirë, po edhe shpifja duhet të ketë sanksione. Kjo është formula ime klasike. Po, shprehja e lirë po, por shpifja duhet të sanksionohet. Ne kemi medime të cilat deklarohen të lira, për fat të keq nuk janë, sepse nuk kanë liri dhe siguri materiale. Po flas për ato që janë të deklaruara të pavarura, sepse për ato që janë publike, unë kam një vendim specifik, konkretisht për RTK-në, me të cilën ne do të merremi për financimin e tij dhe po përpiqemi t'i ndërtojmë organet përfaqësuese të tij,

veç se duhet në këtë Kuvend të thuhet dhe të definohet përfundimisht, a është RTK-ja televizion publik, a është televizion shtetëror, apo po derivon edhe në televizion partiak. Kjo duhet këtu të diskutohet një herë thellë e mirë, se sa për privatet, është problem i tyre, ata mund të deklarohen televizione që përkrahin një politikë, bile bëjnë mirë nëse deklarohen haptas, se është punë për ta, por ky është televizion që mbahet me taksa. Ka diçka edhe me të thellë në ...

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Mund të them se sot ju kam marrë lakmi, keni shpëtuar që nuk keni qenë këtu dy orët e para kur ka filluar seanca, se ne kemi hequr goxha, ne që kemi qenë këtu në sallë, se më këta ministrat çka kanë hequr. Mund t'ju them që është hera e tretë që në Kuvendin e Kosovës dëgjohet njëfarë korrelacioni i raporteve të huaja edhe i njerëzve që ju apludojnë. Tani do të thotë, ekziston dikush, në këtë rast po flasim për Raportin e Komisionit Evropian, ekziston dikush në Bruksel që shkruan raport të keq me qëllim për Kosovën dhe këtu në Kosovë ka disa të këqij që i apludojnë Komisionit. E kam thënë një herë, po e them edhe një herë, a mos po ju duket që është një ndërtim i njëfarë korrelacioni shumë të njohur të viteve '70 për armikun e brendshëm dhe armikun e jashtëm. Nuk kemi armik të brendshëm, e nuk kemi as armik të jashtëm, por kemi njerëz që po duan të flasin dhe kemi njerëz që nuk po duan t'i lënë ata njerëz të flasin. Ky është relacioni i armikut të brendshëm dhe i armikut të jashtëm, që partia më e madhe në pushtet po i shpikë që tri herë në Kosovë dhe më vjen keq që po ndodhë kështu.

Tani po i kthehem vetëm pak raportit. Shumë kolegë, po mendoj thanë kolegët para meje diçka, bile, bile më së shumti tha përfaqësuesi i Partisë Demokratike të Kosovës, se i përmendi krejt ato që i thotë raporti dhe aplaudoi për atë punë. Mirëpo, unë po i përmendi edhe disa, disa që me siguri se kanë për t'i përmendur shumë kolegët, me siguri se kanë për t'i përmendur shumë kolegët, por nuk po mundem t'i ikë kësaj pune. Nëse Komisioni Evropian thotë se në Kosovë po cenohet liria e mediave, ata nuk janë armiku i jashtëm dhe nuk ka armik të brendshëm që i aplaudon, po ata po thonë se në Kosovë është kah instalohet në sistem të cilin e kemi përmendur, një sistem tipik totalitar, përndryshe nuk e kishin thënë të jetë kështu. Edhe një përmirësim tjetër duhet bërë unë këtu. Kryeministri tha se është raport i progresit i 10 vjetëve, po më vjen keq që nuk është këtu. Nuk është raporti i progresit të 10 vjetëve, është raport i progresit vjetor dhe krahasimi bëhet prej vitit të kaluar në këtë vit. Nuk flet raporti çka ka mbërri Kosova për 10 vjet, flet çka ka mbërri për 1 vit dhe nëse ka përmirësim në cilindo praktikë, e përmend përmirësimin. Mirëpo, paramendoni ju, në vitin e parë të pavarësisë së Kosovës të ketë degradim të sistemit në liri të mediave, të ketë rritje të korrupsionit, rritje të keq menaxhimit të ndërmarrjeve publike edhe në institucionet e shtetit, shembull ta marrim përmes emërimeve që prapë i përmend Komisioni. A po mendon dikush që ne e kemi armik Komisionin Evropian që po i shkruan këto në letër edhe ne nuk po ekzagjerojmë asnjë fjali të vetme, na vetëm po lexojmë çka ka shkruar Komisioni Evropian në raport edhe fatmirësisht, fatmirësisht, e kemi thënë edhe ne para raportit të Komisionit. Mund të nxirrni transkriptin dhe të shihni që ka njerëz këtu në Parlament të Kosovës që i kanë thënë krejt këto çka i shkruan raporti, i kanë thënë përpara, i kanë thënë në mënyra tjera, mirëpo i kanë thënë.

Tani, kurrë nuk është keq në raport, sikur mos të ishte periudha pas raportit. Edhe kjo është prizmi në të cilin unë dua të ndalem sot pak më shumë. Raporti tregon gjendjen,

tregon se çka ka ndodhur keq, çka ka ndodhur mirë. Mirëpo, sjellja e sotme në Kuvend e kryeministrit të Kosovës, sjellja e Qeverisë së Kosovës në këtë periudhë pas raportit tregon se nuk ka kurrfarë vullneti politik për tu marrë me të. Nuk po do askush të merret me këtë raport. Bile, bile, sistemi kryesor i ndërtuar te ne, çka po ndodhë në këtë sistem, është se nuk është me rëndësi të jetë në rregull, nuk është me rëndësi të luftohet korrupsioni, nuk është me rëndësi të ketë zhvillim ekonomik, nuk është me rëndësi të ketë drejtësi. Me rëndësi është t'duket duk se ka, do me thënë esenca, esenca e punës, esenca e fjalës në Kuvendin e Kosovës po del kështu, Kosova po shndërrohet një vend fals, ku nuk ka asgjë më me rëndësi se të kamuflohet, se të lihet përshtypja se jemi, bile, bile të provohet për ta rrejtur edhe krejt botën se jemi ne, por jo të bëhet. Po e them një fjalë, është e huajtur. Bindja ime e plotë është që, nëse Kosova, e posaçërisht Qeveria, jo drejtësia, Qeveria, jo Kuvendi, Qeveria, nëse Qeveria kishte për të shpenzuar energji edhe mjete për t'u bërë qysh po pretendon të duket, ndoshta edhe kishte pasur përmirësim, por krejt energjia shkon në dukje, në dukje, në kamuflim dhe definitivisht kjo atëherë kthehet në ndjenja të këqija të njerëzve, kthehet edhe në konflikt të brendshëm, edhe në konflikte të këqija, por qe ky është konflikt verbal që ne po themi se është keq, ju po thonë se është mirë.

Tema tjetër është njëfarë përkthimi i asaj çka shkruhet në raport dhe po ju tregoj një bisedë me disa miq, që nuk janë të Kosovës, ata armiq të jashtëm, unë jam armik i brendshëm, ata janë të jashtëm. Dikush thotë, në raport thuhet se ky temp i zhvillimit në Kosovë nuk garanton asgjë të mirë përpos mizërie, pozitë inferiore në krahasim me popujt tjerë, varfëri dhe izolim, jo liberalizim të vizave, izolim e shihni gjendjen qysh është. Ose tjetra thotë kështu: Politikat që po i shohim në Kosovë, politikat që aplikohen në Kosovë garantojnë pakënaqësi dhe frustrim, korrupsion të skajshëm dhe kriminalizim të shoqërisë dhe të institucioneve. Ky është, do të thotë, një konkludim i armikut të jashtëm.

Po kthehem edhe një herë te pika e parë, me të cilën gati sa ja nisa. Mëkati nuk është në atë çka ka ndodhur dhe është shënuar në raport, mëkati i vërtetë është në atë që po ndodhë pas raportit. Shihni buxhetin, a ka një element të buxhetit që i adreson vërejtjet e Komisionit Evropian, a duhet të fuqizohet Zyra për Integritet Evropian ose agjencion ose çka do që e kanë bërë tash Qeveria, a ka buxhet? Nuk ka. Është adresuar çështja në vitin 2008, në vitin 2009 nuk është paraparë buxhet shtesë. Është adresuar çështja në këtë raport, as për vitin 2010 nuk ka buxhet shtesë, do me thënë njëjtë. Çka po bëjmë ne, po flasim, ne kemi bërë, kemi bërë, në praktikë asnjë veprim konkret i vetëm për t'i adresuar çështjet.

Po dua ta përmbyll me çështjen e drejtësisë, që sot disa herë e përmendi kryeministri dhe shumë njerëz e kanë përmendur. Sundimi i ligjit nuk do të thotë vetëm gjyqet. Gjyqet janë në rregull, po prapë nuk shohim veprime buxhetore apo veprime konkrete, por nuk do të thotë po ndalna në diçka tjetër. Sundimi i ligjit edhe ajo çka ka për të kërkuar Unioni Evropian prej nesh, është fillimisht njerëzit të ndihen të barabartë, të ndihen të barabartë, të kenë të drejtë të konkurrojnë të barabartë, qoftë për t'u regjistruar në Universitet pa e pasur dike të njohshëm, qoftë për të hyrë në punë në Qeveri pa e pasur dike njohshëm, qoftë për të konkurruar në tender për të përfutur prej buxhetit të Kosovës pa e pasur dike të njohshëm dhe pa dhënë ryshfet. Ky është një sens i barabarësisë dhe i drejtësisë që gjithkush e lyp prej nesh dhe nëse ju tash e shini këtë raport, nëse ju e shihni Kosovën dhe ne të gjithë veten në pasqyrë, kemi për të konkluduar që jo vetëm që nuk ka përmirësim, ka degradim, por aq më keq që ju thashë këtë mëkatin më të madhin, që nuk ka as vullnet për ta përmirësuar, por ka vetëm

vullnet për ta kamufluar, për të dalë para mediave dhe të thuhet në Kosovë është gjithçka mirë, për të dalë e për të folur një orë këtu, të lexohen lista, lista, lista për të mos pasur debat, e atëherë të thuhet që Qeveria nuk e kontrollon Kuvendin, gabim jeni ju të Unionit Evropian që po na thoni kështu, se nuk është e vërtetë. Po, po, unë sa të dua flas, kamuflim, kamuflim, kamuflim. E përfundova unë me një fjalë që ju kam thënë para një viti e gjysmë. Askënd në botë nuk mundemi ta rrejmë ne, përpos vetveten. Jeni duke e parë në këtë raport që nuk mbërrim ta rrejmë asnjë institucion ndërkombëtar, përpos veten tonë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Për secilin është koha e fjalës. Në emër të AKR-së, kush e kërkon fjalën në emër të grupit? Deputetja Njomëza Emini e ka fjalën.

NJOMZA EMINI: Ju faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Miq deputetë,

Kam kënaqësinë që të flas në emër të Grupit Parlamentar Aleanca Kosova e Re. AKR-ja shpreh mirënjohje të thellë për angazhimin e vazhdueshëm të miqve tanë evropianë për të na ndihmuar në ndërtimin e një perspektive më të mirë për Kosovën. Hartimi i një raportit të progresit periodik na mbanë ne nën tensionin e plotësimit të përditshëm të standardeve evropiane në qeverisje, në institucione, në shoqëri dhe kudo. Në këtë dritë, Aleanca Kosova e Re e sheh edhe raportin e progresit dhe studimin për Kosovën një lloj harte rruge për ecurinë e mëtutjeshme për Kosovën drejt Evropës. Me të gjeturat e veta, raporti nxit zhgënjimin tonë për mos angazhimin e duhur të Qeverisë dhe të institucioneve tona për të përmbushur standardet e integritetit. Çka është më paradoksale, kjo Qeveri merr guximin për të vlerësuar shumë pozitiv dhe historik këtë raport të progresit të Komisionit Evropian për Kosovën.

Gjithashtu, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së duhet të potencoj që Kuvendi i Kosovës duhet të merret më seriozisht rreth Raportit të progresit të Komisionit Evropian dhe gjithashtu duhet ta vë në diskutim këtë çështje menjëherë pas publikimit të raportit dhe jo të presim gati dy muaj, do të thotë, për ta futur në agjendë dhe të arsyetohet kinse me fushatën që ka qenë komunale. Gjithashtu, ne nuk pajtohemi me Qeverinë kur thotë se raporti në fakt, ne pajtohemi me Qeverinë dhe me kryeministrin që thotë ky raport është real, por nuk mund të pajtohemi me asnjë mënyrë kur thotë se raporti i progresit i vlerëson të arriturat, sepse Kosova me këtë qeverisje nuk ka pasur dhe vështirë se do të shënojë arritje thelbësore. Për t'u bindur, ju lutem, vetëm krahasoni raportin e vitit 2008 me raportin 2009. Raportet janë vlerësues të arritjeve apo të dështimeve në hapësirë dhe në kohë, pra janë si gurët kilometrik. Pothuaj se në të gjitha fushat kemi kthim mbrapa. Prandaj, me plotë të drejtë mund ta quajmë edhe raport i regresit.

Më lejoni që të ndalem vetëm në disa pika që Grupi Parlamentar i Aleancës Kosova e Re i ka konsideruar më të rëndësishme për shoqëri dhe që nuk janë, ka pasur më shumë kritika sa u përket sfidave tani që kanë dalë nga raporti. Përkeqësimi i situatës në fushën e demokracisë dhe të sundimit të Ligjit. Qeveria ka dështuar në ngritjen e kapaciteteve për t'i përmbushur obligimet e saj me efikasitet. Ligjet nuk po zbatohen aq sa duhet. Institucionet e pavarura po influencohen nga Qeveria. Janë rritur përpjekjet e Qeverisë për të ndërhyrë në fushën e mediave dhe gjyqësisë dhe si pasojë, këto institucione po dështojnë në kryerjen e obligimeve të tyre ligjore dhe kushtetuese. Në fushën ekonomike, Qeveria ka ndërmarrë hapa konkret dhe adekuat për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik. Papunësia vazhdon të rritet. Tregu gjithnjë është më jostabil dhe jokonkurues. Edhe Kosova vazhdon të mbetet jo atraktive për investimet e huaja.

Si mos të ishte kështu, siç vëren edhe raporti i progresit, Qeveria vazhdon ta ketë një kualitet të ulët të planifikimit të ekzekutimit buxhetor dhe si pasojë po tregohet e paaftë në ndërtimin e një mendimi strategjik afatgjatë në këtë fushë. Mungojnë pothuajse tërësisht politikat sektoriale. Çka do të thotë kjo? Paratë e popullit harxhohen pa planifikim dhe atëherë kur ka planifikim, ai nuk respektohet. As nuk ka kurrfarë mendimi në këto politika. Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar vazhdon vetëm nëpërmjet deklaratave. Do të ishte mirë që përderisa ne patëm durim dhe kohën ta dëgjojmë edhe kryeministrin për paraqitjen e tij me disa të arritura, edhe ai le të na dëgjon neve këtu qëndrimet që i paraqesim dhe që është shtruar, do të thotë, kjo pikë e rendit të ditës me qëllim të vetëm për të plotësuar kriteret apo standardet dhe për të bërë, do të thotë, më të mirën që të ecën Kosova drejt proceseve të integrimi evropiane.

Përballë të këtyre fenomeneve Qeveria po tregohet pasive edhe nuk po ndërmerr hapat e duhur për të siguruar resurset e nevojshme për t'u përballuar me to. Pse, kush e bënë prokurimin publik? Qeveria, pra, ajo duhet të pranojë se jo vetëm që ka dështuar, por është protagoniste e korrupsionit. Raporti kështu duket që thotë, të gjitha këto dështime nuk janë thjeshtë dështime në fushat respektive, por ato ndikojnë edhe në procesin e integritetit të qytetarëve në Evropë, që kalon nga lëvizja e lirë. Aleanca Kosova e Re nuk mund të mos shprehë shqetësimin e saj lidhur me liberalizimin e vizave. Qytetarët e Kosovës, si duket, do të jenë të vetmit në rajon të cilëve u pamundësohet lëvizja e lirë. Vendosja e prioriteteve dhe koordinimi i veprimeve përkundër faktit që ekziston një agjenci e posaçme për këtë punë, vazhdon të jetë brengë e jona. Aleanca Kosova e Re, vlerëson progresin e arritur në disa fusha, por konsideron që ato janë tepër të vogla në krahasim me nevojat dhe standardet e kërkuara nga Unioni Evropian.

Qeveria e Kosovës po dështon të gjejë rrugët për të përshpejtuar integrimin, ndonëse ajo dihet qartësisht cilat është rruga e përmbushjes së kriterit dhe të plotësimit të standardeve nga Unioni Evropian. Përmbushja e standardeve dhe e kriterëve të Unionit Evropian nuk është punë deklarash, ashtu siç po bën kjo Qeveri, por angazhim serioz dhe me punë me shumë përkushtim dhe është e bindur se rruga e integritetit euro-atlantik të Kosovës nuk ka alternativë dhe është në përputhje të plotë me synimet e popullit të Kosovës, për mirëqenie dhe prosperitet në familjen evropiane, aty ku e ka vendin Kosova. Në këtë rrugë, Aleanca Kosova e Re mbetet e përkushtuar për të dhënë kontributin e saj. Andaj, kërkon me ngulm nga Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës që çështjet e ngritura përmes raportit të progresit t'i trajtojë me seriozitet dhe t'i kushtojë vëmendjen që meritojnë për t'i tejkaluar këto sfida. Duhet hartuar një plan masash me afate për t'ju përgjigjur kritikave në mënyrë efektive. Përndryshe, nëse nuk veprojmë kështu, edhe raporti do të dalë më kritik se sa që ka dalë tani dhe Qeveria përsëri do të mburret në mënyrë paradoksale që ky raport ishte realist. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, Naser Rugova e ka fjalën. Ju e keni shfrytëzuar, se Luli ka folur i pari.

NASER RUGOVA: Ju faleminderit, zoti kryetar, ama si prezantues i debatit, do të thotë, unë duhet t'i jap si anëtar i komisionit, në emër të grupit, shkurt.

KRYETARI: Jo, jo, ju e keni kryer. Më fal që unë ta dhashë fjalën, por do të vish si deputet. Në emër të Grupit Parlamentar "7+", kush e do fjalën? Xhezair Murati.

DŽEZAIR MURATI: Hvala, gospodine predsedniče!

Uvaženi zamjenice premijera,
Ministri, kolege.

Evo, danas smo najzad u prilici da malo popričamo o onome što očekuju naši građani da predstavljamo, ali i Evropska zajednica koja već od 2005. godine, vrši permanentnu analizu onoga šta mi radimo, kako se krećemo i tako dalje. Čuli smo izveštaj premijera, čuli smo izveštaje ostalih kolega na putu ispunjenja onoga što se traži od strane naših građana oko ispunjavanja standarda i od Evrope. Mislim da ima nesumnjivog napretka. Sigurno je da kada se uporedimo sa okruženjem, da postoje određeni, ja bih rekao usponi, koji su nesporni i kada je u pitanju ugao gledanja ispunjenja prava ljudskih i manjinskih, ja bih se tu malo više zadržao. Možemo da govorimo po dosta toga šta aje učinjeno, ali isto tako podosta toga šta nije učinjeno. Mi trebamo biti dovoljno realni, ne kritizeri, nego kritičari i činjenica je da ispunjenje manjinskih prava spada u vrlo važne segmente ispunjenja kriterijuma koje traži Evropska unija od nove mlade države Kosova.

Kada su u pitanju zajednice kosovske, sigurno je da ima napretka u tome kako zajednice žele da se integrišu, da se pozitivno integrišu u kosovsku državu, ali tu postoji jedna tanka nit izmedju onoga što je integracija i asimilacija. Ja bih rekao da ima podosta propusta kada su u pitanju ova dva fenomena o kojima sam govorio. Kada se govori o prvim manjina, nezaobilazan je problem obrazovanja koji je fundament, koji je baza osnova opstojanja i perspektive jedne manjinske zajednice. U tom pogledu, sigurno je da imamo primedaba. Već dugo govorimo o udžbenicima. Ako su to osnovno sredstvo da se oni obrazuju, ja mogu ovde da ponovim po ne znam po koji puta da udžbenici su, ovaj naša zajednica, to je nesporno, zahteva udžbenike po kosovskim planovima i programima, učinili smo mnogo toga kada je u pitanju bio i kurikulum i izrada i tako dalje i tako dalje, ali kada je u pitanju prevodjenje, tu se nismo mnogo pomakli. Prevodi su veoma loši iz predmeta prirodnih nauka, dalje nedostaju udžbenici za srednje škole. Lutamo oko smerova na fakultetima, stvaramo počesće nepotrebno hiper produkciju kadrova manjinskih zajednica zato što sporo vršimo preusmeravanja nekih smerova i tako dalje. Dalje, ja bih rekao da kada su u pitanju izdavanja ličnih dokumenata, ličnih karata, pasoša, još uvek kasanimo, upozoravamo i nailazimo na različita tumačenja. Zakon o službenim dokumentima i o ravnopravnosti jezika se tumači ad-hoc prema situacijama. Kada je službeni i kada je jezik u upotrebi, ima tu dosta nerazumevanja, pogotovo kada je u pitanju turska zajednica, koju ja predstavljam ovom prilikom ispred parlamentarene grupe, kada je u pitanju bosanski jezik, kada je izdavanje dokumenata službenih, vrlo često se ne izdaju na jezicima manjinskih zajednica, i vrlo često nailazimo na primedbe u sredinama gde žive manjinske zajednice. Tako da to su činjenice i mi nemamo šta da ih prikrivamo, ovim ne želimo da stavljamo tovar na nejaka kosovska ledja, ali je činjenica da imamo i subjektivnih promašaja u toj oblasti, tako da moramo brže to da rešavamo.

Kada je u pitanju, gospodo, pristup službenim dokumentima, postoji zakon o tome, ali ga nema, ne sprovodi se, jer mi veoma često se hvalimo koliko smo zakona doneli, a mi ne znamo da je to u potpunom raskoraku kako te zakone implementirati, kako ih sprovesti. Nije isto usvojiti ovde zakon ili neku komisiju, i sutra ona ostane na papiru. Isto to govorim kada je u pitanju Zakon o zaštiti kulturnog nasledja. Ne možemo mi da štitimo kulturno kulturno nasledje samo jedne zajednice, imaju i ostale zajednice kulturno nasledje i mislim da moramo da vodimo računa o tome. Dalje, gospodo, kada je u pitanju javni servis RTK, mi znamo neki zahtev medjunarodne zajednice od 15% vremena za manjinske zajednice. Mi ni blizu tog procenta nismo. Govorimo o drugom kanalu, njega nema. Govorimo o ukidanju TV pretplate, umesto da govorimo o tome

kako signal da se upotpuni, odnosno realizuje na prostoru gde žive manjinske zajednice. Nema signala RTK, pa moraju predstavnici manjina da primaju informacije iz okruženja, i o kakvoj to integraciji govorimo. Naš narod misli, zadovoljan je, uspeli smo TV pretplatu da izdvojimo iz računa struje. Ne, naš je krajni cilj da imamo radiotelevizijski signal Kosova kako bi građani manjinskih zajednica mogli da prate ovu sednicu i da vide šta to njihov jedan predstavnik govori u institucijama Kosova, a ne kada odemo negde, nemaju pojma šta mi govorimo i sasvim nam insinuiraju i podmeću neke druge sadržaje kojima se mi ovde bavimo, ne znam ovakve ili onakve sadržine i tako dalje.

Gospodo, ja bih ovde još jedan problem naveo, koji tišti manjinske zajednice. Naime, veoma često se dešava da se na radna mesta u obrazovanju manjinskih zajednica zapošljavaju predstavnici većinske zajednice. To je jedan non sens, koji mi ne možemo olako preko toga da predjemo. Ukazujemo to kod lokalnih organa, u ministarstvu i tako dalje, rešiće se, sporo ide. Učešće predstavnika u upravnim organima škola ili stručnim organima nastavničkih veća, razrednih veća ne održavaju se sastanci na jezicima manjinskih zajednica. Mislím, dosta je vremena prošlo, nismo hteli da ovaj problem politizujemo, ali je evidentno da on postoji i da ga treba rešavati. Dobijamo često razna rešenja, građani ne razumeju, a zna se po zakonu koji su zvanični jezici i tako dalje.

I, sasvim pri kraju, ja bih rekao da problem reforme lokalne uprave i problem decentralizacije ovde na Kosovu od strane međunarodnih predstavnika se ne tretira jednako za sve zajednice. Nekima se daju ustupci, i to uveliko ustupci i nove opštine, nekima se to do neudogled baca neka nada i ljudi gube strpljenje. Bošnjačka zajednica je najbrojnija nakon srpske od manjinskih na Kosovu. Nema nijednu još uvek ni na vidiku, ni jednu opštinu u kojoj, gde ona čini prema Ahtisarijem dokumentu ispunjava uslove, kriterijume i tako dalje. Tako da, ja sada da ne bude previše kritičnosti, ja sam danas govorio o propustima, a prihvatom sve što je pozitivno. I sam sam dao doprinos kao član potpredsedniku Komisije za evropske integracije u radu ovde sa subjektom, sa zajednicom i tako dalje, ali i mi prihvatamo izveštaj. Mi ćemo dati svoj doprinos, ali smo protiv toga da se sa nekim stvarima toliko razvlači, odugovlači i da nekada samo iz nekih dekorativnih razloga nekima bacamo prašinu u oči, a suštinske stvari nisu ni na domaku. Mi kao Parlamentarna grupa „7+“ prihvatamo izveštaj, ali us dopune o kojima govorimo i uz malo veću i brižniju, ja bih rekao, brigu o onome što se zove, što se zovu ljudska i manjinska prava, jer stalno govorimo o Kosovu kao multietničkoj državi. Ja se nadam da će takva i zaživeti, ali ako se prava manjinskih zajednica ovako sporo rešavaju, u pitanju je koliko će taj segment biti ostvarljiv. Hvala vam!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, nuk ka. A e doni një pauzë, apo po vazhdojmë. Vazhdojmë, dakord, edhe unë jam me juve. Sipas radhës, do të thotë, të gjitha grupet u kryen. Mirë, ju faleminderit! Deputetja Zusan Novobrdali e ka fjalën.

SUZAN NOVOBRDALI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Grupi Parlamentar i AKR-së e ka analizuar me kujdes të veçantë Raportin e regresit për Kosovën të hartuar nga Komisioni Evropian. E kemi quajtur raport i regresit, sepse po të analizohen me kujdes dallimet e këtij raporti me atë të parafundit, edhe ju do ta quani i regresit, se kemi një regres në zhvillimet demokratike në vend, regres që e gjejmë pothuaj në çdo kapitull. Në raport kemi aq shumë top fjalësh të përdorura, si ka keqbesim, çështje shqetësuese, duhet shumë angazhime, akoma nuk janë plotësuar e

shumë të tjera si këto. Po ua citoj një paragraf në faqen 8: “Situata e sigurisë në Veri mbetet shqetësuese. Qeveria duhet forcuar përpjekjet e saj në këtë drejtim”. Menjëherë në faqen 9, shkruan: “Ka pasur ndërhyrje politike në emërime të zyrtare, në pozitat kuqe të shërbimit civil, përfshirë pozitat e larta brenda ministrive, bordeve të ndërmarrjeve publike. Kjo ka dëmtuar kredibilitetin e institucioneve të Kosovës për të menaxhuar procesin e emërimeve në mënyrë të drejtë dhe transparente”. Duke vazhduar më tej, ndërhyrjet politike në emërime të larta, mbeten çështje shqetësuese. Vërejtjet janë bërë edhe në drejtim të korrupsionit. Edhe pse u bënë gati dy vite që nga shpallja e pavarësisë dhe ardhjes së misionit EULEX, akoma nuk kemi shenja në luftën ndaj korrupsionit. Në çdo takim me ndërkombëtarët na përsëritet kërkesa, ju lutem, luftojeni korrupsionin! Edhe në këtë raport, në faqen 12 shkruan: Sidoqoftë, korniza ligjore për adresimin e korrupsionit, duhet të përmirësohet urgjentisht. Kosova ende duhet të miratojë Ligjin mbi deklarin dhe kontrollin e pasurisë dhe ndryshimet e Ligjit antikorrupsion dhe ato të Ligjit mbi konfliktin e interesave. Deri me tani nuk ka ligj mbi financimin e partive politike. Fuqia e mekanizmave mbikëqyrës dhe mungesa e transparencës në lidhje me financimin e partive politike, mbetin çështje me shqetësim serioz. Korniza institucionale mbetet e fragmentuar. Ekziston mungesë e bashkëpunimit në mes të akterëve relevantë, sidomos në mes të agjencisë dhe zyrës së prokurorit. Grupi punues ndërministror për antikorrupsion ka dështuar në dhënien e rezultateve të prekshme. Në tërësi ka pasur progres të kufizuar në luftën kundër korrupsionit, që është për prioritet kyç i partneritetit evropian. Korrupsioni mbetet i përhapur në shumë fusha në Kosovë dhe vazhdon të jetë një shqetësim shumë serioz. Vërtet, nuk ka vend dhe fushë ku nuk ka vërejtje, por si opozitare jam e obliguar të them një gjë pozitive që përmendet në raport e që ka progres, siç është arsimi. Këtu meriton një respekt të veçantë ministri i Arsimit Enver Hoxhaj. Por, po të lexohen me vëmendje dhe shumë kapituj, ku është rritur regresi në Kosovë, siç janë: mungesa e theksuar e shprehjes së lirë, sidomos ndikimi politik në RTK, zbatimi i vogël i Ligjit për qasje në dokumente zyrtare dhe ajo që është vërtetë shqetësuese, është edhe kërcënimi politik i medieve, pa përmendur këtu sundimin e dobët të ligjit, që vazhdon të mbetet pengesë kryesore për zhvillimin socio-ekonomik. Një ndër vërejtjet po ashtu serioze është edhe përdorimi i buxhetit të Kosovës në funksion të fushatës elektorale. Në faqe 27 shkruan: Buxheti 2009, ka qenë i ndikuar nga agjenda elektorale dhe ka vazhduar rritjet në pagat publike, që për pasojë ka shtyrë në prishjen e rregullit fiskal, sikur është paraqitur në kornizën afatmesme të shpenzimeve.

Për fund, më lejoni të përmend edhe një regres, regres me të cilin të dy partitë në pushtet po i mbushin xhepat, pra, tenderët. Nuk është habi pse këto dy parti kritikohen në raport, sepse po t'i shikoni vetëm fushatat e tyre elektorale, do të shihni sepse Komisioni Evropian ka pasur të drejtë. Në faqen 37, për sa i përket prokurimit, situata është keqësuar në krahasim me vitin e kaluar. Kështu thotë raporti. Zyrtarët e prokurimit në Kosovë mbeten akoma të penguar dhe të frikësuar. Ky fakt ka një ndikim negativ në kualitetin e prokurimit publik. Krejt në fund, po i drejtoj disa pyetje në drejtim të këtij koalicioni. Kur kosovarët do të lëvizin pa viza në Evropë, si gjithë rajoni, e nuk do të mbyten bjeshkëve apo lumenjve nëpër kufi?! Kur kosovarët do të hiqen nga listat e zeza? Kur kosovarët do të kenë sundimin e ligjit? Kolegë deputetë, kjo nuk është Kosova për të cilën u flijuan brezat e tërë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju lutem, mund ta merrni fjalën dhe të replikoni, të diskutoni dhe mos u përzieni në debat. Bëhuni të durueshëm të dëgjoni edhe atë tjetrin që ka mendim të kundërt. Kjo mendoj është diçka elementare për deputetin. Keni respekt! Mirë, ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Gani Geci.

GANI GECI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kur flasim për Raportin e progresit, nuk kemi qare pa u ndalë në faqen 51, 52, 53, 54, 55 dhe 56, që kanë të bëjnë me drejtësinë, lirinë, sigurinë, shpëlarjen e parave, narkotikët, policinë, luftimin e krimit të organizuar dhe me problemin e Mitrovicës.

Të nderuar deputetë,

I nderuari kryetar,

Kur flasim për luftimin e krimit të organizuar, Raporti i progresit kërkon adresim të krimit të organizuar dhe unë po ju them para juve, unë kam fakte për ta adresuar krimin e organizuar.

Zoti kryetar,

Kam një besim të veçantë për punën dyvjeçare për ju edhe si burrë shteti, edhe si kryetar i Kuvendit të Kosovës. Andaj, kërkoj nga ju një mbrojtje institucionale për mua personalisht, sepse unë do ta adresoj krimin e organizuar me fakte, jo pa fakte. Ju e dini, të nderuar deputetë, se asnjëherë në Kuvendin e Kosovës nuk e kam marrë fjalën për të folur pa fakte. Prandaj, po them se në këtë Kuvend ka deputetë që kanë dhënë urdhra për të vrarë deputetë të tjerë. Me fakte, kam faktet. Në këtë Kuvend ka ministra e zëvendësministra që kanë dhënë urdhra për të vrarë deputetë të tjerë. Me fakte prapë. I nderuar kryetar, nuk jeni ju, as zoti kryeministër nuk është ai që ka dhënë urdhra, por ka në Kabinetin qeveritar burra që kanë dhënë urdhra për të vrarë deputetë, kolegët tanë që tani janë deputetë dhe po i përmend me emra. Kanë dhënë urdhra për za vrarë zotin Agim Veliu, kanë dhënë urdhra për ta vrarë zotin Adem Salihaj dhe unë kam fakte, unë kam dëshmi, dëshmi që mund t'i argumentoj në çdo kohë dhe nuk mund të ketë progres nëse në Kuvendin e Kosovës, nëse Qeverinë e Republikës së Kosovës janë të involvuar kriminelët që kanë dhënë urdhra për të vrarë kolegë. Në të njëjtën kohë ata kanë dhënë urdhra edhe për të vrarë udbashë, por i kanë përzier patriotët me udbashët, që ka qenë gjëja më e shëmtuar e Kosovës së pasluftës.

KRYETARI: Gani, me gjithë respektin, por realisht të gjitha këto nëse ke fakte, i dërgon në Prokurori e jo në foltoren e Parlamentit.

GANI GECI: Jo, nuk po e shfrytëzoj në parlament foltoren, por po e shfrytëzoj realitetin. Nëse ju jeni i interesuar t'i shihni dëshmitë, jepni urdhër regjisë dhe unë i kam të filmuara. Jepni urdhër regjisë dhe të shohin të gjithë deputetët e Kosovës, e gjithë Qeveria dhe i gjithë populli i Kosovës faktet që unë i kam. Ju e dini që unë nuk falas pa fakte, sikur mos të kisha fakte, nuk do të dilja këtu.

I nderuari kryetar,

Kam respekt të veçantë si burrë i Kosovës, si burrë shteti dhe kërkoj mbrojtje nga ti, sepse në hierarkinë institucionale të kam kryetar vetëm ty. Po them, në hierarkinë institucionale të kam kryetar vetëm ty, sepse unë njohë hierarkinë, unë e njoh Kuvendin e Kuvendin e Kosovës, njoh kryetarin e Kuvendin, njoh kryeministrin dhe presidentin. Kam njohur gjithmonë institucionet e Kosovës edhe më herët, kam njohur institucionet edhe gjatë luftës, sepse me institucione krijohet shteti.

I nderuar kryetar,

Nuk mund të shkojmë në Evropë me këso probleme, nuk mund të shkojmë në Evropë absolutisht me kriminelë brenda. Unë kërkoj nga kryeministri i Republikës së Kosovës që të fillojë spastrimin nga vetja vetë dhe nga të gjithë ata në të gjitha partitë politike. Po spastrim jashtë institucional, po institucional, duke denoncuar krimin te prokuroria dhe

këto fakte që po i them unë, i ka edhe prokuroria. Kërkoj nga Prokuroria e Kosovës dhe nga Prokuroria e EULEX-it që sa më parë që është e mundshme të fut në funksion arrestimin e kriminelëve, arrestimin e urdhërdhënësve dhe arrestimin e vrasësve. Grupet kriminele

KRYETARI: Gani, nuk je në rend të ditës, të lutem!

GANI GECI: ...shumë në rend të ditës. Ju lutem, zoti kryetar, në faqen 53 flitet për krimin e organizuar dhe krimi i organizuar duhet të fillojë të luftohet prej nesh. Po e them këtë sinqerisht, duke e mbuluar me fakte, me argumente të mjaftueshme, të bollshme, me dëshmi të gjalla, me dëshmi, se pa dëshmi s'e kisha marrë kurrë, s'e kam marrë fjalën asnjëherë që 2 vjet, sepse s'kam pasur dëshmi. Këto dëshmi i kam para zgjedhjeve. Nuk kam dashur t'i bëj publike këto dëshmi përpara zgjedhjeve, sepse nuk kam dashur ta pengoj procesin e zgjedhjeve në Kosovë, sepse unë dua të jem pjesë e procesit të zhvillimit të Kosovës, pjesë e procesit të integritetit të Kosovës. Po, nëse denoncoj krimin me argumente, unë nuk po bëj një gjë të keqe, unë po e bëj atë që do ta bënte secili deputetë dhe, ju lutem, edhe për këtë e kam marrë votën, nuk jam votuar unë nga qytetarët e Kosovës që të hesht krimin, që të hesht padrejtësinë, po të flas. Prandaj, unë zoti kryetar, po them edhe një herë, do të kërkoj zyrtarisht nga ju personalisht që të takohemi dhe të shqyrtojmë me hierarkinë institucionale problemet që unë po i adresoj. Këto probleme që i kam adresuar, i kanë adresuar te tjerët jo unë, sepse unë nuk mbrojtë udhëbës. Unë nuk kam mbrojtur kurrë dhe nuk mbrojtë kurrë spiunët e cilitdo shtet. Por unë mbrojtë shtetin e Kosovës dhe do ta mbrojtë shtetin e Kosovës, sepse jam i votuar ta mbrojtë shtetin e Kosovës dhe jam i një hierarkie familjare ta mbrojtë këtë shtet sepse është i ri.

Prandaj, zoti kryetar,...

KRYETARI: Kthehu në rend të ditës!

GANI GECI: ...e kam informuar kryeministrin, e kam informuar tërthorazi, në hierarkinë institucionale kryeministrin për këto probleme që po i adresoj.

Zoti kryetar,

Raporti i progresit kërkon adresim të krimit dhe, unë, nëse po bëj ndonjë mëkat, ju lutem më ndërprisni!

KRYETARI: Jo, jo, po këto gjëra thashë i çon në prokurori, është çështje e..., ne si Kuvend s'jemi për ato gjëra.

GANI GECI: Prandaj po them, kërkoj nga prokuroria dhe kërkoj nga ju, zoti kryetar, një mbrojtje sepse unë te prokurori s'po guxoj të shkoj, se një herë më kanë vra, m'i kanë vra edhe do shokë. Prandaj, po kërkoj një mbrojtje prej jush, që kur të shkoj unë te prokurori, ju të më mbronin me institucionet e Parlamentit të Kosovës, me hierarkinë e institucionale si kryetar i Kuvendit.

Të nderuar deputetë,

Në raport thuhet se Kosova nuk ka strategji për luftimin e krimit. Zyra e prokurorit, të nderuar deputetë, thuhet në raport se ka nënshkruar një memorandum me Drejtorinë e Antimafias në Itali. Ju lutem, a jep të kuptohet kjo se në Kosovë ka mafë. Nëse nënshkruhet një dokument, një memorandum me Zyrën ose me Drejtorinë e Antimafias,

në Kosovë paska mafi dhe kriminelë. Andaj, ky dokument nuk është formalizuar ende, thuhet në raport.

Zoti Kryetar, të nderuar deputetë,

Zoti kryeministër tha se kam në plan luftën e krimit të organizuar, andaj unë po kërkoj institucionalisht ta luftojmë krimin, t'ia fillojmë nga vetja, sepse nëse s'e luftojmë krimin, nuk na i çelin dyert për të hyrë në Evropë. Nuk na i çelin dyert, sepse jemi vendi i vetëm që i kemi dyert e mbyllura ende, sepse jemi vendi i vetëm në Evropën Luglindore, si një shtet i ri, që nuk po na mundësohet as nënshkrimi i dokumenteve fillestare. Si po mendojmë ne të hyjmë në Evropë, kur te ne, kur në vendin tonë ekziston në hierarkinë institucionale krim dhe urdhërdhënësia.

Zoti Kryetar, unë pas kësaj mbledhjeje kërkoj një takim me ju, për ta adresuar krimin, se unë s'mund të shkoj në prokurori, se unë jam deputet, unë të falem vetëm ty si kryetar, vetëm ty të kam kryetar të Kuvendit dhe unë në këtë rast nuk kam as kryetar partie sepse unë, zoti kryetar, jam deputet i zgjedhur dhe, ju lutem, nëse unë s'kam dëshmi, kërkoj të dënohem para ligjit. Nëse unë s'kam argumente, kërkoj që prokuroria që sot të nisë një iniciativë hetimore kundër meje, para ligjit. Por, të njëjtën kohë kërkoj nga Prokuroria e Kosovës, Prokuroria e EULEX-it që të nisë që tani një hetim, sepse kanë fakte, jo që ua kam çua unë, por ua kanë çuar ata që m'i kanë dhënë mua, të hetojë vrasësit, kriminelët dhe të hetojë ata që patriotët e mëdhenj i kanë bashkuar me udbashët, udbashët që kanë penguar integritet e Kosovës, që kanë penguar Kosovën për vite të tëra dhe kanë çuar mijëra qytetarë të Kosovës në burg. Nuk i mbroj unë ata, s'i kam mbrojtur kurrë, s'do t'i mbroj kurrë. Por, përzierja e udbashëve me patriotët e mëdhenj dhe vrasja e tyre ose tentim-vrasja e tyre e ka shkatërruar Kosovën e pas luftës dhe e ka lënë Kosovën mbrapa në integritet evropiane. Andaj, të nderuar deputetë, unë nëse kryetari është në pajtim, nëse ju të nderuar jeni në pajtim, kërkoj nga ju një votim formal që dokumentin që e kam unë të adresuar për krimin e organizuar, që kryetari i Kuvendit të Kosovës t'i thotë regjisë që ne ta shikojmë së bashku dhe qytetarët e Kosovës, se unë nuk jam spiun i askujt, por jam deputet i votuar me votë. Nëse ju e apromoni me votën tuaj që ta shohin të gjithë se kush është kriminel dhe kush është viktimë atëherë unë jam ai që

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Unë kisha thënë që materialin ta çosh në prokurori, por vërtet ne s'mund të shndërrohem në gjykatore, si Kuvend, dhe kjo që u keqpërdor, konsideroj se u keqpërdor foltoja për një rend të ditës, unë s'kam gjë kundër që të gjithë ata që kanë përgjegjësi të përgjigjen para drejtësisë dhe drejtësia të funksionojë. Unë mendoj, kisha kërkuar nga ju, të nderuar deputetë, unë e kam përgjegjësinë e kryetarit të Kuvendit, e kemi një dokument, në fakt dy dokumente, edhe dokumentin e komisionit, që në fakt janë tri për të debatuar, për të diskutuar dhe për t'i bërë disa rekomandime, por realisht kështu siç ia kemi nisur ne të mohojmë gjithçka.... Unë e di që Kosova ka probleme, por të mohohen sukseset që janë arritur gjatë këtyre 10 viteve prej qershorit '99 e këndeje, mendoj se është e tepërt dhe kjo mund të ndodhë diku tjetër që nuk e do Kosovën me shqiptarët, por realisht shqiptarët vetë nuk mendoj që mund dhe duhet të flasin me këtë gjuhë. Ne duhet të flasim me gjuhën që na takon dhe për këtë, të lajmëruar për diskutim janë 36 vetë, andaj unë e kisha shpallur pauzën deri në ora 14:00 Urdhëro, Lutfi Haziri e ka kërkuar fjalën, në emër të Grupit.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, kryetar!
Zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar deputetë,

Deputeti, kolegu ynë ka krijuar një rrethanë të re sot. Nuk mund të injorohet fakti, është deputet, është njeri i zgjedhur, ka përgjegjësi ndaj fjalës publike dhe ka imunitet për fjalën e tij.

Duke qenë dëshmitar dhe pjesë e dhunës politike në Kosovë pas luftës, ne nuk mund ta injorojmë faktin. Ne kërkojmë një komision ad-hoc, i përzier nga të gjitha grupet parlamentare, ta sheh dëshminë, në prani të kryetarit të Kuvendit, të organeve tjera ose të gjendet rrugë për të proceduar, sepse ky fakt që u soll sot në publik, nuk na lë neve të sillemi komod, sikur nuk ka ndodhur asgjë. Edhe nëse ajo dëshmi nuk qëndron, ka kapacitete Policia e Kosovës të dëshmojë, kapacitete të teknologjisë, ka kapacitete profesionale të dëshmojë.

Kërkesa e parë që deputeti Geci të vendoset në mbrojtje shtetërore, duhet të aprovohet unanimisht, që policia për mbrojtje nga afër duhet ta marrë nën mbrojtje dhe, nën dy, kjo çështje vërtet të hyjë në procedurë, sepse do të duhej të kemi qëndrim politik. Në të kundërtën, ne sot u solidarizuar me dhunën ndaj gruas, ndaj familjes. Sot na doli në ditën e solidarizimit për dhunë në familje, na doli problemi kryesor që Kosova është ballafaquar me dhunën politike që e kemi përballuar, e kemi përballuar, por ajo që ka ndodhur, nuk kalon pa u vërejtur. Dy njerëz nga radhët e grupit të deputetëve të LDK-së janë gjallë se zoti i ka shpëtuar, u përmend njëri prej tyre me emër, të tjerët nuk janë, por ju lus ta marrim me gjakftohtësi, nuk janë këto materiale për publikun. Këto materiale janë për brenda objektit, ku institucionet e shohin dhe e vlerësojnë se si duhet të shkojmë. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Dokumentet janë për prokurori, ne i kemi ndërtuar institucionet dhe secili institucion e ka rrugën e vet. Jo, jo, nuk është për votim, ne e kemi rendin e ditës dhe punojmë, vazhdojmë me rendin e ditës. Një pauzë deri në orën 14:15 minuta.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë, vazhdojmë seancën. Në sallë janë 52 deputetë, po ju e dini se me 1/3 mund të filloj debati, sipas Rregullores së Punës së Kuvendit.

Fjalën e ka Ramë Buja, në emër të Grupit ka diçka...

RAMË BUJA: I nderuar zoti kryetar!

Të nderuar ministra, që keni mbetur këtu,

Të respektuar kolegë deputetë,

Unë ju them në emër të Grupit që jam shumë i shqetësuar për një fakt që ndodhi pak më parë në Kuvendin e Kosovës. Me gjithë respektin për Gani Gecin, për shqetësimet e tij, jam absolutisht mbështetës i asaj që krimi të dënohet, të ndëshkohet, paraprakisht të zbulohet dhe të goditet, por jo nga institucionet politike, kur s'e ka për detyrë, as s'është prokurori, as s'është gjyqësi, as s'është hetuesi, as s'është forenzikë, andaj kërkoj nga kolegu im i nderuar dhe nga të gjithë deputetët që dikush u dëgjua si zë që të votojmë për mbrojtje të hapur të Ganiut apo të dikujt tjetër, që ta bëjmë si votim në Kuvend. Jam absolutisht kundër kësaj, jam absolutisht pro asaj që kushdo që ka nevojë për kërkesë për mbrojtje të afërt, të bëjë kërkesën. Unë nuk e besoj që ka ndodhur ndonjëherë që është

ofruar kërkesa.... dhe nuk i është bërë, por edhe një herë po them që foltorja e Kuvendit asnjëherë të mos shpërdoret për gjëra të tilla, por sinqerisht do ta ketë mbështetjen time kurdoherë në çdo situatë, kushdo qoftë ai, që ka bërë të zeza për Kosovën, të zbulohet dhe të ndëshkohet. Andaj, i lus kolegët të gjithë, paraprakisht dhe fillimisht Gani Gecin që foltorja të shfrytëzohet për debate politike, për rendin e ditës të caktuar, por jo në asnjë mënyrë për të hedhur, po e them kushtimisht, deri sa nuk është sqaruar, gjer sa nuk është sqaruar, megjull, sepse kjo sjell vetëm të keqe. Unë e lus Ganiun që krejt ato materiale t'i përcjell në prokurori dhe pastaj të merret edhe instanca më e lartë e zbulimit të këtyre gjërave, të merret forenzika me to dhe ne këtu të ndëshkojmë dhe dënojmë politikisht, por të jemi insistues që të gjitha insistacionet shtetërore të Republikës së Kosovës, ato që janë përgjegjëse të merren me këto gjëra dhe ne t'i pastrojmë këto, qofshin ata njerëz edhe të afërt familjarë tonët, le të ndëshkohen sepse meriton të ndëshkohet secili që bën krimin dhe meriton të zbardhet ajo që quhet Kosovë dhe që kemi bërë shumë për të, kemi investuar shumë për të bashkë dhe, ju lus, që ne të mos e bëjmë Kuvendin as ta shpërdorim duke bërë as gjyqësi, as prokurori, as instancë tjetër.

Unë kërkoj që kjo gjë të kapërcehet, ato gjëra që i kërkoi Ganiu të shkojnë në vendin e duhur dhe ne të vazhdojmë debatin për gjërat të cilat e kemi caktuar sot në pikën e rendit të ditës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Lutfi Haziri e ka fjalën!

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë po e përsëris edhe një herë atë që e thashë edhe në fjalën time të parë. Natyrisht se Grupi Parlamentar i LDK-së në vazhden e kërkesave për ta dënuar krimin, për ta zbardhur, për ta dënuar dhe denoncuar, mbështet deklaratën politike të Kuvendit, një deklaratë e cila fton institucionet relevante që merren me hetime, prej Prokurorisë së Kosovës, Prokurorisë Speciale, EULEX-it dhe institucioneve tjera që të merren me të gjitha krimet politike dhe krimet ekonomike, në mënyrë që të ndihmohet zbardhja e tyre dhe të ndihmohet demokratizimi i vendit deri në fund.

Natyrisht që ne e mbështesim deklaratën dhe si grupe të përbashkëta parlamentare duhet të punojmë deri në fund, t'i ofrojmë edhe mbrojtje institucionale kërkesës së deputetit në fjalë dhe mbrojtje që shteti i garanton secilit njeri i cili në këto raste ka nevojë për raste të tilla. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë seancën. Në emër të grupit? Urdhëro, Lulzim Zeneli e ka fjalën.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti kryetar!

Ju njoftoj se Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, gjatë pauzës që patëm pak më parë mbajtëm takimin e rregullt dhe ajo çka mund të thuhet tash se ne vetëm kemi formuluar qëndrimet tona sa i përket situatës që është krijuar dhe të gjitha këto qëndrime do t'i procedohen kryetarit të Kuvendit, kryetarit të Kosovës dhe kryeministrit. Prandaj, duke qenë në përputhje të plotë me rendin e ditës, deputetët e Grupit parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë do të marrin pjesë në debat aktivisht me rendin e ditës që sot e kemi përpara. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Prej AAK-së, a e do dikush fjalën? Jo. Prej AKR-së? Jo. Faleminderit!

Edhe ne jemi dakord që, vërtet, kush çka ka, le t'ia dorëzojë hetuesisë dhe gjyqësia le të merren me to. Ne i mbështesim. Ne si Kuvend kemi bërë ligje. Ne si Kuvend e mbështesim funksionimin e sistemit të drejtësisë dhe i mbështesim në punën e tyre për të vendosur rendin dhe ligjin, për të vendosur sundimin e ligjit në Kosovë. Kjo është politikisht përgjegjësi e jona. Përgjegjësia praktike është e organeve të drejtësisë, prandaj mendoj që Parlamentit t'ia kthemi detyrat dhe përgjegjësitë që i ka dhe organeve tjera detyrat dhe përgjegjësitë që i kanë. Fjalën e ka deputetja Edita Tahiri. S'është! Ramadan Avdiu e pati fjalën, pse u tërhoqe ti? S'do! Mirë. Emrush Xhemajli! Jo, e ke tërhequr, se ke qenë i pari, e ke prekur butonin dhe është shlyer këtu.

EMRUSH XHEMAJLI: Zoti kryetar, faleminderit!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Perspektiva evropiane e Kosovës është e qartë që disa vite dhe kur e përmendim këtë, nuk mund të quhet diçka e re ose ndonjë rezultat i punës kohëve të fundit. Ne këtu po flasim për shkurtimin e kohës që sa më shpejt të ndodhë që vendi ynë të hyjë në Bashkimin Evropian dhe kështu mund të ndodhë vetëm pasi institucionet e Kosovës, Kuvendi, Qeveria, Presidenca, ministritë, agjencionet, mediat të punojnë në të njëjtin drejtim, duke u dëshmuar në vepër se rruga evropiane është qëllim i përbashkët i të gjitha partive politike të Kosovës dhe i gjitha institucioneve. Raporti i progresit për vitin 2009 i Këshillit të Evropës është një skanim i saktë i gjendjes ku është Kosova dhe ajo në të gjitha fushat është ende shumë larg nga plotësimi i standardeve që kërkohen. Nëse dikur mosplotësimi i standardeve arsyetohej me mungesën e statusit, unë besoj këtu i kemi parasysh kujtimet nga koha e standardeve para statusit kur ish kryeadministratori Shtainer, të cilit në atë kohë i ishin më tepër këto standarde si ushtrime shkollore, tani nuk mund të ketë asnjë justifikim për institucionet tona që të plotësohen sa më parë të gjitha kriteret që kërkohen për paanshmërinë, për anëtarësimin e vendit tonë në BE.

KRYETARI: Rendi i ditës është debati për raportin....

EMRUSH XHEMAJLI: Për raportin, për atë jam duke folur...

KRYETARI: ... koncentrohuni në raportin dhe përpikuni të mos bëni veç fjalime politike, por mundohuni të jeni më konkret.

EMRUSH XHEMAJLI: Kosova është mbetur larg standardeve të nevojshme të BE-së për të gjitha temat që trajtohen në Raportin e progresit. Me këtë formacion ministror e kanë parë të gjithë, e ka parë edhe Këshilli i Evropës që nuk ka mundësi të arrihen këto. Andaj, ju e dini shumë mirë se është propozuar prej Këshillit të Evropës, që e ka mbështetur edhe Qeveria, është kërkuar edhe prej partive politike tjera që të bëhet Ministria për Integritet. Edhe kjo është një mundësi për t'u fokusuar më mirë çështja të cilën ne po e trajtojmë sot sepse, mos të harrojmë, ne e dimë shumë mirë qysh trajtohen temat të cilat janë përshkruar këtu në Raportin e progresit. Ta marrim çështjen e liberalizimit të vizave. Për të gjitha vendet e Ballkanit dhe vendet e ndryshme që dëshirojnë të aderojnë në BE dhe të liberalizohen vizat janë shtrua detyra krejtësisht të njëjta, mirëpo ne e dimë se ka vende që këto i kanë plotësuar standardet për atë, ka vende që nuk kanë mundur. Në mesin e atyre që nuk kanë mundur t'i plotësojnë të gjitha kushtet për liberalizimin e vizave është Kosova. Kush e di për së afërmi këtë problematikë, e di shumë mirë se kjo ka ardhur si rrjedhim që nuk është bërë sistemi i kontrollit të integruar të kufijve, nuk janë bërë pasaportat biometrike, domethënë nuk janë krye ato punë që kanë dashur të kryhen. Dhe, disa prej nesh që e dimë hala më për së

afërmi, nëpër komisione që kemi qenë, e dimë se sa herë që është kërkuar prej zyrtarëve të Kuvendit, prej ministrive përkatëse që t'i kryejnë këto detyra, kanë thënë se do të punojmë, po gjithmonë pa kurrfarë specifike për kohën, pa kurrfarë dinamike të kohës, kështu që gjithmonë është thënë se jemi duke punuar në atë drejtim sikurse të ishin zyrtarët e Kuvendit të Kosovës, deputetë sikur të ishin gazetarë edhe zyrtarët e ministrive, sikurse të ishin duke u përgjigjur para gazetarëve. Edhe në këtë mënyrë shumë mirë e ka parë Komisioni i Bashkimit Evropian se me këtë formë të punës nuk ka mundësi që të plotësohen standardet. Prandaj, unë po shpresoj që me krijimin e Ministrisë për integritet këto punë do të përshpejtohen dhe kisha për të thënë dhe kisha dëshiruar që mos të ndodhë sikurse me agjencionet dhe bordet që në pa kufi zgjatet formimi i tyre, po kjo të ndodhë sa më shpejt. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ramadan Avdiu e ka fjalën, le të përgatitet Sanije Aliaj.

RAMADAN AVDIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë Raportin e progresit të Komisionit Evropian nuk mund ta shoh të shkëputur nga raportet që bëhet për vendet në regjion. Duhet pasur parasysh se Kosova është vendi i fundit në regjion, i cili ka filluar domethënë me procesin e integriteteve evropiane, që nga krijimi i mekanizmit përcjellës për stabilizim-asocim e deri te fillimi i raportimit për gjendjen në Kosovë. Raporti aktual nëse krahasohet me raportin e vitit të kaluar shihet që ka avancime në Kosovë. Vetëm me një fjali, domethënë në të gjitha fushat në Raportin e vitit 2008 thuhet se është arritur njëfarë progresi apo nuk është bërë fare progres, kurse këtu në shumë fusha theksohet se është arritur progres i theksuar gjatë këtij viti, prandaj kjo është inkurajuese edhe për institucionet e Kosovës dhe se shihet që është vërtet një raport relativisht objektiv për arsye se sidomos të çështja e figurave, e shifrave nuk ka objektivitet. Kjo ka qenë një vërejtje e jona edhe në raportin e vitit të kaluar, sepse dihet që nga Kosova nuk janë mbi 200.000 të zhvendosur, por janë më pak.

Sidoqoftë, edhe lidhur me bashkëpunimin në rajon do të duhej theksuar se përkundër insistimeve dhe përpjekjeve të mëdha të institucioneve të Kosovës, ka pengesa relativisht të mëdha qoftë në shkëmbimin e mallrave, qoftë në pjesëmarrjen në forumet dhe organizatat regjionale. Kjo sigurisht që nuk do të mungojnë përpjekjet e Qeverisë, të Ministrisë së Punëve të Jashtme që të jetë më e integruar në mekanizmat regjionalë. Në përgjithësi, ne do të duhej si Kuvend që të inkurajojmë Qeverinë që të vazhdojë me progresin e arritur deri më tash, por edhe mekanizmat tjerë të vendit do të duhej që t'i inkurajojmë që të thellojnë luftën kundër korrupsionit, krimit të organizuar, informalitetit në ekonomi dhe të thellojnë reformën e administratës publike, veçanërisht do të duhej të përqendrohet në sferat ku akoma konsiderohet se nuk është arritur progres, për shembull, në rrafshin e pronës intelektuale shihet që nuk është arritur akoma asnjë progres, nuk është kompletuar akoma korniza ligjore dhe në këtë drejtim do të duhej të përqendrohen institucionet më shumë në mënyrë që në ato fusha ku akoma nuk ka pasur mundësi që të ketë lëvizje pozitive, të përqendrohemi më shumë edhe në ruajtjen e ambientit.

Meqë e kam fjalën, do të dëshiroja që lidhur me debatin paraparak vetëm të theksoj se është shumë mirë që është krijuar një korrelacion në mes të Prishtinës dhe Brukselit dhe ky korrelacion është në agjendë të përbashkët sepse dihet tashmë qëndrimi i Komisionit Evropian për të ardhmen e Kosovës, ka një vendosmëri dhe një konsensus i plotë që e ardhmja dhe perspektiva e Kosovës është integriteti i saj në Evropë, por nuk duhet harruar akoma sfidat që ne nuk mundemi ta ndjekim hapin me vendet tjera për arsye se jemi më të ngecur mbrapa, por veçanërisht ka edhe probleme tjera të mosnjohja e shtetit të

Kosovës nga 5 vende anëtare të Bashkimit Evropian, është një sfidë e veçantë në të cilën do të duhej që ta inkurajojmë Qeverinë dhe gjithashtu edhe miqtë tanë ndërkombëtarë që t'i shtojnë përpjekjet në mënyrë që të tejkalohet kjo pengesë, sepse është thuaja se pengesë e patejkalueshme për t'u futur në mekanizimin e procesit të stabilizim- asociimit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Këtu u shlye emri i Sanije Aliajt, deputetes! Mirë, shtype butonin! Fjalën e ka deputetja Sanije Aliaj. Jo, më parë ishte në rend, pse s'po funksionon teknika, këta emrat janë në rend. Më parë ishte, në fillim e para ishte.

SANIJE ALIAJ: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Ministra dhe kolegë deputetë,

Është shumë e qartë se Raporti i progresit të Komisionit Evropian për vitin 2009 për Kosovën obligon institucionet e Kosovës në 3 shtylla të shtetit për efikasitet në punë dhe transparencë më të madhe për realizimin e synimeve për integritet evropian, por edhe për integritet global në përgjithësi. Në këtë raport prezantohen sa janë synimet tona në hap me kohën dhe në nivelin e kërkuar. Raporti prezanton përparimin e arritur bazuar në vendimet e marra, legjislacionin e aprovuar dhe masat e ndërmarra për të vendosur rend dhe rregull në njërin anë, por në anën tjetër Raporti i progresit ka nxjerrë sfida të shumta për institucionet e Kosovës dhe mekanizmat veprues të këtyre institucioneve që duhet plotësuar për arritjen e standardeve bashkëkohore të kërkuara nga Bashkimi Evropian. Natyrisht se obligimet që dalin nga raporti nuk janë vetëm punë për t'i plotësuar standardet, por edhe punë për përmirësimin e jetës në Kosovë. Prandaj, raporti është real dhe udhërrëfyes se ku duhet fokusuar prioritetet dhe po qe se realizohen rekomandimet e ofruara nga Komisioni Evropian në këtë raport, shumë shpejt Kosova do t'i ketë dyert e hapura në Bashkimin Evropian. Në kuadër të këtij debati, unë do të fokusohem në rolin e Parlamentit dhe të Qeverisë në fushat më të rëndësishme, shtetin ligjor, zhvillimin ekonomik, të drejtat e njeriut dhe lëvizjen e lirë të mallrave. Në çdo kapitull të këtij raporti, kërkohet të plotësohet infrastruktura ligjore me ligje konkrete në harmoni me ligjet e BE-së, por rekomandim për Parlamentin në tërë raportin është fokusimi në mbikëqyrjen dhe kontrollin e Qeverisë sa po zbaton ligjet dhe sa po i përmbush standardet e kërkuara.

Rekomandim kryesor i Komisionit evropian është sundimi i ligjit si kusht për evitimin e dukurive të parregullta në Kosovë. Në Kosovë një prej sfidave kryesore është zhvillimi ekonomik, i cili është bazë e stabilitetit të vendit, por edhe kusht për luftimin e dukurive që po e dëmtojnë shoqërinë tonë. Edhe në raport, por edhe në realitetin që ne jetojmë, është e ditur se investimet në sektorin privat kanë pësuar rënie si pasojë e mos investimeve të huaja direkte dhe të ngecjes së privatizimit dhe të krizës globale.

Në kapitullin – Lëvizja e lirë e mallrave, ka përparime në fushën e akreditimit dhe të mbrojtjes së konsumatorit sa i përket anës ligjore, por kapacitetet administrative janë të pamjaftueshme për zbatimin e standardeve dhe mungon strategjia për mbrojtjen e prodhuesit dhe të konsumatorit. Tregu është jo stabil dhe jo konkurrues. Me këtë rast po i drejtohem Qeverisë dhe më shumë ndërkombëtarëve, se ne jemi për lëvizje të lirë dhe qarkullim të lirë të mallrave, synim kemi ekonominë e tregut të lirë, por jo për lëvizjen e pa kontrolluar as të mallrave e as të qytetarëve, se i hapen dyert të keqes. Në veri të Kosovës nuk kemi regjim kufitar, mund të hyjë kush të dojë dhe të veprojë si të dojë, hynë mallra të pakontrolluara. Qeveria dhe EULEX-i duhet të rrisin përkushtimin në atë pjesë të Kosovës edhe pse ky përkushtim edhe tani nuk mungon.

Edhe për kundër miratimit të disa ligjeve për luftimin e korrupsionit dhe të mekanizmave për luftimin e tij, në raport është vlerësimi se ka pasur progres të kufizuar në luftën kundër korrupsionit, që është prioritet kyç i partneritetit evropian. Korrupsioni vazhdon të jetë shqetësim serioz. Këtë deputetët, por edhe qytetarët e Kosovës e kanë të njohur edhe nga raporti i agjencisë kundër korrupsionit, si pasojë se nuk është në nivelin e duhur bashkëpunimi i Zyrës së Prokurorisë dhe Agjencisë kundër korrupsionit për luftimin e korrupsionit dhe denoncimin e personave të korrumpuar. Në fushën e të drejtave të grave është përfaqësimi i barabartë, mbetet një sfidë në të gjitha nivelet, gjë që është edhe angazhim serioz i Bordit të grave deputete për të ndërruar këtë realitet në masën e dëshiruar. Natyrisht, gjë që shqetëson është në këtë drejtim, duhet edhe angazhim dhe përkujdesje institucionale për këto kategori. Të drejtat e fëmijëve edhe përkundër legjislacionit të mjaftueshëm, po shkelen. Në çdo cep të rrugëve shihen fëmijë që shtrijnë dorën për të mbijetuar. Konsideroj se me një plan të veprimit duhet këta fëmijë të orientohen drejt ardhmërisë, është sfidë për Ministrinë e Arsimit dhe Ministrinë për Punë dhe Mirëqenie sociale.

Këto ishin disa vërejtje të mia në këtë raport. Konsideroj se pas miratimit të Planit të veprimit të Komisionit për Integritet Evropian, që e kemi në disponim nga Komisioni për Integritet Evropian dhe një përkushtim i institucioneve për zbatimin e këtij ligji, raporti i ardhshëm për vitin e ardhshëm kalendarik do të jetë pozitiv, Raporti i progresit të Komisionit Evropian. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Unë po ju tregoj, të lajmëruar janë 31, me siguri del edhe ndonjë, dalin edhe më shumë. Nëse jeni dakord, kishim shkua në 5 minuta. Jo. Unë mendoj që 5 minuta janë mjaft, po nëse doni, shkojmë 10 minuta, po atëherë duhet të shkojë më gjatë. Në rregull, janë 32, unë jam i 33-ti dhe unë do t'i marr 10 minuta, po pak më vonë. Atëherë, vazhdojmë me 10 minuta, unë kam durim t'ju dëgjoj, por atëherë duhet të keni durim edhe ju. Fjalën e ka Ethem Çeku, me kartelë të Bajram Kosumit. Fjala e deputetit Bajram Kosumi, do të thotë u ndërruan Bajrami me Ethemin.

BAJRAM KOSUMI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Për Raportin e progresit është folur edhe para se të publikohet në opinionin publik, kështu që kemi pasur mundësinë të krijojmë një përshtypje qysh po pranohet dhe qysh po perceptohet raporti edhe para se të vijë në diskutim në Kuvend. Sot e dëgjova me vëmendje edhe fjalën e kryeministrit, qysh e ka perceptuar ai dhe Qeveria dhe qysh e pranon këtë raport. Dhe, fillimisht më duhet të them se në politikë nuk je ai që dëshiron të jesh, por je ai qysh të perceptojnë të tjerët. Raporti i progresit është perceptim, perceptim nga prizmi evropian i proceseve në Kosovë, është një lloj pasqyre e asaj çka ndodh në Kosovë, është një skaner i asaj çka është në Kosovë dhe në këtë drejtim unë i përshëndes vetëm për këtë punë ata që e kanë bërë raportin në Komisionin Evropian dhe vetë raportin, se raporti është i pamëshirshëm në kuptimin se i thotë të zezës e zezë dhe të bardhës i thotë e bardhë. Unë e falënderoj Komisionin Evropian që ka bërë një raport të tillë, që mund të na nxisë neve që e kemi pak vështirë, klasa politike në Kosovë t'i themi të zezës e zezë e të bardhës e bardhë. E falënderoj që na nxit të diskutojmë për realitetin tonë ashtu çfarë është.

Tema e parë për të cilën dua të flas në lidhje me raportin, ka të bëjë me trajtimin e çështjeve dhe të proceseve të Kosovës në raport. Ekziston përshtypja se ky raport flet ekskluzivisht vetëm për afrimin e standardeve të Kosovës me Bashkimin Evropian. Edhe

unë do të dëshiroja të ishte ashtu, të gjithë dëshirojmë që të jetë ashtu. E vërteta është se në raport shfaqen dy nivele të gjykimit, dy nivele të kualifikimit të proceseve. Niveli i parë ka të bëjë me funksionalitetin e institucioneve, s'ka të bëjë kurrgjë me standardet evropiane. Niveli i parë në raport flet a janë të afta institucionet e Kosovës ta kryejnë obligimin e tyre ligjor. Këto janë standarde të Kosovës, s'kanë të bëjnë me Bashkimin Evropian dhe kualifikimi i Komisionit Evropian për këtë nivel është jo gjithmonë i mirë. Gati në çdo faqe gjen – ky institucion nuk është i përgatitur sa duhet, ky institucion s'ka potenciale, e tjera, e tjera.

Unë po marr një shembull për ta dëshmuar këtë. Në faqen 36, kur flet për Ligjin e prokurimit publik, Komisioni Evropian e vlerëson dy herë Ligjin e prokurimit publik. Një herë e thotë – ky ligj nuk është në përputhje me standardet evropiane, herën e dytë thotë – edhe ashtu çfarë është, ky ligj nuk implementohet në praktikë. Janë dy vlerësime, do të thotë. Vlerësimin e parë do ta ktheja ndryshe. Vlerësimi i parë është se ky ligj, i mirë i keq, ashtu qysh është, nuk implmentohet, do të thotë shkelet. Ndërsa vlerësimi i dytë është se ky ligj edhe i tillë është ende larg standardeve evropiane. Ose një shembull tjetër, faqe 51, po e citoj vetëm një fjali, po e marr shembull Institutin e Statistikave të Kosovës, rastësisht do të thotë, për të gjitha institucionet është fjala një soj. Kështu thotë: “Zyra e statistikave akoma nuk është në gjendje për të prodhuar statistika ekonomike të mjaftueshme për të ndihmuar politikbërjen efektive”. Kjo është çështja themelore. Do të thotë, një institucion, rastësisht e mora shembull Institutin e Statistikave, nuk është në gjendje ta kryejë qëllimin e vet kushtetues për çka është formuar, e të mos flasim tash për përafrim me standardet evropiane. Do të thotë, unë po dua t'i theksoj këto dy nivele të gjykimit të Komisionit Evropian, sepse rrjedhimisht dalin dy punë që duhet t'i bëjë Qeveria dhe institucionet tjera në Kosovë:

Nën një, duhet t'i fuqizojmë institucionet tona, duhet t'i shtojmë kapacitetet brenda institucioneve, duhet t'i aftësojmë institucionet tona për t'i përmbushur qëllimet kushtetuese dhe ligjore, sepse ende nuk i kanë arritur ato. Do të thotë, ne kemi një ent statistikor, ne kemi një ministri, ne kemi një qeveri, ne kemi një kuvend, por të gjitha këto institucione ende nuk kanë arritur të përmbushin qëllimin kushtetues për çka janë formuar. Vetëm pasi të arrijmë këtë, të përmbushim qëllimet tona, obligimet tona kushtetuese, vetëm atëherë mund të mendojmë, hajt të shikojmë tash cili standard është larg standardeve evropiane në mënyrë që të përafrohemi.

Tema e dytë, për të cilën dua të diskutoj është kontrolli. Në Raportin e progresit, në disa faqe, nuk po i përmendi të gjitha tash, nuk po citoj, por në disa faqe flitet se ekzekutivi, Qeveria ka futur në darët e kontrollit shumë mekanizma nga jeta institucionale në Kosovë, në mënyrë diku më ashpër diku më but, por Qeveria akuzohet se ndërhyr në shërbimin civil të Kosovës, ndërhyr në borde të ndërmarrjeve publike, ndërhyr në media, ndërhyr në gjykata, madje edhe në Kuvendin e Kosovës e tjera, e tjera. Nuk është kjo një akuzë thjeshtë politike. Ky vlerësim ka të bëjë ose me mentalitetin politik të klasës politike në Kosovë dhe tash edhe të partive në Qeveri, ose ka të bëjë me vizionin politik. Nëse është mentalitet politik që me të shtrihen duart, të kontrollohet gjithçka në shoqëri, vaj halli për shoqërinë tonë, por nëse është vizion politik, atëherë dy herë vaj halli për shoqërinë tonë. Është keq, ku s'ka ku shkon më tej. Ndoshta mund të jetë një..., mund të shërbejë ky kontroll si mekanizëm për stabilitet politik, por gabohen të gjithë ata që mendojnë se duke i futur në kontroll të gjitha strukturat e shoqërisë, mund të prodhojnë stabilitet. Është e kundërta dhe historia ka dëshmuar disa herë që rritja e kontrollit, futja në kontroll e mekanizmave të shoqërisë nuk e stabilizon shoqërinë, por përkundrazi e çon drejt pëlcitjes, drejt eksplodimit. Prandaj, nuk mund të pajtohem si deputet, si politikan, si

njeri i Kosovës me këtë koncept të tillë qeverisë, me tendencë për t'i futur në kontroll të gjitha strukturat e shoqërisë. Madje tash po bëj një degresion edhe për Kuvendin këtu, edhe atë që e kërkoj pak më herët kryetari i nderuar shkurtimin në 5 minuta, nuk i kontribuon krijimit të kësaj demokracie. Jo një herë, buxheti i Kosovës kur diskutohet, buxheti i Qeverisë është çështja më themelore pse ekziston ky Kuvend. Diskutimi kërkohet dhe voton Kuvendi, kryetari kërkon, por Kuvendi voton që të shkurtohet debati në 5 minuta. Është, do të thotë, një diçka thelbësore që nuk është kah funksionon mirë në demokracinë tonë në Kosovë.

Kjo demokraci e kontrolluar, po dal tash jashtë Kuvendit, kjo demokraci e kontrolluar në zhargonin politik ka filluar të quhet Putin – demokracia, demokraci sipas standardit Putin. Kosova nuk e meriton asnjë prej neve që jemi këtu, as Qeveria, as opozita, asnjë qytetar i Kosovës për shumë arsye, ka shumë arsye, nuk e meriton as t'i ngjajë, e lëre më të imitohet, por as t'i përngjajë asnjë grimë Putin-demokracisë. Dhe, unë shpresoj se kjo është vetëm një shfaqje e përkohshme, që nuk mund të zë vend në politikën tonë.

Çështja e tretë dhe e fundit për të cilën dëshiroj të diskutoj, është korrupsioni. Është një prej çështjeve shumë interesante, është krijuar miti për korrupsionin në Kosovë, është një prej temave për të cilën është krijuar një retorikë e veçantë në fjalorin e politikës kosovare. Dhe, krejt ajo që është bërë në lidhje me korrupsionin, është thjeshtë një retorikë, është thjeshtë një fjalë. Kryeministri thotë – zero tolerancë për krimin dhe besoj se zgjedhjet janë fituar edhe mbi këtë koncept – mos tolerancë për krimin, ndërsa në fakt, në Raport të progresit ka kualifikime dhe ka vlerësime të kundërta. Jo që është luftuar me sukses kundër korrupsionit, më falni korrupsioni, por ka degradim, ka rënie, ka shtim të korrupsionit. Ligji i prokurimit publik, që është baza ku mund të kontrollohet korrupsioni dhe të gjenerojë korrupsionin, ka degradim, ka keqësim të situatës...

KRYETARI: Faleminderit! Faleminderit, shumë! Sa i përket diskutimit, i nderuari deputet Bajram Kosumi, mund të them që në Parlamentin Evropian, para një kohe që kemi qenë, i kemi pas filluar debatet me 5 minuta, por në fund na i kanë dhënë vetëm nga 1 minutë të flasim. Unë bile 5, nuk po ua zbres 1 minutë, por në 5 po ua lë. Mandej, Kuvendi e ka votuar atë, çka të bëhet. Po vazhdojmë. Fjalën e ka deputetja Qamile Morina, le të përgatitet Muzejene Selmani.

QAMILE MORINA: Faleminderit, zoti kryetar!

Ministra,

Deputetë të nderuar,

Ka dy vite që miqtë tanë ndërkombëtarë që na u drejtuan neve në këtë Kuvend dhe qytetarëve të Kosovës na siguruan se dera e Evropës mbahet e hapur për ne, por edhe na treguan se, në fund të fundit, pushteti është në duart tuaja, që do të thotë që vizioni, përkushtimi dhe vendimet e institucioneve tona do të përcaktojnë shpejtësinë e udhëtimit tonë në Bashkimin Evropian. Dhe, çka ndodh me Raportin e progresit? Raporti i progresit po na tregon se rruga jonë drejt Bashkimit Evropian është shumë e gjatë dhe fare jo e lehtë. Ajo thelbësorja që duhet kuptuar drejt dhe qartë nga institucionet tona, është se Raporti i progresit identifikon problemet serioze të funksionimit të shtetit tonë. Në këtë raport shprehen pakënaqësi të ngjashme me ato të vitit të kaluar, si dhe fatkeqësisht është bërë praktikë që raportet e progresit gjatë këtyre viteve të mbesin vetëm të tilla, të interpretohen, debatohen dhe shumë pak punohen.

Sa u përket kritereve politike në fushën e demokracisë dhe të sundimit të ligjit, në mbrojtjen e të drejtave njerëzore situata në Kosovë është përkeqësuar nga viti 2007.

Raporti i progresit nënvizon problemet rreth implementimit të ligjit, pavarësisë së institucioneve nga influenca e tepruar e Qeverisë dhe kapacitetet e dobëta brenda institucioneve. Jemi dëshmitarë se si u zgjodhën shumë borde të ndërmarrjeve publike, pozitat e larta brenda ministrive dhe ajo më eklatantja – zgjedhja e Gjykatës Kushtetuese në këtë Kuvend.

Themelimi i një tregu ekonomik funksional ka shënuar shumë pak progres me kalimin e viteve. Në vitin 2009 jo balancimi i madh tregtar, largimi prej privatizimit drejt investimeve kapitale, si stimulues për rritje ekonomike, duke përfshirë zhvillime shqetësuese në fushën e prokurimit dhe niveli i lartë i papunësisë, sidomos i atij të rinisë, kanë zbehur edhe më shumë progresin ekonomik të Kosovës. Papunësia e lartë dhe pa perspektiva e rinisë tonë, që çdo ditë e më shumë po kërkon shtigje jashtë Kosovës, duhet të jetë brengë për institucionet tona dhe për shoqërinë tonë. Fuqia e Kosovës duhet të jetë tek rinia e saj, kurse koalicioni qeverisës shumë pak po bën në zhvillimin e mëtutjeshëm të potencialit ekonomik të të rinjve në Kosovë. Është tejet jo serioze dhe pa përgjegjësi e Qeverisë mos zgjedhja e dy anëtarëve të Bordit mbikëqyrës të Agjencisë Kosovare të Pronave, që është dashur të emërohen para dy viteve, si dhe mungesa e zgjedhjes së gjyqtarit vendor që po e paralizon punën e panelit. Kjo ka pasur reperkusione të rënda për qytetarët e Mitrovicës, ngase nga viti 2007 Agjencia nuk ka mund të bëjë asnjë lirim të pronës në pjesën veriore të Mitrovicës, ku kryesisht janë të uzurpuara pronat e shqiptarëve. Aso kohe kanë qenë të evidentuara 389 prona të shqiptarëve në veri. Zoti kryeministër nuk është këtu, mirëpo deputetë të nderuar, gjëja më e vogël që duhej të ishte bërë nga zoti kryeministër për këta qytetarë të Mitrovicës, ka qenë që të aktivizojë punën e këtij paneli me zgjedhjen e dy anëtarëve të Bordit dhe të gjyqtarit vendor, që do të mbronin interesat e këtyre qytetarëve.

Sa i përket sistemit shëndetësor sipas raportit të progresit persiston status-kuo që anon kah regresioni. Indikatorët shëndetësorë po persistojnë si më të ulët në Evropë. Infrastruktura shëndetësore, duke përfshirë pajisjet mjekësore, furnizimin me barna, janë të një niveli të dobët. Në përgjithësi, sektori shëndetësor është në nivel të dobët dhe kërkon urgjentisht vëmendjen e autoriteteve. Këto janë vlerësime të Raportit të progresit, që nuk është zoti ministër këtu, që fare nuk dallojnë nga vërejtjet dhe deklaratimet tona të mëparshme.

Zoti ministër pati premtuar këtu në Kuvend vitin e kaluar që shëndetësia do të jetë prioritet kombëtar dhe reformën e sistemit shëndetësor do ta bëjë me konsensus gjithëpërfshirës. Të gjithë tani e kemi të qartë se shëndetësia nuk është prioritet për këtë koalicion qeverisës dhe fare nuk shihet në horizont se ju jeni duke përgatitur një strategji me plan të reformimit të sistemit shëndetësor me një konsensus gjithëpërfshirës me grupet e interesit që do t'ia paraqitni Kuvendit për miratim. Çdo prolongim i kësaj gjendje të rëndë në shëndetësi do të ketë impakte afatgjate dhe vështirë të riparueshme në të ardhmen në shëndetësinë kosovare.

Korrupsioni po mbetet i përhapur dhe autoritetet kosovare kritikohen për mosangazhim të mjaftueshëm në luftën kundër korrupsionit, krimit të organizuar dhe shpëlarjes së parave. Deputetë të nderuar, çelësi i frymimit të Kosovës së lirë demokratike dhe prosperuese mbetet lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Sipas këtij dokumenti, autoritetet kosovare nuk kanë strategji se si ta luftojnë krimin e organizuar dhe korrupsionin. Gjithashtu, sistemi gjyqësor sipas raportit ka mangësi të mëdha. Kosova nuk ka Ligj të punës dhe nuk ka gjykata të specializuara për çështjet e punës. Punësimi dhe politikat sociale mbeten si pikat më të dobëta të funksionimit të institucioneve të

Kosovës, e çmimin për këtë po e paguajnë qytetarët e Kosovës. Situata rreth prokurimit është përkeqësuar, krahasuar me vitin paraprak dhe implementimi i Ligjit mbi prokurimin publik në praktikë ngre shqetësime serioze. Nëse vendit tonë i shkon çdo e katërta euro në prokurim publik, e që janë taksat e qytetarëve tonë, atëherë shtrohet pyetja se a e ka përmirësuar ky prokurim publik në të vërtetë jetën e qytetarëve. Andaj, koalicioni qeverisës, si bartës kryesor i detyrave të dala nga Raporti i progresit, nuk i ka përmbushur detyrat e tij përkundër deklarimeve të vazhdueshme se përmbushja e kërkesave të procesit të integritetit evropian është në qendër të angazhimeve të tij. Fatkeqësisht, e tëra po mbetet në deklarime boshe.

Në fund, Raportin e progresit 2009 duhet ta kuptojmë me seriozitetin maksimal dhe problemet e identifikuara në të koalicioni qeverisës t'i pranojë si detyra jo vetëm si sfida dhe mos t'i vë në funksion të politikës ditore. Vetëm një angazhim i sinqertë dhe me përkushtim në zbatimin e reformave të thella, e shpeshherë të dhimbshme, mund të bëjnë procesin e integritetit evropian të Kosovës sa më afër suksesit. Faleminderit!

KRYETARI: Ibrahim Makolli e ka kërkuar fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Propozoj, për derisa është festë fetare sonte dhe nesër, po edhe e flamurit është, propozoj që kjo seancë të ndërpritet dhe t'i vazhdojë punimet javën e ardhshme. Është propozim i Grupit Parlamentar të AKR-së, që besoj se mbështetet edhe prej deputetëve tjerë.

KRYETARI: Ramë Buja, e ka fjalën.

RAMË BUJA: Më pëlqeu, kryetar, që respektive shefin e Grupit Parlamentar të opozitës, edhe pse ne pozitaret kërkuam, por nuk na përfille. Domethënë, ne e mbështetëm shefin e Grupit Parlamentar të AKR-së që seancën ta shtyjmë për ditën e martë. Faleminderit!

KRYETARI: Lutfi? Aleanca? Po!

Atëherë, po shkojmë në votim. Kush është për të vazhduar seanca të martën në ora 10:00. Kërkesa është për të martën, mocionin unë s'e ndryshoj. Faleminderit! Kush është "kundër"? Kjo paraqitje nuk vlen, duhet rishtas, pasi po e lëmë për të martën, edhe renditja e diskutuesve bëhet prej fillimit. Vazhdojmë, pra, të martën, veç pak më ndryshe se sot le të jetë!

Vazhdimi i seancës plenare

E enjte, më 3.12. 2009, ora 10:00

Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuari kryeministër, zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar, Vazhdojmë me punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar më 26 nëntor 2009. Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 63 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për punë.

Vazhdojmë me debatin për Raportin e Komisionit Evropian për progresin në Kosovë për vitin 2009, sipas kërkesës së Komisionit për Integritet Evropian dhe të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë.

Urdhëro, deputeti Ramë Buja.

RAMË BUJA: I nderuari zoti kryetar,
I nderuar zoti kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,
Kolegë të nderuar deputetë,

Unë kam një kërkesë në emër të Grupit Parlamentar dhe të 46 deputetëve, në fakt edhe të grupeve të tjera, që sot ne në orën 14,00 të mbajmë një seancë të jashtëzakonshme, meqë është situata e jashtëzakonshme e sigurisë në Kosovë dhe opinioni qytetarë i Kosovës është terrorizuar që sa kohë. Këtu kemi kërkuar ne që të mos bëhet debat i këtillë i kësaj natyre më herët në Kuvend, këto gjëra që janë përfolur me disqe, ç'disqe të shkojnë në organet e drejtësisë, atje të bëhet puna dhe pastaj, nëse ka nevojë, ne mund të flasim, por është bërë si është bërë dhe është e domosdoshme që opinionin, duke kërkuar falje, ta ngarkojmë edhe pak, por për të sqaruar gjërat që janë të domosdoshme për t'i sqaruar.

Prandaj, unë kam një kërkesë këtu që sot, në orën 14:00, të mbahet seanca e jashtëzakonshme. Janë nënshkruar 46 deputetë dhe janë të gjitha kushtet e plotësuara legale, andaj unë kërkoj që kjo kërkesë e jona dhe e 45 të tjerëve të realizohet e të plotësohet dhe sot ta realizojmë seancën e jashtëzakonshme. Faleminderit!

KRYETARI: Jo, unë jam i obliguar t'ju njoftoj që Kryesia e ka pasur sot, do të thotë, pak përpara e kemi pasur në shqyrtim kërkesën e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike dhe të 46 deputetëve, do të thotë, janë më shumë se sa që ka deputetë Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike dhe, realisht, bisedimet kanë qenë, ne kemi tentuar që të marrim vendim me konsensus, nuk kemi arritur konsensus se s'kemi votuar për mbajtjen e seancës sot. Kemi qenë të mendimit që mos të ketë seancë të jashtëzakonshme, të jetë seancë e rregullt dhe me mundësi të mbahet të shtunën, por sot të vazhdojë seanca e rregullt, siç e kemi në rend të ditës. Ky është qëndrimi i Kryesisë së Kuvendit, ku kanë qenë shumica e anëtarëve të Kryesisë.

Rregullorja nuk e përcakton, rendin e ditës e përcakton, do të thotë, e bën Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

(Reagime nga salla)

Unë ju njoftova me vendimin, do të thotë, me qëndrimin e Kryesisë së Kuvendit. Urdhëro, Ramë, por shkurt.

RAMË BUJA: Nuk e kam zakon të flas gjatë, sepse fjalët e gjata janë fukarallëk. Por, po ju them që 41 nënshkrim, më nuk përfill as Kryesia askënd. Është çështje e përplotësuar legalisht dhe me rregullore që seanca duhet të mbahet në ditën e sotme, në orën 14:00, sepse është kërkesë e 46 deputetëve, jo 41 as 40.

KRYETARI: Faleminderit! Faleminderit, për 46 nënshkrimet. Ne vazhdojmë seancën dhe në fund të seancës mund të deklarohet Kuvendi, do të thotë unë tjetër rrugëdalje nuk di. Urdhëro, Lutfi Haziri e ka fjalën.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Kryeministër,
Grupi Parlamentar i LDK-së pas njoftimit me vendimin e ri të Kryesisë, ne e mbështesim qëndrimin e Kryesisë së Kuvendit.

KRYETARI: Në emër të AAK-së, a e do dikush fjalën? Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, kryetar!

Ne mendojmë se, ashtu siç e tha në fillim zoti Ramë Buja, janë çështje të drejtësisë, drejtësia duhet të merret me këtë çështje. Nuk mendojmë se debati do t'i ndihmojë drejtësisë dhe nuk jemi të interesuar të marrim pjesë në debat në këtë fazë, i cili vetëm sa ka për t'i komplikuar çështjet edhe më tepër dhe ka për të ndërhyrë drejtpërdrejt në punën e gjyqësorit.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të AKR-së, deputeti Ibrahim Gashi.

IBRAHIM GASHI: Faleminderit, zoti kryetar!

Grupi parlamentar i AKR-së nuk ka ndonjë qëndrim për momentin, ndërkaq mbështet qëndrimin e Kryesisë për një seancë të rregullt për këtë çështje. Natyrisht, në parim ne nuk kemi qenë që Parlamenti të shfrytëzohet për debate të tilla, që nuk na taktojnë shumë neve, sepse ne asnjëherë s'mund të japim fjalën e fundit për to, por këtë mund ta jep vetëm drejtësia. Kemi qenë mbase edhe për një seancë të mbyllur, mirëpo meqë ka disponim që kjo të bëhet, ne e mbështesim qëndrimin e Kryesisë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, deputeti Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti kryetar!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë ka shprehur qëndrimin e vet edhe në takimin e Kryesisë dhe mbi ato pikëpamje Grupi ynë mbështet qëndrimin e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar "7+", a do dikush fjalën? Jo. Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, jo. Urdhëro, Ramë.

RAMË BUJA: Kryetar, unë nuk e di kush po heziton dhe kush po i frikësohet këtij debati gjersa ne jemi meta dhe të goditurit. Duhet të sqarohen këto gjëra dhe duhet të sqarohen pa pasur nevojë për përgatitje enkas, sepse jemi përgatitur e terrorizuar që një javë ditë me gjëra, shpifje, gënjeshtër, trillime, insinuata dhe atë më të ulëtat të mundshme.

Ju lus, nëse nuk bëhet këtu votimi, unë ju lus për një pauzë 15 minutëshe dhe pastaj nuk ka mundësi të vazhdojë seanca normale, kur ne jemi shënjestër e të gjitha goditjeve të mundshme, më të ulëtat që mund t'i ketë opinioni qytetarë.

(Reagime nga salla)

KRYETARI: Ju lutem, vazhdojmë me seancën dhe ndërkohë grupet parlamentare le të diskutojnë dhe të merren vesh. Unë mendoj, ne të vazhdojmë me seancën.

Atëherë, 10 minuta pushim.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI: Vazhdojmë. Deputeti Ramë Buja e ka fjalën, 50 deputetë janë në sallë.

RAMË BUJA: I nderuari zoti kryetar,

Ne në Grupin Parlamentar u dakorduam që meqë disponimi i tillë ose indisponimi është që të mos zhvillohet debat, e kjo është keq, keq për opinion qytetarë për faktin që kjo gjë është bërë për fushatë dhe nuk do të duhej të bëhej kështu dhe kjo fushatë nuk ka zgjatur më pak se 10 vjet, kur njerëzit janë terrorizuar në forma të ndryshme, por e lëmë këtë. Kemi insistuar gjithmonë që politika të ndahet nga gjyqësori dhe nuk është bërë dhe përsëri kërkojmë dhe vazhdojmë të kërkojmë vazhdimisht. Dhe, meqë është kështu puna, atëherë ne nuk duam assesi që këtë debat ta shtimë në kohën e fushatës. Nesër fillon fushata për balotazhin dhe në asnjë mënyrë nuk do të ishte as logjike, as politike, as korrekte e as e arsyeshme që të bëhet. Debat i për këtë gjë nuk e di pse po hezitohet, nuk e di pse po hezitohet, sinqerisht nuk e di pse po hezitohet, e kishim zhvilluar sot, e kishim ezauruar dhe e kishim lënë aty ku e ka vendin kjo gjë për t'u zbardhur secili rast, ama secili rast dhe absolutisht nuk më intereson se kush është fajtori, le ta mbajë barrën e vet kur ajo dëshmohet nga gjyqësia. Por kështu, nuk e kam idenë si. Ne, si Grup Parlamentar, për të mos prishur rendin dhe marrëveshjen e Kryesisë, e thamë që mund të vazhdojë seanca e radhës, seanca që e kemi lënë përgjysmë dhe debatin ta shtyjmë për më vonë, nuk e di çka nënkupton kjo. Sinqerisht, opinioni qytetar i Kosovës ka pas nevojë të sqarohet, të sqarohet sepse është terrorizuar. Ju lutem, sqarimet kanë qenë të nevojshme. Unë nuk kam qenë asnjëherë ithtari i asaj që këtë gjë ta sjell në Kuvend, këtë gjë ta sjell në Kuvend, sepse kjo është tribunë e shenjtë e politikës dhe e juridiksionit, por megjithatë është sjellë. Prandaj, ne se Grup Parlamentar megjithatë pajtohemi me vendimin e Kryesisë që ky debat të shtyhet, por jam i dyshimtë se do të sjell, mirë kjo shtyrje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Unë jam i obliguar që në emër të pozitës që e kam, si kryetar i Kuvendit, të kërkoj nga të gjithë deputetë që vërtet as sot e as të ardhmen mos të keqpërdoret foltorja e Kuvendit për të dëmtuar procesin politik në Kosovë. Gjatë këtyre ditëve vërtet është keqpërdorur edhe Kuvendi dhe ka marrë rolin edhe të mjeteve të informimit, edhe të hetuesisë, edhe të prokurorisë, edhe gjyqësisë. Unë konsideroj që krejt kjo që ka ndodhur, nuk ka qenë në interes të Kosovës, nuk ka qenë në interes të demokracisë së Kosovës, nuk ka qenë në interes të procesit politik dhe gjyqësor që është duke u zhvilluar në Gjykatën Ndërkombëtare dhe mund të konsideroj që të gjitha këto marifete kanë një adresë dhe kjo adresë konsideroj se nuk ka qenë në nderin as të njerëzve që janë marrë me të, as të Kuvendit, as të qytetarëve të Kosovës dhe as të institucioneve të Kosovës.

Prandaj, kërkesa ime është që kurrë më as foltorja e Kuvendit, as Kuvendi të mos keqpërdoret për veprimtari të tilla që janë një farë lloj atentati mbi institucionet dhe mbi demokracinë e re në Kosovë.

Vazhdojmë me seancën e 26 nëntorit.

Radha e deputetëve, fjalën e ka deputeti Ibrahim Gashi.

IBRAHIM GASHI: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë nuk e prita që jam në radhë, por sidoqoftë menjëherë po vazhdoj.

Mendoj që është me interes që kur flasim për Raportin e progresit të Komisionit Evropian, të kemi një fakt parasysh se fjala është jo vetëm për Raportin e Punës së Qeverisë, por edhe për progresin që ka shënuar Kosova si shtet. Prandaj, reflektimi ynë nuk duhet të jetë vetëm opozitar, por mendoj edhe patriotik, duke ofruar zgjidhje, sepse është në pyetje Kosova. Duke ju referuar Raportit të progresit të vitit të kaluar, ku si kriter matës, do me thanë është i vetmi raport që mund ta marrim si kriter matës prej kur

Kosova është shtet i pavarur, fatkeqësisht duhet të konstatojmë se raporti i fundit nuk përmban edhe aq shumë progres për të cilin mund të flasim sot.

Me gjithë qasjen time që të përmbledh pjesët më afirmative të raportit, është krejtësisht e pashmangshme që të mos përmenden pikat kyçe të cilat Komisioni Evropian i ka cilësuar si ngecje.

Mungesa e mbikëqyrjes parlamentare ndaj Qeverisë, pra i referohet punës së Parlamentit. Edhe në observimet tona shpeshherë kemi konstatuar të njëjtin konstatim që e jep Komisioni Evropian, se misioni mbikëqyrës i Parlamentit është ajo pjesa që Parlamenti i Kosovës nuk ka arritur ta realizojë, bëhet fjalë, do të thotë, për mbikëqyrjen e realizimit të ligjeve në Kosovë, të cilat vetë ky Parlament i ka miratuar.

Mungesa e një koordinimi ndërqeveritar evidentohet si një ngecje tjetër që i referohet punës së Qeverisë. Natyrisht, edhe këtu do të thotë nuk është diçka që, si të them, është ekzagjeruar si konstatim, por në fakt ne kemi vërejtur këtë, natyrisht, edhe për shkak të një agjende mund të thuhet të stërngarkuar që Kosova e ka pasur në këto dy vitet e para të shtetësisë së saj.

Ndërhyrjet politike në emërimet e zyrtarëve të lartë dhe në pozitat kyçe të shërbimit civilë, prapë është një ngecje që i referohet punës së Qeverisë, për të cilën ky parlament dhe opinioni i gjerë, por edhe Shoqëria Civile kanë ngritur herë pas here shqetësimet për këtë mënyrë të adresimit të kësaj përgjegjësie që e ka Qeveria e Kosovës në emërimin e zyrtarëve të lartë. Do të thotë, kemi vërejtur që një pjesë e udhëheqësve të asociacioneve të bordeve dhe të institucioneve tjera të administratës civile në Kosovë, kemi vërejtur joprofesionalizëm dhe më shumë preferenca politike në emërimin e zyrtarëve të lartë. Kjo ka prodhuar konstatimin tjetër të Komisionit Evropian, ku thuhet se kapacitetet të administratës publike cilësohen si të dobëta. Natyrisht, mungesa e profesionalizmit nuk prodhon diçka tjetër po prodhon efikasitet të dobët, mungesë efikasiteti në punën e këtyre institucioneve.

Ajo që ndoshta është një shqetësim më i madh që adresohet brenda Raportit të progresit lidhur me punën e institucioneve në Kosovë, është dobësia e gjykatave në hetimin e akuzave për korrupsion dhe keqpërdorime. Krejt kjo bien te një konstatim që, për mendimin tim, është ajo pjesa më drastike e vërejtjeve që jepen se sistemi i drejtësisë mbetet i dobët, i cënueshëm nga intervenimi politik dhe joefikas.

Mendoj që po që se e elaborojmë më shumë këtë, vijmë te konstatimet të cilat unë tash nuk kam as kohë as nuk dëshiroj, por që janë konstatime që edhe në disa herë në disa momente dhe nga disa podiume i kemi ngritur këto shqetësime.

Korniza ligjore për adresimin e korrupsionit duhet të përmirësohet urgjentisht. Në rastin e aprovimit të Ligjit antikorrupsion kemi ngritur këtë shqetësim, si opozitë, për faktin se kemi thënë që nëse krejt ligji i adresohet një institucion të vetëm, qysh është Agjencioni kundër Korrupsionit, kemi menduar që atëherë dhe kjo në një farë mënyre është konstatuar në Raportin e progresit se është institucion i pamjaftueshëm, i pafuqishëm dhe në një farë mënyre si i vetëm dhe gjithsesi i pamjaftueshëm për t'u përballur me këtë dukuri, nga e cila nuk është imune asnjë nga shoqëritë e vendeve në tranzicion.

Pra, strategjia dhe plani i veprimit antikorrupsion ende nuk është miratuar, edhe kjo është një vërejtje që i adresohet pikërisht këtij segmenti.

Dhe, në fund, krejt çështjet që lidhen me korrupsionin, thotë se korrupsioni mbetet mbizotërues në shumë fusha, e që kjo po që se e përkthejmë, është një shqetësim i cili në një farë mënyre duhet të na brengosë të gjithëve dhe duke iu rikthyer kësaj qasje time në fillim, që të jemi në një farë mënyre edhe kontribuuese dhe të kemi një interpretim afirmativ, sepse në pyetje është Kosova, unë mendoj që ajo që kërkohet në këto momente, është që nga institucionet ekzekutive dhe nga kryeministri i vendit kërkohet që të krijojë një strategji të cilën ta prezantojë se si ka menduar që vitin e ardhshëm në një farë mënyre t'i adresojë këto vërejtje dhe që raporti i ardhshëm i progresit të jetë shumë më i avancuar, në fakt, të ketë më pak konstatime të kësaj natyre.

Pra, duhet të kërkohet nga kryeministri se si duhet t'i shkurtojë shpenzimet, për shembull, që lidhen me çështjet e prokurimit, që raporti i vitit të ardhshëm të jetë më ndryshe. Pastaj, mendoj që nuk guxon që për hir të stabilitetit politik të heshtën çështjet që kanë të bëjnë me korrupsionin. Mendoj që është momenti, ndoshta, që edhe të merren masa, në një farë mënyre masa fillestare të fillojnë të trajtohen masa të ndëshkimit të atyre që konstatohet se janë të implikuar në këto çështje, sa për të shërbye kjo në një farë mënyre që të tjerët të tërhiqen nga veprimet korruptive.

Një çështje që është prapë shqetësuese në Raportin e progresit, mendoj që u adresohet problemeve ekonomike. Nëse e lexojmë mes rreshtave ose edhe drejtpërdrejtë e interpretojmë thënie se në Kosovës Qeveria është punëdhënësi më i madh, kjo flet se në çfarë shkalle të zhvillimit ekonomik është Kosova. Dhe, natyrisht, të gjitha problemet që po i përmendim edhe korrupsionin edhe krejt në një farë mënyre gjenerojnë prej shkallës së ulët të zhvillimit ekonomik të vendit. Dhe, duke u nis prej këtij fakti, mendoj se Qeveria duhet në një farë mënyre të adresojë problemet urgjente që lidhen me zhvillimin ekonomik, sepse këtu thuhet edhe në raportin e progresit, duhet të krijohet parakushte edhe financiare për aprovimin e ligjeve bazike, qysh është Ligji mbi punën, Ligji mbi sigurimin shëndetësor dhe pensional, Ligji mbi kategoritë e dala nga lufta, do të thotë janë një varg ligjesh bazike pa të cilat s'mund të pretendojmë se mund të lëvizim nga ky pozicion i zhvillimit ekonomik në të cilën ndodhet Kosova.

Këto kishin për të qenë vërejtjet, që në një farë mënyre mendoj që secili nga ne duhet të reflektojmë konstruktivisht dhe racionalisht dhe të japim kontributin tonë aty ku mundemi, sepse edhe një herë po e potencoj, ky raport i progresit është raport që i referohet progresit të shënuar ose që pretendohet të shënohet në Kosovën si shtet i ri dhe jo ndoshta vetëm një institucioni.

Grupi Parlamentar i AKR-së e ka thënë fjalën e vet lidhur me këtë. këto ishin më shumë pikëpamjet e mia, por mendoj që nuk dallojnë shumë edhe nga ato të grupit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar deputeti, Nexhat Daci.

(Ndërhyrje nga salla)

Atëherë, fjalën e ka deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje për të gjithë të pranishmit!

Raporti i Progresit 2009 nga Komisioni Evropian është vlerësuar në mënyra të ndryshme nga klasa politike. Derisa për mua si opozitë ky mund të quhet raport i regresit dhe për koalicionin qeveritar është vlerësuar si raport historik, që realisht është për t'u habitur nëse i kanë lexuar sfidat me radhë.

Raporti vlerëson se Kosova në të vërtetë ka bërë shumë pak progres prej vitit të kaluar deri në shtator të vitit 2009, kurse në shumë fusha gjendja madje është përkeqësuar.

Nënë një, Në fushën e demokracisë dhe sundimit të ligjit, situata është përkeqësuar, progresi nuk është shënuar as në mbrojtjen e të drejtave njerëzore dhe të minoriteteve, që ka qenë një çrregullim, kurse prej vitit 2009 situata u përkeqësua. Raporti i progresit nënvizon problemet rreth implementimit të ligjit, që akoma është shumë i dobët nga ky koalicion qeveritar, pavarësinë e institucioneve nga influenca e tepruar e koalicionit qeveritar nënvizon kapacitetet e dobëta brenda institucioneve.

Kapaciteti i Kosovës për t'u ballafaquar me progresin e konkurrencës dhe fuqisë së tregut, do të thotë mundësitë e saj për të funksionuar brenda ekonomisë së BE-së ka shënuar vetëm pak progres, krahasuar me 4 raportet e kaluara të progresit.

Në vitin 2009, jo balancimi i madh tregtar, largimi prej privatizimit drejt investimeve kapitale si stimulim për rritje ekonomike dhe niveli i lartë i papunësisë, sidomos i atij të rinisë e kanë zbehur edhe më shumë progresin e ekonomisë së Kosovës.

Në Raportin e progresit 2009, ka shumë tema që ndërlidhen me kriteret e ndryshme në bazë të të cilave Komisioni Evropian gjykon progresin e Kosovës drejt integritimit në BE. Më poshtë janë të cekura disa nga raportet e progresit të grupuara në disa fusha të përbashkëta.

Organet mbikëqyrëse, prej Kuvendit deri te institucionet e pavarura rregullative, të medieve, nuk i kryejnë obligimet e tyre për të qenë në llogari të ekzekutivit. Kjo dëmtton jo vetëm demokracinë, por edhe ekonominë. Mbikëqyrja e degës së ekzekutivit nga Kuvendi ka nevojë për përmirësim, gjë që është cekur edhe shumë herë.

Mbikëqyrja demokratike e sektorit të sigurisë kosovare duhet të forcohet. Institucionet dhe agjencitë e Qeverisë nuk e bëjnë punën e tyre, madje edhe aty ku ligjet ekzistojnë dhe lejojnë për ta bërë këtë. Pa kapacitete më të forta në këto institucione, Kosova nuk mund të shpresojë të zhvillohet si shtet demokratik dhe efektiv. Kapaciteti i institucioneve është i dobët, kurse situata në sektorin ligjor, i cili është i dobët, i lëkundshëm ndaj ndërhyrjeve politike dhe jo efektive kërkon vëmendje urgjente.

Raporti citon shumë ndërhyrje politike, kjo është cekur edhe shumë herë nga Grupi Parlamentar i AKR-së, në ndërhyrjen e bordeve, ku do të thotë se kjo është çështje shumë e prekshme për arsyet e mosfunksionimit të ligjit.

Korrupsioni, një fenomen ky i ndërlidhur me mos sundimin e ligjit, mbikëqyrjen e varfër të Qeverisë dhe ndërhyrjen në emërtime e keqëson gjendjen edhe më shumë, dëmtton demokracinë dhe zhvillimin ekonomik. Korrupsioni mbetet i përhapur në shumë fusha në Kosovë dhe vazhdon të mbetet një çështje shumë shqetësuese dhe këtu përgjegjës kryesor është koalicioni qeveritar.

Dyshimet rreth korrupsionit dhe keqpërdorimeve në sistemin gjyqësor akoma nuk janë hetuar si duhet, situata rreth prokurimit është përkeqësuar krahasuar me vitin paraprak dhe implementimi i ligjit në praktikë ngreh shqetësime serioze. Zyrtarët e prokurimit në Kosovë mbeten të luhatshtëm karshi ndërhyrjeve politike që japin një ndikim negativ.

Vështirësitë ekonomike të Kosovës janë përkeqësuar si pasojë e mungesës së mendimit strategjik, ku akoma në Kosovë mungon një strategji e zhvillimit ekonomik dhe afatgjatë. As afatgjatë, as afatshkurtër nuk e kemi.

Ekziston një kualitet i dobët i planifikimit dhe ekzekutimit buxhetor, që do të thotë se Kosova ende duhet të punojë në marrjen e përgjegjësisë së plotë mbi stabilitetin makro-ekonomik. Kosova është shumë larg nga anëtarësimi në Schengen listën e bardhë të BE-së. Kosova është tek në fillim të adresimit të prioritetëve të saj sa u përket politikave rreth vizave, kufijve dhe menaxhimit të tyre. Kosova duhet të fillojë një zhvillim të një politike koherente për viza në përputhshmëri të plotë me standardet evropiane.

Zhvillimet në fushën e krimit të organizuar në Kosovë janë tejet shqetësuese. Është arritur shumë pak progres në luftimin e krimit të organizuar, që paraqet një çështje vërtet shqetësuese, sidomos në pjesën veriore të Kosovës dhe në vijën kufitare në mes Kosovës dhe Serbisë.

Kosova nuk ka ndonjë strategji për zvogëlimin e krimit. Kosova ka mungesë të resurseve të nevojshme për të luftuar këtë fenomen në mënyrë efektive. Shpërlarja e parave gjithashtu mbetet një tjetër çështje shqetësuese, luftimi i krimit financiar është një ndër prioritetet kyçe të partneritet evropian. Mirëpo, Kosova ka ndërmarrë vetëm disa hapa të vegjël në adresim të këtij fenomeni në mënyrë efektive.

Korniza legjislative duhet të fuqizohet më shumë për të siguruar definimin e shpërlarjes së parave si krim. Në të ardhmen, Njësia Kosovare e Inteligjencës financiare duhet të jetë e pavarur nga ndikimet e ndryshme politike dhe të tjera, si dhe të gjitha aktet tjera ligjore dhe nënligjore duhet të jenë në përputhshmëri të plotë me standardet evropiane.

Të gjitha këto sfida duhet të adresohen nga qeveria dhe të raportohen periodikisht të arriturat para Kuvendit, e jo vetëm të pritet atëherë kur publikohet Raporti i Komisionit Evropian. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Unë jam i obliguar t'ju përkujtoj që janë tri dokumente në diskutim, do të thotë: 1) është Raporti i progresit, 2) është studimi për Kosovën dhe 3) është Plani i veprimit të Kuvendit të Kosovës për integrimet evropiane. Do të thotë, kemi tri dokumente, deri më tani është diskutuar vetëm për raportin, me përjashtim të deputetit Sabri Hamiti. Prandaj, unë po ju tërheq vërejtjen që është mirë të flitet për të tri dokumentet që i kemi në shqyrtim.

Fjalën e ka deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuari zoti kryetar,

I respektuar zotëri kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra, deputetë të respektuar, Ky është një dokument i rëndësishëm që jep një pasqyrë, natyrisht asnjëherë jo bash reale, qoftë për të mirë, qoftë për dështime, ama është një dokument që e jep një incizim të momentit, ka gjëra progresive. Këtë dokument nuk e kisha quajtur të regresit

kurrsesi, ka arritje që duhet t'i mbështesim e t'i përshëndesim, sinqerisht. Po, unë do të kisha fokusuar në disa tema të cilat hyjnë në skopin e profesionalizmit tim, me qëllim që, natyrisht, jo të kritikizmit, porse të vënies në spikamë të disa dështimeve të cilat nuk kanë mundur me angazhim më të madh, nuk kanë mund të jenë ekzistente dhe të cilat mund të eliminohen e mund të evitohen, e natyrisht të gjitha këto do ta çonin çështjen e Kosovës përpara.

Një, te faqja 6, po e zëmë, Sundimi i së drejtës. Jo sundimi i ligjit, po i së drejtës, se nuk është fjala për sundimin e ligjit, se nuk është vetëm ligji, po ka edhe rezoluta, ka deklarata, konventa e kovenante, ka kushtetutë e tjera e tjera, këtu ka defekte të mëdha. Ju lutem, ka raste, raste jo kështu në përgjithësi, konkrete ku është shkelur kushtetuta, ligji, po e zëmë, me vetëdije, pse partitë politike të caktuara e kanë imponuar zgjidhjen e caktuar dhe është dashur asisoj të veprohet në kolizion me kushtetutën, me ligjin. Nuk ka pasur nevojë për ta bërë atë, bile së paku në të ardhmen mos të bëjmë dështime të tilla se absolutisht janë hije e zezë.

Më pastaj, ne e kemi bërë një numër të konsideruar të akteve ligjore dhe i kemi miratuar. Unë gjykoj se në një numër të konsiderueshëm të akteve ligjore ka dominuar kuantitativja në vend të kualitatives, pak si ngutshëm i kemi bërë, pak si me vetëdije kemi përpi edhe zgjidhje të akteve ligjore të cilat nuk janë bash adapte, bile, bile këto shihen edhe kësisoj, le t'i marrim ne diskutimin e dytë, numrin e projekt-amendamenteve, ka rast kur, po e zëmë, 80% ka projekt-amendamente në dokumentin e mëparshëm. Po të ishin përgatitur më mirë, e kanë mund të përgatiten më mirë, e mund të përgatiten edhe duhet përgatiten më mirë, atëherë natyrisht se s'do të kishte pas nevojë për të pasur aq shumë amendamente.

Është një dështim serioz te çështja e neglizhencës së administratës publike të ministrive të caktuara. Dihet, ekziston një institut i cili quhet, është një institut juridik administrativ, ndërkombëtarisht i njohur – heshtja e administratës. Ju lutem, ka raste me numër të lëndës, po e zëmë, ministrinë tona të caktuara, heshtje absolute e administratës. Rasti juridik administrativ i cili sipas ligjit në fuqi ishte dashur të zgjidhej për 3 ditë, do me thënë jo më vonë se 3 ditë, 3 vjet e 3 muaj nuk është zgjedhur. Unë kam ngritur mocion shkrimor, kam kërkuar përgjigje gojore, nuk kam marrë përgjigje gojore. Do me thanë, është fjala për neglizhencë të patolerueshme, ju lutem. Çështje juridike administrative tepër e thjeshtë, e cila do të mund të zgjidhej për 2 minuta, mos të them për një minutë, se sa duhet deri ta hapë atë kompjuterin e deri sa ta shtypë e çka po di unë. Do me thanë, këtu është fjala pse po pranojnë njerëz inkompetent, hajde që po i pranojmë, po nuk i trajnojmë sa e si duhet edhe i zënë pikat kyçe, më pastaj bëhet ngërç në funksionimin e administratës. Administrata, mos ta harrojmë, është shteti. Ka shumë definicione për shtetin, por më i qëlluari është që administrata është shteti.

Kjo është e ngjashme, po e zëmë, edhe te gjyqësori. Për gjyqësorin nuk është e vërtetë se gjyqësori duhet të jetë pavarur, nuk ka pavarësi absolute, ka, është ajo sistemi checks and balances, na duhet reciprokisht të kontrollohemi, mbikëqyremi, gjyqësori, po e zëmë, është po thuaj se jashtë çdo mbikëqyrjeje parlamentare, e në gjyqësorin konsiderohet se janë afër 300 mijë raste të paprekura, ju lutem. Ka raste të cilat sipas ligjit trajtohen urgjente, e ato urgjente, po e zëmë, Ligji për shtypin. Unë e kam një rast, po e zëmë, timin konkretisht, që është dashur të kryhej më së largu për 3 ditë, 4 vjet s'u prekur, fare s'u prekur. Ju lutem, këto janë çështje tepër delikate edhe është fjala për lëshimet tona të cilat me angazhim më të mirë mund të evitohen edhe duhet të evitohen, se ne e kemi gjyqësorin, mburremi që e kemi gjyqësorin, apo jo, a gjyqësori është njëra ndër tri

këmbët më të rëndësishme të shtetit, të cilat do shtet. Nuk diskutohet fare se një numër i akteve ligjore nuk përfillen.

Te faqja 21 – ekonomia e tregut. Ekonomia e tregut quhet te ne, është ekonomi ku dominon monopoli, ku dominon konkurrenca jolojale, importohet çfarë të doni, është shkatërruar ekonomia vendore, ju lutem, s'ka mbrojtje bujku, blegtori, tregtari, s'ka kurrfarë mbrojtjeje. Ne konsumojmë mallra tepër të dyshimta, nëpër shitoret tona nëse hyjmë pak në kthina atje, gjejmë punëtorë, punëtorë që paguhën për t'i ndërruar tiketat e mallrave të skaduar. Kjo është tepër e keqe.

Autori, pa mbrojtjen e të së drejtës së autorit, ju lutem, nuk ka autorësi, nuk ka invencione, s'ka krijimtari të mirëfilltë. Autori është totalisht i pambrojtur. E marrim një tekst universitar, kudo fotokopjohet, po e zëmë, ju lutem, kurrfarë mbrojtje nuk ka dhe kjo është punë e thjeshtë, punë e lehtë, ju lutem, kjo mund të bëhet dhe duhet të bëhet.

Pylltaria, pylltaria jonë u shkatërrua. Mundet dikush të marrë ... andej e këndej, po një lis po e zëmë, kur prehet, duhen 50 vjet për t'u bërë lis, e prehen pa kurrfarë kriteri absolutisht, e tash aty vinë pasojat, vjen ndër tjera erozioni, klima, shëndeti, pasuria e popullit tonë shkatërrohet dhe ne kemi ministri, kemi inspektorate, bile, bile numri i nëpunësve civilë shumëfish më i lartë se sa që ndoshta do të duhej të ishte.

Faqja 37, ambienti. Me angazhime më të mëdha do të mund ta përparojmë, jo veç ta mbrojmë, por ta përparojmë ambientin. Edhe përfundimisht, unë e kam kënaqësinë që ta përshëndes Qeverinë për punët e bëra, edhe për rezultatet e arritura. Natyrisht, këto janë disa skope, ku me të vërtetë ndihem si të them kështu i nxitur për t'u angazhuar për atë sa mundem, aty ku mundem për ta dhënë një kontribut sado kudo modest, në të mirë të tejkalimit të lëshimeve edhe të defekteve të cilat janë evidente. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Sylaj, le të përparojë deputeti Berim Ramosaj.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryetar!

Mbas dy orë vonese, më në fund filloi seanca. Fjalimi im, zoti kryetar, qeveritarë dhe të nderuar deputetë, do të jetë shumë i shkurtër.

Unë sot jam përparuar për të kontribuar për çështjen e integritetit evropian, me shpresën se do të kontribuoj për çështjen në interes qytetarëve të Kosovës. Mirëpo, po shihet se efekti i debatit është i kotë.

Prandaj, do ta përmbyll me një vlerësim. Në Kosovë nuk ka zhvillim, ka ngecje dhe ka kthim pas. Po e merrni në qafë vendin, prandaj ju pyes: - Çfarë tjetër duhet të ngjajë që kjo qeveri të shkojë? Faleminderit!

KRYETARI: Kosova është shumë mirë, vetëm dikush s'po e ndjen veten mirë në Kosovën e lirë. Edhe na vjen keq për ata që se ndiejnë veten mirë në Kosovën e lirë. E drejta ime është të them kur flisni keq për Kosovën.

Fjalën e ka deputeti Berim Ramosaj, le të përparojë deputeti Xhevdet Neziraj.

BERIM RAMOSAJ: I nderuar kryetar i Kuvendit,
Kryeministër, Kabineti qeveritar,
Deputetë të nderuar,

Vërtet, unë do të mundohem të bëj një ekspozë në lidhje me Raportin e progresit, që në fakt në mesin e këtyre dokumenteve të cilët dëshirojmë sot t'i diskutojmë, unë mendoj se dokumenti që më së miri tregon performancën e Kosovës në të gjitha fushat është ky raport. Duke marrë parasysh që Komisioni Evropian është organ ekzekutiv i Bashkimit Evropian, pa dyshim që edhe Raporti progresit në një farë mënyre matë performancën e vendeve të cilat aspirojnë apo pretendojnë të jenë pjesë e këtij Bashkimi Evropian.

Kosova në këtë Raport të progresit ka të gjetura shumë, qoftë në aspektet negative, qoftë në aspektet pozitive. Mirëpo, pa dyshim që performanca varet nga perceptioni i individit. Unë dëshiroj që vërtet perceptimi im të jetë në natyrën kritike në kuptim pozitiv të fjalës për të gjitha ato që kemi arritur dhe ato të cilat do të mundohemi apo po bëjmë punën tonë edhe ne si legjislativ që të jemi pjesë e kësaj familje evropiane.

Perceptioni i shikuar në gotën gjysmë mbushur apo gjysmë zbrazur na çon për të parë disa gjetje të të gjitha fushave, të cilat na japin sigurisht edhe bazë për të qenë kritik në gjendjen ekzistuese. Duke marrë parasysh edhe vokacionin tim, do të orientohej kryesisht në kriteret ekonomike.

Duke marrë parasysh gjetjet ekonomike në Raportin e progresit, del se Kosova vërtet matet në dy aspekte. Në njërin anë matet funksionimi i ekonomisë së tregut dhe, nën dy, mundësia ekonomike e Kosovës të jetë partnere me vendet tjera të Bashkimit Evropian. Të dy këto kritere pa dyshim na japin neve një rezultat në kuptimin e asaj se vërtet ekzistimi i ekonomisë funksionale të tregut është bazë edhe për të qenë partnerë me vendet tjera evropiane. Në këtë fushë kisha për t'i përmendur disa pika.

Në politikën ekonomike, Qeveria e Kosovës ka aprovuar Kornizën afatmesme të shpenzimeve, mirëpo sidoqoftë ky dokument nuk është përdorur në përpikni si dokument për planifikimin e politikave ekonomike. Kjo vërehet edhe në planifikimin e buxhetit, por vërehet edhe në planet afatshkurtra të zhvillimit, qoftë në nivel njëvjeçar, qoftë në nivel trevjeçarë për zhvillimin ekonomik të Kosovës. Korniza ligjore, si dhe praktika e menaxhimit modern të financave publike ende ka të meta, mos të them mungon si qasje publike.

Mandej, në çështjet e eksport-importit, respektivisht të bilancit tregtar, Kosova mund të karakterizohet me këta tregues: Investimet e sektorit privat kanë pësuar rrënje 10%. Kjo e fundit ka ndodhur për shkak të rrënjës së investimeve të huaja direkte, si dhe të ngecjeve në procesin e privatizimit. Si pasojë e krizës globale ekonomike që nga fundi i vitit 2008 eksporti ka filluar të pakësohet. Qasja e kufizuar e Kosovës në ekonominë globale, si dhe sektori financiar i qëndrueshëm i cili ka përcjellë strategjitë konzervative që, në fakt, këtu vlen të përmendet edhe Banka Qendrore e Kosovës, që udhëheq një politikë shumë konzervative në lëmin edhe të licencimit, edhe të mbikëqyrjes së sektorit financiar, tregon se Kosova nuk i ka pasur ato impaktet që i kanë pasur vendet e tjera. Edhe pse shënimet duhet të merren pak me rezervë, duke marrë parasysh se Enti i Statistikave, respektivisht Institucioni i Entit të Statistikave të Kosovës ende nuk është në nivelin e dëshiruar që të jetë kredibil me shënimet e tyre në matjen e performancës së treguesve të caktuar ekonomikë.

Në përgjithësi, duke mos zbuluar efektet edhe ashtu të limituara të krizës ekonomike në ekonominë e Kosovës, deri tani mungesa e të dhënave nuk ka lejuar një hulumtim të gjerë për vitin paraprak fiskal. Në gjysmën e parë të 2009 eksportet kanë rënë në mënyrë të ndejshme, afër 40%, ku metalet bazë kanë pësuar rënie afërsisht 60%. Importet e

mallrave janë rritur po ashtu diku mbi 20% në vitin 2008, duke arritur shkallën 50% të bruto produktit vendor, krahasuar me 44% të bruto produktit vendor, që ishte në 2007. Ky është një tregues jo i mirë për Kosovën duke marrë parasysh bilancin tregtar të Kosovës në raport me eksportin dhe importin.

Te çështja e punësimit, respektivisht papunësisë, papunësia e regjistruar në gjysmën e parë të vitit 2009 mbetet shumë e lartë, vlerësuar deri në 40% dhe e pandryshuar që nga viti 2008. Më shumë se 90% të personave të regjistruar renditen në grupin e personave të papunësuar në afat të gjatë. Hulumtimi i fuqisë punëtore gjithashtu konfirmon papunësinë në nivel të lartë, që do me thënë 40 deri 50%. Këtij niveli apo kësaj shkalë të përqindjes sigurisht i kontribuon shumë kontingjenti i 30.000 të rinjve që hynë për çdo vit kalendarik në tregun e fuqisë punëtore. Në përgjithësi, niveli i aktiviteteve ekonomike nuk i lejon fuqisë punëtore të re që rritjet të absorbohen, ashtu që për shumicën – emigrimi, puna jashtë vendit mbetin e vetmja zgjidhje e mundshme, që pa dyshim është një faktor negativ në aspektin e zhvillimit në përgjithësi.

Vend të rëndësishëm në Raportin e progresit zë edhe industria financiare, si po i thonë tani, apo zhvillimi i sektorit financiar në Kosovë. Banka, edhe pse Banka Qendrore e Kosovës thirret apo emërtohet si Bankë Qendrore, ende është larg nga institucioni i një banke nacionale, ende merret kryesisht me një politikë, bile tepër konzervative në lëmin e sigurimeve, në lëmin e bankave komerciale, bën mbikëqyrje që në instancat, respektivisht në periudhën afatgjatë ka dhënë rezultate pozitive, duke marrë parasysh impaktin e krizës globale, mirëpo sidoqoftë politika monetare kreditore, qoftë në lëmin e shkallës së interesit, pa dyshim nuk ka dhënë rezultate të duhura në raport me bankat komerciale, do me thënë raporti midis bankave të nivelit të parë, dytë dhe të tretë. Raporti midis Bankës Qendrore dhe bankave komerciale pa dyshim është i natyrës, gati veç kujdestarisë, nuk ka ndonjë natyrë tjetër të politikës zhvillimore në aspektin e industrisë financiare.

Sektori financiar në Kosovë ka vazhduar të zgjerohet, edhe pse me shpejtësi mjaftë të ngadalësua, duke marrë parasysh se sektori financiar ishte zhvilluar me hapa shumë të mëdhenj në periudhën para 5 vjetëve. Në Kosovë deri tani operojnë 8 banka komerciale, 10 kompani të sigurimeve dhe 2 fonde pensionale. Banka Qendrore e Kosovës ka reaguar ndaj krizës financiare ndërkombëtare me themelimin e Komitetit të gatishmërisë për kriza dhe nënshkrimin e një Memorandumi të mirëkuptimit për mbrojtjen e stabilitetit financiar. Mirëpo, kjo nuk është e mjaftueshme me qëllim që të zbutet ndikimi i krizës, sepse kriza financiare globale vërtet ka filluar nga sektori financiar, por sektorin real e ka përfshirë tash, sidomos sektorin e ndërtimeve, sektorin e veprimtarive të tjera që kanë peshë më të madhe dhe bëjnë ndikim në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik.

Dhe, së fundi, desha të them edhe këtë. Buxheti i vitit 2009 ka qenë i ndikuar nga agenda elektorale, këtë duhet ta kuptojmë, dhe ka vazhduar rritjen e pagave, që për pasojë ka shtyrë në prishjen e rregullit financiar, sikur është paraqitur edhe nga Korniza afatmesme e shpenzimeve, do me thënë kjo e ka prishur atë raportin midis Kornizës afatmesme të shpenzimeve, që është raport që për ne është strategji e zhvillimit dhe planeve njëvjeçare apo planeve afatmesme.

Qeveria po ashtu ka vazhduar të iniciojë legjislacion, pa i lidhur ato me KASH-in, do me thanë me Kornizën afatmesme të shpenzimeve apo dokumente tjera afatmesme të planifikimit, që mund të siguronin ndonjë konsistencë të politikës me kohë. As buxheti dhe as korniza afatmesme nuk janë

KRYETARI: Një minutë, regjia!

BERIM RAMOSAJ: Faleminderit! Të mirëkuptohemi, faktikisht ne po mundohemi të japim efektin në kuptimin e asaj që të rregullohet performanca e Kosovës në të gjitha fushat, andaj unë kërkoj që edhe Qeveria ta mirëkuptojë, edhe legjislativi, edhe qytetarët e Kosovës se jemi të gatshëm të ballafaqohemi me vetëkritikë, në mënyrë që të ecim më mirë për të ardhmen. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Xhevdet Neziraj, le të përgatitet deputeti Ramë Buja.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër, ministra dhe kolegë deputetë,

Unë do të ndalem në një segment të caktuar të raportit dhe do ta kisha lexuar raportin në faqen 22, ku thuhet se situata e komuniteteve minoritare vazhdon të jetë brengosëse, sidomos e komunitetit romë, egjiptian dhe ashkali dhe në përgjithësi autoritetet kosovare duhet të ndërmarrin hapa urgjentë, të adresojnë situatën e këtyre komuniteteve për zgjedhjen e këtyre problemeve. Atë ditë kryeministri i tha shumë gjëra që ekzistojnë për komunitete, tha se është formuar Këshilli konsultativ për komunitete, Zyra pranë kryeministrit për minoritete, Komisioni funksional për komunitete, janë edhe komiteti për komunitete nëpër komuna, komunitetet për ndërmjetësim, kemi zyrtarë për kthim, kemi Ministrinë për Komunitete dhe Kthim dhe prapë çdo raport është shumë negativ, çdo raport është edhe më i keq se tjetri dhe unë dua që një herë e përgjithmonë në këtë Kuvend mos të vijnë raportet që shkelin të drejtat e asnjë komuniteti. Ajo është në të mirë të gjithë qytetarëve, është në të mirë edhe të shumicës, por edhe të pakicës.

Do të ndalem në Këshillin konsultativ, që një vit funksion dhe nga vetë fjala konsultativ është, merret veç me konsulta dhe s'merr asnjë veprim. U kënaqëm në atë këshill konsultativ duke na i treguar praktikat e mira të ligjeve të ndryshme se si zbatohen në botë pa asnjë rekomandim, pa asnjë veprim dhe dua të them që është me të vërtetë një këshill që është duke u tregua bosh nëse nuk ndërmerren hapa tjerë dhe hapa konkretë. Dhe, është një mesele që është dëgjua nga anglezët, se thuhet që aty ku ka kuzhinier shumë, gjella do të jetë pa kripë. Edhe ne kemi shume komisione, kemi formuar shumë gjëra për komunitete, mirëpo diçka nuk është duke vepruar në rregull.

Gjithashtu, kryeministri tha se e kemi aprovuar strategjinë për komunitetin romë, egjiptian dhe ashkali, strategji që në fillim të hartimit të saj e ka cenuar identitetin etnik të egjiptianëve të Kosovës dhe për këtë arsye nuk kemi marrë pjesë në hartimin e këtij dokumenti. Kjo strategji paraqet një dokument bosh, i cili është i pa zbatueshëm dhe jemi të vetëdijsëm se ky dokument i shërben Qeverisë së Kosovës vetëm si arsyetim se kemi strategji, por na mungojnë vetëm fondet. Edhe pse dokumenti quhet strategji e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian, kjo strategji është ndërtuar vetëm për një komunitet dhe të gjitha referencat kanë vetëm një shifër, vetëm një përqindje, vetëm një masë për veprim dhe askund nuk gjendet diçka e ndarë për secilin komunitet. Këtë mund ta lexojmë në strategji, në faqen 8 dhe 9, edhe pse ajo strategji është diku 82 faqesh, besoj që asnjë nga ministrat, as kryeministri s'e kanë lexua se është shumë voluminoz.

Ne jemi shumë të vetëdijsëm se egjiptianët e Kosovës kanë shumë probleme të njëjta, çfarë kanë edhe komuniteti shumicë shqiptare, boshnjakët, turqit, por problemet si arsimi, varfëria, infrastruktura nuk mund të mohohen se nuk janë probleme edhe të egjiptianëve, por edhe të romëve, por kur kemi të bëjmë me dallimet etnike, gjuhësore, kulturore në

mes të romëve dhe anën tjetër të egjiptianëve, këto probleme nuk bënë të zgjidhen me një shabllon, nuk bënë të zgjidhen me një kut dhe nuk bënë që këto tri komunitete të bëhen një komunitet. Kjo, është duke u shkelur edhe kushtetuta, por është duke u shkelur edhe Ligji për promovimin e komuniteteve që është aprovuar në këtë Kuvend. Thuhet në një nen që komunitetet tradicionalisht që jetojnë në Kosovë, janë minoritare, janë serbët, boshnjakët, turqit, romët, egjiptianët dhe tani dëshirojnë që prapë t'i bashkojnë këto komunitete. Strategjia për integrimin e këtyre komuniteteve është dokument që është iniciuar, financuar dhe hartuar nga KFOS, OSBE, UNDP, Këshilli i Evropës dhe lobi rom në Evropë dhe nuk është produkt i Qeverisë. Atëherë, nuk është mirë që Qeveria të shtinë therë në këmbë të shëndosh. Pasi që s'është produkt i tyre, ata edhe s'mund ta zbatojnë.

Kontributi i përfaqësuesve të komuniteteve në këtë strategji ka qenë vetëm simbolik për arsye se përfaqësuesit e komunitetit egjiptian s'kanë marrë pjesë në hartimin e kësaj strategjie, përfaqësuesit legjitim dhe përfaqësues legjitim jam unë, si kryetar i subjektit politik, që jam nënshkruar i pavarësisë së Kosovës, që jam nënshkruar i Kushtetutës së Kosovës dhe jo të merren njerëzit nga rrugët, shoqatë civile që e përfaqëson veten dhe një anëtar të familjes. Kjo një herë e përgjithmonë duhet të ndërpritet.

Me të gjitha masat që me të gjitha metat që i ka strategjia, thuhet që këtë strategji duhet ta zbatojë Ministria për Komunitete dhe Kthim, ministri kjo që nga fillimi është ministri kaotike, që shquhet për mos efikasitet, që shquhet për keqmenaxhim dhe kjo ministri vetëm simbolikisht e ka emrin për komunitete. se as që merret dhe as që është marrë me komunitetin romë, egjiptian dhe ashkali, për arsye se nga 100 e sa punëtorë të punësuar, nuk e ka asnjë pjesëtarë të këtyre komuniteteve të punësuar në këtë ministri.

Strategjia, thashë edhe një herë, cenon rënd integritetin e komunitetit egjiptian dhe unë do të dorëzoj në Kuvend të Kosovës rekomandimet dhe nënshkrimet e intelektualëve të komunitetit egjiptian në Kuvendin e Kosovës, si organ më të lartë. Strategjia nuk parasheh integrim me specifika të veçanta për zgjedhjen e problemeve, po i zgjedh problemet me të njëjtin shabllon. Strategjinë e përkrahi për komunitetin romë, për arsye se kjo strategji është për ato komunitete, se është marrë kopje nga strategjitë në Sllovaki, Çeki, Rumani, që evropianët ua kanë zgjedhur shumë problemin atyre dhe i kanë shti duke jetuar në enklava.

Një problem tjetër që do ta cek, është edhe decentralizimi. Komuniteti ndërkombëtar, me decentralizim do të përfitojë vetëm komuniteti serb, për arsye se do të bëhet decentralizim edhe administrativ, edhe politik, po edhe fiskal. Do të thotë, ato komuna të reja do të kenë edhe buxhetin e vet. Prandaj, komunitetet tjera nuk do të kenë qasje në të gjitha këto mjete financiare.

Dhe, përfundimisht, do ta përfundoj, ka ndodhur një befasi shumë e kënaqshme në zgjedhjet e fundit, ku të gjitha partitë politike kanë pasur pjesëtarë të komunitetit egjiptian, bile edhe në lista dhe ju kanë premtuar punësim, ju kanë premtuar shkollim, po është mirë që këto t'i realizojnë pas fushatës. Dhe, është shumë mirë, atë që e kam kërkuar unë me kohë gjithmonë që të ketë anëtarë të këtij komuniteti në të gjitha subjektet politike, po këto subjekte politike mandej duhet të veprojnë edhe për këto komunitete.

Unë i kam dy dokumente këtu se shkelen të drejtat dhe kushtetuta. Një dokument është nga Ministria për Komunitete dhe Kthim, ku edhe në ndarjen e fondeve veç për 2 milionë se çfarë ndarje ka bërë, 600 mijë për komunitetin shqiptarë, 800 mijë komunitetin serb,

27 mijë për komunitetin turk, 300 mijë për komunitetin boshnjak, 200 mijë për komunitetin goranë, ndërsa për këto tri komunitete, që më së shumti po vajtojnë, i kanë ndarë veç 40 mijë euro dhe ato nuk dihet as kah i ka çuar. Unë nuk di deri kur Qeveria e Kosovës duhet të ndërmarrë masa konkrete, masa konkrete dhe masa vepruese që të mos na paraqiten raporte të tilla. Komiteti egjiptian ka dhënë kontributin e vet gjatë gjithë pjesës së kësaj historie, do ta japë edhe këtë kontribut, por presim nga institucionet vendore me të vërtetë të na trajtojnë si njerëz dhe të jetojmë me dinjitet dhe jo të anashkalohejmë në çdo pore të jetës.

Unë dua ta përshëndes këtu zonjën deputete, Besa Gaxherri, kur u ngrit, u ngrit se nuk ka përfaqësues diplomatik nga komuniteti, nga gratë. Do të kishte me qenë në nderin e këtij parlamenti të ngrihen dhe të kërkojnë edhe ndonjë përfaqësues, ndonjë ambasador nga komunitetet tjera, të jetë edhe nga komuniteti egjiptian, sepse këta janë qytetarë të Kosovës dhe me dinjitet i mbrojnë interesat e Kosovës.

Dhe, përfundimisht, unë dua të pres se në këtë Kuvend, në institucione, sidomos Qeveria, ekzekutivi të veprojë në të mirë të të gjithë qytetarëve të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! fjalën e ka deputeti Ramë Buja, le të përgatitet deputeti Niman Baliq, vetëm nëse mund t'i rrumbullakoni pak fjalët e juaja.

RAMË BUJA: Gjithsesi, kryetar, do t'i bëjmë rrumbullake, po...

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar qeveritarë dhe kolegë deputetë,

Kërkoj falje që sot më ra shpesh të marr fjalën, por kësaj radhe do të ndalem në temën e caktuar për të cilën bisedohet sot dhe do të flas me një theks të veçantë, duke u pajtuar me kryetarin e Kuvendit se ne po e kapim vetëm një segment ose po e segmentarizojmë çështjen e këtij Raporti të progresit të Komisionit Evropian, andaj do të ishte mirë të kapet në tërësinë e tij dhe të shihet se si do të dalë pastaj.

Edhe në seancën e kaluar të Kuvendit tonë, edhe në të sotmen u debatua gjerë e gjatë rreth Raportit të progresit të Komisionit Evropian që ka të bëjë me Kosovën dhe përparimin e saj, ecjen e saj në sendërtimin e objektivave të veta për të arritur cakun e shënuar – aderimin në Bashkimin Evropian. Tonet dhe disponimet ishin nga më të ndryshmet, herë racionale dhe në akord me të arriturat solide, doni as mish as peshk, si zakonisht, e herë - herë me çakorde dhe tërësisht të shpërputhshme me këtë ecje dhe synime të mëtutjeshme, gjer në mohim të plotë të kësaj rrite në këtë kohë kaq të shkurtër kohore, që nga pavarësia e këndeje. Jam i prirur të respektoj mendimin e kundër, por assesi të pajtohem me të për arsyen e malit të fakteve që ekzistojnë për të argumentuar të kundërtën e këtyre të thënave nihiliste.

Kolegë të mi të respektuar,

Që jeni të disponimit të vazhdueshëm të shihni gotën gjithmonë as gjysmë të zbrazët, ju ftoj të jeni më esëll, një herë së paku, për të parë këtë realitet në sy, objektivisht, për të peshuar drejt dhe arsyeshëm dhe, gjithsesi, për të ruajtur më dinjitetshëm pozicionin opozitar. Më thoni, ju lutem, si është ky Raport i Progresit për vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, që kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë favore të shumta në raport me ne, pa e përmendur kohën tonë tepër të shkurtër të të qenit shtet të pavarur, sovran dhe demokratik, i ngjashëm tepër identik me .. shumë të vogla dalluese.

Jam i ndërgjegjshëm se krahasimet për raste të tilla nuk flasin shumë, por gjithsesi thonë diçka dhe unë këtë po e bëj për të rikujtuar, kolegë të nderuar, se duhet të besoj se këtë raport e keni lexuar. Po e them kështu, se nga diskutimet që i kam dëgjuar sot dhe atë ditë kur ishte seanca e fillimit, jo të gjitha më dalin kështu që e kanë lexuar këtë raport.

Është e ditur që Këshilli Evropian në vitin 2003 miratoi agjendën e Selanikut për Ballkanin Perëndimor, ku u bë e ditur se a ardhmja e vendeve të Ballkanit Perëndimor është në Bashkimin Evropian. Vlerësimi i përmbushjes së të gjitha detyrimeve që vijnë nga partneriteti evropian sigurohet në Projektraportin e progresit të Komisionit Evropian.

Ne këtë raport e kemi pritur me shumë qetësi për faktin e punëve të kryera dhe të atyre që po vazhdojnë të kryhen me ritëm të kënaqshëm. Jemi posaçërisht të disponuar për faktin, në të vërtetë, që fokusimet e këtij raporti janë shumë identike me agjendën e institucioneve tona legislative, ekzekutive dhe gjyqësore. Besoj, e dini, por po ua rikujtoj, se fokusimi i këtij raporti bie në veçanti mbi tri sfone, pa i anashkaluar të tjerat, e ato janë: politika, ekonomia dhe legjislacioni. Ne nuk i kemi përfshirë të gjitha në diskutimet dhe përimtimet tona, në sqarimet tona.

Besoj ta dini, gjithsesi, se raportet e progresit nga Komisioni Evropian do të vazhdojnë. Kanë filluar në vitin 2005 dhe ato që do të vijnë, do jenë më sfidues, më kërkues, më insitues sado më afër që u ofrohem portave të Bashkimit Evropian. Ne të Partisë Demokratike dhe institucionet shtetërore jemi të gatshëm t'i presim e mirëpresim, për t'u përballur dhe për t'ia dalë mbanë për të arritur te caku i synuar, besoj, nga të gjithë ne – aderimi në gjithë mekanizmat e BE-së dhe më gjerë, gjithsesi. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Numan Baliq, le të përgatitet deputeti Armend Zemaj, nëse nuk shkojmë në pauzë për drekë.

NUMAN BALIĆ: Ju faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Dopustićete mi da vas selamim i da iznesem nekoliko gledišta vezano za Izveštaj Evropske komisije. Nastojaću da iznesem neke strvari koje do sada nisu govorene i, rekao bih, pokušao bih da zavirim u drugu stranu medalje, a opšta ocjena vezano za Izveštaj Evropske komisije jeste da je jako obiman, da je opširan, čak je i preopštiran. On teži da bude sveobuhvatan, ali je u mnogim slučajevima površan i ne bavi se suštinom, stvarnom suštinom mnogih pitanja. On jedva da dotiče neka pitanja, samo ih nabraja, a ne daje preporuke i rješenja. To je ključna mahana ovoga izveštaja, koju bih na početku spomenuo. Druga mahana koju bih spomenuo vezano za Izveštaj Evropske komisije jeste da se on već na samom početku bavi odnosima između Evropske unije i Kosova i, naravno, nije izbjegao da padne u zamku politiziranja, jer je i ovaj izveštaj, kao i mnogi izveštaja koji se prenose u međunarodnim tijelima, politizira, tako da se, recimo, govori o ekonomskoj političkoj podršci, odnosno podršci ekonomskom i političkom razvoju Evrope, koju ona daje Kosovu, međutim nema dovoljno transparentnosti oko ovog izveštaja.

Ako je u pitanje ekonomski dio, ono što bih spomenuo a što je do sada malo ko spomenuo, da ne bih ponavljao, rekao bih da se, recimo, govori oko toga da je u zadnjih nekoliko godina Evropa dala Kosovu 500 miliona eura. Malo koji stanovnik Kosova bi mogao odgovoriti, čak i oni koji su u opštinskim i vladinim institucijama, čak i oni koji vode ministarstva, malo ko od njih bi mogao nabrojati gde je otišlo 500 miliona eura i kako je potrošeno toliko novca. To je veliki novac. Verujete da je taj novac ravan kapitalnom investiranju Vlade u zadnje najmanje dvije godine, govorim o kapitalnom

investiranju. Dakle, radi se o jako puno para i da nema transparentnosti vezano za izvještaj koji navodi komisija, a takodje ni Vlada ne daje izvještaj, a samo u zadnjoj godini se spominje da je dato 103 miliona eura. Naravno da se govori o Donatorskoj konferenciji i o tome koliko je sredstava dato, ali ono što je vrlo važno i što bih želio da napomenem je da je javnost potpuno neobavještena oko toga šta je sve bilo, koji su konačni rezultati Donatorske konferencije? Šta je uradjeno sa novcem koji je Evropa dala na zadnjoj Donatorskoj konferenciji? U koje fondove su otišla ta sredstva i koliko je zaista iskorišćeno za sve zajednice i za narod Kosova.

Drugi dio koji je veliki nedostatak, jeste deklarisanje značajne političke podrške koje je Kosovo dobilo. Kosovo jeste dobilo političku podršku od Evropske zajednice, ali se zato ne govori o dvostranoj politici Evropske zajednice, koja ona u isto vreme hoće da baude dobra i Beogradu i Prištini, prema poznatom fenomenu politike ekvidistance. Tako da se na jednoj strani dozvoljava takav luksuz da Srbija, Crna Gora i Makedonija, Srbija posebno koja je poznata po genocidu koja je izvršila u Bosni i na Kosovu, dobija vize za ulazak u Evropi, a na drugoj strani Bosna i Kosovo ne dobijaju vize za ulazak u Evropi. To je pitanje o kome treba govoriti u izvještaju i koji ima važne političke konsekvence. Ovo je vrlo važno pitanje i vezano je za stranu 5. Pošto vidim da predsednik već tamo nešto se mršti, ovo je vezano za stranu 5. Izvještaja Evropske komisije.

Drugi dio koji se tiče nesigurnosti, navodno na sjeveru. Spominje se nesigurnost i bezbednosno stanje na severu, koje nij dobro. Pa molim vas, vrlo je blago, vrlo je nerearno govoriti o uznemiravajućoj bjezbednosti kada to treba nazvati pravim imenom. Evropa sigurno da ima svoj značajan udio u tome, da čitav dio, sjeverni dio Kosova, ne samo da se radi o paralelnim strukturama, ne samo da se radi o bjezbednosnom ili nedostatku suvereniteta Kosova, pa bukvalno se radi o tome da je to dio Kosova koji je pod upravom srpske države. On funkcioniše kao da se nalazi u Srbiji a ne na Kosovu. To je problem o kojem Vlada mora otvoreno da govori i ne da daje prazna obećanja ili obećanja koja nemaju nikakve realne podloge da je Kosovo potpuno, pod punim suverenitetom vlade, a ustvari ga nema ni za lijek, nego tamo u stvari funkcioniše srpska država a ne kosovska država. To su stvari koje moramo da ... i koje moramo imati jasno prijed cjelom javnošću Kosova.

Pomeniću kratko još nekoliko stvari koje su važne za druge zajednice. U vezi sa administracijom. Administracija jeste napravila napredak, povećala je efikasnost u cijelosti i u vladnim i opštinskim strukturama, ima pomjeranja vezano za administraciju, ali ima jako puno nedostataka, posebno vezano za izdavanje dokumentacije na jezicima, bosanaskom i turskom u opštinama u kojima žive ove zajednice. Ima mnogo kršenja prava vezano za Zakon o lokalnoj samoupravi, vezano za izdavanje lične dokumentacije, vezano za Zakon o državljanstvu. Ja sam javno prosljedao ovde, nad ovom govornicom, i dao napismeno ministru vezano za slučaj kršenja prava, međjutim ništa nije preduzeto. I lokalni policijski službenici u pojedinim opština su prekoračili svoja ovlašćenja i vrlo često su bili recimo na strani žrtava, a nisu štitili one koji su bili napadnuti i takodje u mnogim slučajevima je osporeno državljanstvo građanima Kosova. Više stotina familja naših građana koji žive godinama ovdje imaju pravo na državljanstvo, odnosno Zakon o državljanstvu, sada su izgubili to pravo i prinudjeni su da plaćaju državljanstvo. To je jedan non sens koji postoji samo u nekim djelovima Kosova gde žive ove zajednice. I to je imperativ da Vlada hitno počne rješavati ova pitanja i da se uklone sve prepreke vezano za

ostvarivanje osnovnih prava, a to je pravo na državljanstvo i izdavanje lične dokumentacije svim građanima Kosova.

Oko decentralizacije. Ovo je vrlo važno pitanje, moramo da budemo realni da je drecentralizacija u stvari znak slabosti kosovskih institucija i znak popuštanja pred jakom presijom upravo evro-američkih predstavnika i kao znak popuštanja srpskoj zajednici. Naravno da je dobra stvar da je tu došlo do nekih pomaka pa je formirano 5 srpskih opština zajedno sa sevjernom Mitrovicom, pa je uz njih kao kolateralna dobit,...dobit a ne šteta, ušlo i dvije albanske opštine i jedna turska opština. Međutim, glavni je problem u tome što su potpuno ignorisani zahtjevi Bošnjačke i Goranske zajednice za Vitimiricu, Vitimirica, Rečane i Gora. Mislim da je neoprostivo, nedopustivo i da je to na jednoj strani dokazan neangažovanost i nezainteresovanost Vlade, ali i političkih zastupnika bošnjaka i turaka, koji su kupujući pozicije koje imaju, sopstveni mir i sopstveni napredak, jednostavno radili na štetu svojih zajednica. Vrijeme je da Vlada počne riješavati pitanje decentralizacije i zahteve koji su dati za ove opštine i da se razgovara sa pravim predstavnicima ovih zajednica i da se konačno riješava ovo pitanje, jer ono ne samo da zadire u ustavni okvir, nego zadire i u Zakon o lokalnoj samoupravi, koji kaže na osnovu člana 12.3 da Vlada Kosova treba stupiti, da stupi u obavezi sa onim zajednicama koje ispunjavaju uslove. Ove zajednice koje sam spomenuo, ispunjavaju uslove na osnovu zakona i Vlada je dužna četiri godina nakon predavanja ovih zahtjeva, da stupi u razgovore sa zajednicama oko opština koje sam spomenuo, a posebno opštine Vitimirica, gde se radi jednostavno jednoj budućoj multietničkoj opštini koja bi doprinela celokupnom razvoju Kosova i na karaju krajeva jednoj zajednici koja je jako zaslužna za današnje Kosovo.

Oko pitanje nestalih. Mislim da je pitanje nestalih potpuno nepravedno zaobidjeno. Vlada je tu najviše, da tako kažem, ..., jer je recimo otkriveno 40 slučajeva u odnosu na 1800 slučajeva. Pa molim vas, 40 slučajeva ubijenih i nestalih, to je samo 2% u odnosu na ukupan broj nestalih, tako da je to jedna sjenka na rad Vlade, ali takaođe i na rad evro-američkih predstavnika. Evropljani su trebali biti mnogo veći posrednici u ovoj situaciji, kada znamo da odnosi Beograda i Prištine praktično ne postoje, Evropski zastupnici, regionalni misionari, mnogi drugi su trebali dati mnogo veći doprinos za riješavanje pitanja nestalih. Mislim je neoprostivo da smo u zadnju godinu dala riješili samo sudbinu 40 ljudi, a da se uglavnom politizira, odlaže i manipulira, moram to reći, u određenoj mjeri manipulira sa sudbinama onih koji su izgubile živote svojih najmilijih. Ovde napominjem da ne treba više, mislim da je nedopustivo da se stalno govori kada se spominju nestali, da se stalno govori o nestalim iz redova Albanske, Srpske zajednice. Treba spominjati i nestale iz redova Bošnjačke, Romske i drugih zajednica, jer su takodje i to građani Kosova koji su nestali i treba riješavati njihova pitanja.

I, na kraju, oko integracije i povratka. Ponovio bih naš poznati stav da uopšte nije dobro govoriti o integraciji. Treba govoriti o ravnopravnosti, jer se ne radi o stanovnicima koji su došli iz Kine, nego se radi o ljudima koji žive ovdje stotinama godina, i o Bošnjacima i Romima i Turcima, dakle ne radi se o njihovoj integraciji, nisu oni otišli u Njemačku pa da se tamo u integrišu, nego oni žive u svojoj zemlji i treba govoriti o njihovoj ravnopravnosti. Nažalost, oni nisu zasada ravnopravni, uprkos naprecima koje jesam pobrojao, napreci koje postoje, koji su djelom naravno i delovanjem ove vlade i prethodnih vlada, naravno da postoje napredci, ja ponavljam, mi smo zajedno sa mnogima učestvovali u ostvarivanju tih napredaka, ali još uvek je sasvim nedovoljno. Ono što je kolega Neziraj nabrajo, smatram potpuno realnim i Vlada treba obratiti pažnju posebno na predstavnike onih zajednica koje su zaslužne,

koje mogu pomoći vladi, i ovaj koji vam govori, upravo je jedan od onih koji se borio za današnje Kosovo, prema tome neoprostivo je da upravo one zajednice koje su puno doprinjele današoj državi Kosova, da su danas jako zapostavljene, da se radi sa onima koji su poslušni i koji su kooperativni, a da se....

KRETARI: Ju faleminderit! Vazhdojmë në orën 14:30.

Vazhdimi i seancës pas pauze

Seancën drejton: Xhavit Haliti, anëtar i Kryesisë

KRYESUESI: Atëherë, po vazhdojmë. Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit shumë!

Zëvendëskryeministër,

Ministra,

Kolegë deputetë,

Gjuha e përdorur në tekstin e ofruar të Raportit të progresit 2009 nga ana e Komisionit Evropian për të maturat e arriturat e institucioneve të Kosovës, edhe pse qartë flitet për të gjeturat, krijon hapësirë për interpretime të shumta pro edhe koftra. Fjalët që më së shpeshti hasen si tregues të të arriturave, si nuk ka progres, pak progres, shumë pak progres, progres i pamjaftueshëm, progres i pjesshëm, paraqesin fushat në të cilat mungon progresi edhe në të cilat kërkohet veprim. Jo të gjitha shtetet anëtare të BE-së e kanë njohur pavarësinë e Kosovës dhe me të cilat është krijuar edhe një barrierë ligjore që Kosova të hyjë në raporte kontraktuale me BE- në. Prandaj, me këtë mekanizëm alternativ, siç është matja e progresit në Kosovë dhe performanca e institucioneve të Kosovës, të gjeturat duhet të plotësohen dhe të bëjnë me të lehtë që të plotësojnë standardet evropiane që kërkohen për anëtarësimin në Bashkimin Evropian.

Për shembull, mosvënia në veprim i vullnetit politik, nevoja për përmirësimin, koordinimin efikas të agjendës për integrim evropian nga Qeveria e Kosovës, ne kemi debatuar edhe më parë dhe është nevojë imediate që në raport me Qeverinë dhe me të gjitha institucionet të jenë më koherentë në zbatimin apo zbatueshmërinë e plotë.

E dyta, sistemi gjyqësor. Kjo po përsëritet ngjashëm edhe në vitin e kaluar, edhe në këtë vit Raporti i progresit identifikon një sërë problemesh serioze në funksionimin e sistemit gjyqësor, që konstatohet të jetë vetëm në stadin fillestar të zhvillimit të saj. Edhe sivjet, raporti liston paketën e ligjeve kyçe që ende nuk janë miratuar: Ligji për gjykatat, Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Ligji për Prokurorinë dhe Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës. Ky ligj, do me thënë, edhe ligji ekzistues që është mbi përbërjen e përkohshme të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, nuk është në përputhje me standardet evropiane. Prandaj, hartimi dhe miratimi sa më parë i paketës së ligjeve, do të mundësojë krijimin e kornizës ligjore për reformim të plotë të sistemit gjyqësor, duke filluar që nga rritja e numrit të gjyqtarëve, stimulimi i përfshirjes të gjyqtarëve të komuniteteve dhe ristrukturimi i funksionimit të gjyqeve. Unë mendoj që kjo agjendë, do me thënë duhet të përmbillet jo më shumë se në marsin e vitit të ardhshëm.

D treta, lufta kundër korrupsionit. Problemi i korrupsionit prapë vazhdon të jetë gjithëpërfshirës dhe prezent në shumë sfera të funksionimit të institucioneve, bizneseve dhe shoqërisë në Kosovë. Në më tepër se 10 fusha të Raportit të progresit adresohen çështjet e lidhura me korrupsionin dhe pasojat e saj. Përkundër kompletimit të Agjencisë Kundër Korrupsion me staf, sfidë mbetet bashkëpunimi me institucionet e tjera

të hallkës së luftës kundër korrupsionit. Për më tepër, kërkohet plotësim dhe ndryshim i kuadrit ligjor që rregullon fushën e përpjekjeve kundër korrupsionit dhe kjo bie mbi Kuvendin e Kosovës, do me thënë përgjegjësia është edhe e ne deputetëve, e punës së Kuvendit, duke marrë parasysh që paketa ligjore e cila ka ardhur kundër korrupsionit akoma, do me thënë, nuk ka marrë aprovimin dhe përfundimin përfundimtar, dhe e gjetura e cila kritikon edhe Kuvendin e Kosovës, edhe ne deputetët, është e sakët, për mua, dhe mendoj që shtimi i përkrahjes profesionale dhe financiare ndaj komisioneve parlamentare është më se e domosdoshme sidomos në shqyrtimin e propozim-ligjeve dhe përdorimin e ekspertizës gjatë ligjbërjes.

A kërkohet angazhim më i madh, patjetër se po. A mungon vullneti politik për angazhim më të madh apo mungon profesionalizmi, kjo mbetet, do me thënë, obligim i të gjitha institucioneve, të Kuvendit, të Qeverisë, plotësimi i kuadrit ligjor dhe politikave publike për sigurimin e paanshmërisë, të profesionalizmit dhe të efikasitetit të administratës publike. Mendoj që duke e krijuar edhe klimën e favorshme për zhvillimin e biznesit, duke përfshirë funksionim adekuat të autoriteteve edhe rregullative, mbikëqyrëse dhe qeverisjes së korporatave, të gjeturat e këtij raportoi mendoj që duhet sa më shpejtë dhe në mënyrë emergjente, do me thënë, të plotësohen dhe mos të përsëriten në vitin e ardhshëm. E thashë këtë me qëllim, sepse i vetmi mekanizëm alternativ tani për tani, siç është matja e progresit në Kosovë dhe e performancës së institucioneve të Kosovës, që e lehtëson rrugën tonë për anëtarësim në Bashkimin Evropian, mendoj që duhet të rregullohen, sepse prapë se prapë edhe në vitet e mëvonshme, kur ne do t'i plotësojmë kriteret për anëtarësim, kërkohet plotësimi i këtyre standardeve. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Sipas radhës, fjalën e ka deputetja Donka Kadaaj – Bujupi.

DONIKA KADAJ – BUJUPI: Ju faleminderit!

Të them të drejtën, nuk ka mbetur vend për të folur, se nuk keni lënë vend për të debatuar më tutje për kurrgjë dhe krejt çka themi sot, është irelevante me ato për çka po vazhdon kjo seancë. Ato që po dua të mos i mbetem borxh këtij Kuvendi dhe kryetarit, i cili nuk qenka këtu tash, është që është shumë e vërtetë që me politikat e juaja dhe me veprimet i keni bërë njerëzit e Kosovës të ndihen keq, i keni bërë qytetarët e Kosovës që në Kosovën e pavarur të ndihen shumë keq. Të vetmit njerëz që po ndihen mirë, si duket jeni ju që keni uzurpuar gjithçka dhe në këtë uzurpim nuk po e vëreni se Kosova nuk është mirë edhe kur po ju vijnë raportet që flasin me zëra kritik për ta kthyer Kosovën në binarë, ju prapë po injoroni dhe po silleni sikur kurrgjë nuk ka ndodhur, sikur këto janë raporte të shkëlqyeshme, sikur Kosova është mirë. E Kosova dhe qytetarët e saj nuk janë mirë. Besoj që një ditë shumë shpejt do ta vëreni edhe ju këtë, por sigurisht do të jetë vonë. Çka mund të them është që ajo çka po bëni, krejt kjo që po e bëni, është një vendim që po e futni në praktikë për ta shkatërruar shtetin e Kosovës, shtetin e ri që nuk i ka ende dy vjet. Për dy vjet keni bërë që ky shtet sot të jetë në pikën zero. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Për fjalë është paraqitur deputeti Hajredin Kuçi, zëvendëskryeministër.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,
Anëtarë të Qeverisë,

Më lejoni që në fillim të them se diskutimi për Raportin e progresit, besoj edhe ata të cilët e kanë propozuar dhe cilit duhet t'i falënderojmë edhe Grupi Parlamentar, në veçanti, edhe Komisionit për Integritet Evropian, ka pasur dhe ka për qëllim diskutimin për fuqizimin e institucioneve të Kosovës dhe rritjen e seriozitetit në plotësimin e sfidave që dalin nga Raporti i progresit, por gjithsesi besoj që një reflektim të përbashkët ta vejë si shoqëri për këtë raport të progresit dhe për zhvillimet në perspektivën evropiane. Natyrisht, mos të bëhemi shumë demagog, këtu ka edhe pak fushatë, dhe kjo është krejt normale, besoj, në këtë kohë të fushatës.

Ajo çka dua të them është, besoj që thanë, e ka përendur profesor Hamiti, por besoj është mirë ta themi, Kosova në këtë rast i ka marrë tri dokumente. Është e para, studimi i fizibilitetit, që për arsye të ndryshme Komisioni Evropian nuk e quan studim të fizibilitetit, por vetëm studim. E dyta është që quhet Raport i zgjerimit, që i përfshinë 8 shtetet pretenduese, edhe Kosovën për anëtarësim në Unionin Evropian dhe, e treta, Raporti i progresit. Vetëm nëse lexohen bashkë, jepet kuptimi i drejtë. E them unë se është një korrelacion. Pse? Unë e di që pozita është më e interesuar që ta theksojë studimin e fizibilitetit dhe Raportin për zgjerim. Unë e di po ashtu që opozita do më shumë Raportin e progresit. Por, ajo çka më intereson mua, besoj të gjithë neve, këto nuk mund të shihen të ndara. Sado që mund të jetë i avancuar Raporti i progresit, nëse nuk kemi perspektivë evropiane, çfarë nuk kemi pasur deri në këtë vit, unë besoj që nuk do të kishim rezultate, sikurse e kundërta. Sado që na jepet mundësi me studimin e fizibilitetit për liberalizimin e vizave, për marrëveshje tregtare dhe për marrëveshje për stabilizim-asocim, nëse ne nuk i kthejmë këto në veprime për plotësimin e sfidave që dalin nga Raporti i progresit, edhe kjo perspektivë nuk do të jetë e qartë. Pra, të provojmë të shohim si të përbashkët, si tërësi dhe në korrelacion njëra me tjetrën. Natyrisht që dokumenti i parë që ka të bëjë me studimin e fizibilitetit, i ka dhënë Kosovës mundësi apo ia ka hapur derën për perspektivën evropiane. Unë e di që Raporti i progresit bashkë me ju ka filluar në Kosovë më 2005. Por, e di se Kosova nuk ka qenë në agjendën e Komisionit Evropian, jo që nuk ka punuar në Kosovë, ka punuar edhe atëherë, ka punuar edhe në vitin e kaluar, edhe tani. Por, është hera e parë që Kosovës i është hapur perspektiva, i është hapur për tri gjera: liberalizimin e vizave, marrëveshjen tregtare dhe marrëveshjen për stabilizim-asocim.

Në këtë drejtim duhet t'i falënderojmë të gjitha shtetet anëtare të Unionit Evropian, edhe ato që e kanë njohur Kosovën, por edhe pesë sosh që nuk e kanë njohur Kosovën, por i kanë dhënë pëlqim perspektivës evropiane për Kosovën me gjithë dilemat që i kanë për statusin e Kosovës. Në drejtim të liberalizimit të vizave ne kemi marrë hapa më herët, kemi bërë një udhërrëfyes, kemi filluar strategjinë, kemi filluar implementimin, por kanë qenë hapa të njëanshëm. Në drejtim të marrëveshjeve tregtare, u besoj që edhe legjislacioni që është nxjerrë në këtë vend, por edhe veprimet tjera që janë bërë - përmirësimi i ekonomisë, tregtisë dhe të tjerave, kanë pasur për qëllim respektimin e ekonomisë së lirë të tregut dhe të kriterëve që kërkohen nga Unioni Evropian. Por, ajo çka dua të them është, në këtë rast është hera e parë kur ne jo vetëm që kryejmë detyrat e shtëpisë vet, por do ta kemi edhe dikë që do të na i shikoj ato detyra a po i kryejmë mirë apo jo dhe mbi të gjitha dikush që do të na tërheqë vërejtjen nëse nuk e kemi kryer ndonjë detyrë. Me fjalë tjera, unë jam profesor, pak më lejoni ta marr një krahasim një digresion. Studenti ka mund të përgatitet, por nuk ka mund të hyjë në provim. Kësaj radhe, ne mund të hyjmë në provim, do të thotë ne kemi mundësi që t'i kryejmë detyrat tona dhe të hyjmë në provim. Sa më afër që jemi për anëtarësim në Union Evropian, llupa që do të na shikojë do të jetë më e madhe, sa më afër. Unë ju premtoj që vitin

tjetër edhe më në detaje do të na shikojnë. Do të thotë, mos të mendojë dikush që me afërsinë në Union Evropian do të zvogëlohet mbikëqyrja e Komisionit Evropian.

Një çështje tjetër që dua ta themi edhe sot. Ne kemi bërë disa vlerësime për Raportin e progresit dhe ato vlerësime kanë mundur të dalin nga dikush shumë pozitive, dikush e thotë apo pozita apo Qeveria, dikush shumë negative dhe unë e them të ndërmjetme. Ne kemi thënë ditën e parë që e kemi marrë Raportin e progresit, është raport real. Me thënë diçka që është reale, unë mendoj se është edhe guxim edhe politik edhe qytetar, por edhe obligim institucional. Kur të thuash është diçka reale, i ka dy gjëra përparësi. E para, nuk mund të justifikohet askush për lëshimet, as Qeveria, as dikush tjetër dhe, e dyta, kur të themi është reale, është gjendje që na stimulon neve të ndryshomë gjendjen. Nëse themi që gjendja në luftën krimit të organizuar, luftën e korrupsionit dhe tjetër janë reale në Kosovë që duhet të punojmë më shumë, ky është një motivim më tepër dhe në vlerësimet tona, ne e kemi edhe punën e Qeverisë, e kemi edhe të Kuvendit dhe të agjencioneve të pavarura dhe të gjyqësorit. Unë e di se Qeveria i ka ndërmarrë dhe është mirë t'ju njoftoj për disa hapa. Përveç takimeve që i kemi bërë në Qeveri, konstatimeve, kemi bërë takimin dy herë të Këshillit ndërministror, ku marrin pjesë jo vetëm anëtarët e Qeverisë, por edhe akterët tjerë të institucioneve të Kosovës. Kemi identifikuar sfidat që kanë dalë nga Raporti i progresit, kemi vënë ato sfida me përgjegjësit në afate kohore dhe i kemi inkorporuar në Planin e punës së Qeverisë për vitin 2010.

E dyta, apo veprimi i dytë që ka qenë, kemi diskutuar me të gjitha agjencionet të cilat kanë obligime nga ky Raport i progresit që t'i kryejnë detyrat dhe punët e veta. Kemi tentuar që t'i inkorporojmë në buxhetin e Kosovës sfidat që dalin dhe të mbulohen, kemi tentuar dhe kemi kërkuar nga projekti i IPA-s, i Komisioni Evropian që institucionet e para anëtarësimit të financohen me prioritet sfidat që dalin nga Raporti i progresit. Kemi kërkuar nga donatorët të njëjtën gjë dhe po ashtu çka dua të them, kemi përfshirë në planin e veprimit të partneritetit evropian me rishikimin që po e bëjmë. Unë dua ta falënderoj Komisionin për Integritet Evropian që e ka bërë të njëjtën punë sa i përket Kuvendit dhe tanimë janë të inkorporuara këto punë dhe ky korrelacion i punëve është edhe me të gjitha institucionet. Në Kosovë nuk mund të lavdërohet dikush që ka kryer punë më shumë, dikush më pak. Kosova do të hyjë në Union Evropian si tërësi dhe një segment nëse çalon, cili do që të jetë ai, nuk duhet të ndihemi mirë, përkundrazi duhet t'i ndihmojmë atij segmenti.

Unë nuk them që çdo gjë që është bërë, është perfekte e mundur, por ajo çka dua të them pa dashur me justifikim, vërejtjet kryesore apo më të mëdha i marrim në fushën e sundimit të rendit dhe të ligjit. Janë dy befasi këtu. Befasia e parë, edhe korrupsioni, natyrisht, kudo që gjendet ai dhe, ajo çka dua të them, janë dy befasi. Befasia e parë është që kemi një sistem gjyqësor në Kosovë, që është tërësisht i pavarur në kuptimin e bazës legale dhe në këtë drejtim, në emër të pavarësisë, edhe gjyqësori, por edhe agjencionet e pavarura, kemi momente të caktuara kur i ikin llogaridhënies. Unë nuk e di, jam jurist, me profesion jam zëvendëskryeministër, unë nuk e di kujt i përgjigjen ata. Besoj që në një mënyrë në gjendje të njëjtë përafërsisht jemi të gjithë. Befasia e dytë është – mbikëqyrja dhe konstatimi i Raportit të progresit vjen nga Komisioni Evropian dhe në Kosovë e kemi një mision që quhet EULEX, që ka kompetenca mbi gjyqësorin e Kosovës, mbi Policinë e Kosovës, mbi doganat e Kosovës. Unë nuk dua t'i fajësoj ata që nuk e kanë kryer punën e vet, por i ftoj ata të na ndihmojnë ta kryejmë punën pak më mirë. Në këto fusha kemi bërë një marrëveshje me EULEX-in, kemi bërë një plan të përbashkët në fushën e gjyqësorit, të policisë dhe të doganave që në vitin 2010 të mos punojmë në mënyrë paralele, do ta quaja kështu, por të punohet bashkërisht në

objektivitet, qëllimet dhe në fund ta kemi një rezultat ku do t'i raportojmë njëri tjetrit, por mbi të gjitha do t'i raportojmë Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të Republikës sonë. Sa më i dobët që është gjyqësori në Kosovë, do të kem skena më shumë ku ka debate politike për çështjet e drejtësisë.

Unë jam ithtar që çështjet e drejtësisë t'i kryejë drejtësia, çështjet e politikës t'i kryejë politika dhe në këtë drejtim unë jam shumë i bindur që gjithë bashkë do të kemi angazhime konkrete në këto fusha. Ne kemi bërë edhe disa veprime tjera, që është mirë për Kuvendin. Fusha e prokurimit publik ka vërejtje dhe këtë fushë, me iniciativën time, po bëhem pak jo modest, kryetari i Kuvendit ka thirr të gjithë përgjegjësit e KRPP-së, APP-së, OBSH-së dhe i ka ftuar ata bashkë me Komisionin Evropian, përfaqësuesit e Komisionit, çka duhet të bëjnë. I kemi identifikuar fushat, përveç bazës ligjore, ka nevojë të bëhen edhe ndryshime tjera. Deri me iniciativën që e ka dhënë edhe kryeministri për një prokurim elektronik. Ndoshta ka mundësi, së paku të mos..., unë e kam quajtur shumë të hapur, në mënyrë legale të mos lejohet korrupsioni, por të luftohet dhe në këtë drejtim, ne kemi nevojë që këto agjencione, t'ju njoftoj juve, deputetë të nderuar, që nga kryetari dhe të tjerët, agjencionet e pavarura që i ka themeluar Kuvendi i Kosovës, të kërkojë llogari për punën e tyre sipas afatit dhe mundësive ligjore, jo t'ua prekë autonominë ose pavarësinë e tyre, po një raport pune është mirë ta dimë secili prej nesh. Nëse ne do të bënim ndonjë kërkesë të tillë, me siguri që dikush kish pasur për të thënë – është ndërhyrje e kompetencave në pushtetet e ndara. Natyrisht, për sistemin e gjyqësorit, jemi në dry procese me rëndësi. Procesi i parë është riemërimi i gjyqtarëve dhe i prokurorëve. Ju e dini që ky proces tani është në fazën finale për Gjykatën Supreme dhe për Prokurorinë, por ajo çka dua të them, presidenti ka kompetencat e veta në riemërim, është mirë ta themi para të gjithë qytetarëve të Republikës, në procesin e përzgjedhjes dhe të vlerësimit të tyre, nuk ka asnjë qytetar të Republikës së Kosovës. A është mirë a keq, besoj që dikush tjetër jep vlerësimin, por unë jam i bindur se një tjetër riemërim duhet të përshpejtohet aktiviteti dhe, e dyta, që e përmendi edhe deputeti Zemaj, është fjala për 4 ligjet. Qeveria i ka përgatitur, Ministria e Drejtësisë ka përgatitur që gati një vit Ligjin për gjykatat, Ligjin për Këshillin Gjyqësor, Ligji për Prokurorinë, Ligji për Këshillin Prokurorial, por që një vit ka mosmarrëveshje në mes akterëve ndërkombëtarë. Unë po bëhem pak sa më i hapur se sa duhet dhe ata një mënyrë, për shkak të gjërave të tilla nuk na i kanë lejuar që t'i procedojmë në Qeveri ose më shumë t'i biem në Kuvend. Unë kam bërë presion...

KRYESUESI: Edhe dy minuta!

... bashkë me ministren Kelmendi, bile ministrja Kelmendi ndoshta edhe më shumë, që t'i procedojmë këto ligje, duke marrë parasysh edhe sugjerimet e tyre, por mospasja e këtyre ligjeve krijon një ambient jo të mirë. Por gjithashtu, mos të harrojmë, ne duhet të kemi ngritjen e bazës materiale për gjyqtarët dhe prokurorët në Kosovë, të sigurisë së tyre fizike dhe të sigurisë tjetër për çështjet të cilat lidhjen me gjyqësorin. Natyrisht, këtu besoj që Kuvendi mund ta luaj rolin e vet shumë më shumë se Qeveria, por unë pajtohem me profesor Smakën që e tha, të gjithë duhet në një mënyrë ta kemi një balancë apo një kontroll reciprok. Unë kam dëshirë të na kontrollojnë neve si Qeveri, dikush si Kuvend, dikush si gjyqësor, por të gjithë ta dimë që jemi pjesë e një sistemi që quhet Kosovë. Unë e di që nëse marrim parasysh Raportin e progresit, po e them me bindje të plotë, në planin politik është sukses, është sukses, na është hapur dera për perspektivë evropiane, për liberalizim të vizave, për marrëveshje tregtare dhe stabilizim-asocim. Në planin teknik ka sfida dhe nuk do të krijoj iluzion nëse them sfidat do të përballohet për një vit. Ne i kemi identifikuar 1568 sfida. Unë jam i bindur që me punë,

me aktivitet e kalojmë 70%-shin e këtyre sfidave, nuk them të gjitha, janë sfida që do të merremi tërë jetën, lufta kundër korrupsionit, krimet të organizuar, dukurive tjera negative janë punë permanente që merren edhe shtetet më të avancuara të Unionit Evropian, por duhet ta bëjmë infrastrukturë të qëndrueshme në vendin tonë dhe perspektiva evropiane, unë jam shumë i bindur se do të ketë sfida, do të ketë angazhim dhe ka perspektivë evropiane me një, unë do ta quaja, politikë të përbashkët nacionale. Nuk jemi asnjëri më pak ose më shumë për perspektivë evropiane, jemi të gjithë bashkë, por rolin prijatar, në kuptimin e përgjegjësisë, gjithsesi ta marrë Qeveria, por nuk është vetëm. Të gjithë ne duhet ta kryejmë punën tonë, t'i kryejmë aktivitetet tona dhe ta kuptojmë se ky proces do të zgjatë pak, do të kemi sfida pak më shumë se sa duhet, koncentrim më të madh dhe shpeshherë unë e quaj, po e përfundoj krejt, ju faleminderit edhe për vëmendjen, procesi i përmbushjes së sfidave që lidhen me integrimet evropiane, është po aq i rëndësishëm sa anëtarësimi në Union Evropian. Nëse ne i realizojmë sfidat me sukses, i kemi arritur standardet çfarë Zvicra ose Norvegjia, që edhe kur nuk hyjnë në Union Evropian, jetojnë mirë. Ne duhet të punojmë që edhe të hyjmë në Union Evropian, por edhe të jetojmë mirë. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka, deputetja Njomza Emini. Nuk është paraqitë, e paska pasur akoma Emrin. Atëherë, Mimoza Ahmeti.

MIMOZA AHMETI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra dhe të nderuar deputetë, Raportin e progresit të BE-së, lexuar në tërësi do ta ndaja në tri kategori. Obligimet e realizuara apo të arritura nga institucionet e Kosovës deri tani, ato që kanë qenë në proces dhe që në kohën kur raporti është përpiluar, që nga koha kur raporti është përpiluar, janë realizuar dhe nuk janë të përfshira në ë raport, si dhe ato që nuk janë realizuar, por janë ende, mbesin obligim që në një të ardhme të plotësohen.

Kosova, si të gjitha shtetet e këtij regjioni, do me thënë Ballkani Perëndimor, që kanë për aspiratë anëtarësimin në BE, sipas raportit ka ngecje dhe të arritura. Do të ndalesha deri të të arriturat e deritanishme të paraqitura në raport, siç janë: rritja reale e bruto produktit vendor prej 5%, sa ishte në vitin 2008, në 5.4% në vitin 2009. Pastaj, rritja e investimeve kapitale në 194%, rritja e bruto produktit vendor për kokë banori sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar, nga 6.5% sa ishte në vitin 2007, në 6.9 këtë vit, si dhe rritja e eksporteve ndaj shteteve të BE-së nga 42%, sa ishte në vitin 2007, në 47.8%, në vitin 2008 janë vetëm disa nga treguesit e politikave të qëndrueshme financiare, me çka i jemi shmangur ndikimit të krizës globale dhe njëherësh paraqet përkushtimin tonë për të ndërtuar vendin. Si të arritura të Qeverisë gjithashtu konsiderohet edhe rritja e kapaciteteve të saj, krijimi i ministrive të reja dhe i institucioneve të reja, emërimi i disa zyrtarëve të lartë në pozitat kyçe dhe përpjekjet për përmirësimin e gjendjes së pakicave. Në raportin e këtij viti, Komisioni në raport për Kosovën nuk e ka kritikuar apo është më pak i kritikuar Parlamenti në krahasim me vitet e shkuara. Raporti i progresit thekson gjithashtu se Kosova ka shënuar një përafrim të legjislacionit dhe të politikave me standardet evropiane, në veçanti në dogana, në bujqësi dhe lëvizje të lirë të mallrave. Është bërë harmonizimi i strategjive, strategjisë legjislative në mes të Qeverisë, Parlamentit me *acquis-communitaire*. Vetëm në legjislaturën e fundit janë shqyrtuar 170 projektligje, prej të cilave 118 janë miratuar, 22 i janë kthyer propozuesit, ndërsa 30 janë në shqyrtim. Kjo tregon që ne si shtet jemi ende në fazën e krijimit të legjislaturës që është themeli i shtetit ligjor dhe që në këtë raport përmendet si përparim në këtë drejtim.

Janë shënuar reforma në pushtetin lokal. Progres po ashtu ka pasur edhe në fushën e statistikave, sidomos të atyre të ekonomisë, të bujqësisë dhe të biznesit, megjithëse ende mungojnë statistikat demografike dhe ato sociale. Vërejtjet të cilat i kam hasur në raport dhe që e përmenda më parë, që janë çështje të cilat janë përmend se nuk ekzistojnë, po që në të vërtetë në ndërkohë janë realizuar, janë: zgjedhjet lokale të përfunduara me sukses dhe të organizuara për herë të parë nga vendorët, si dhe pjesëmarrja e serbëve në to, që është paraqitur në raport me shumë dilema dhe që ka paraqitur një sfidë të madhe për Kosovën. Përmendet mungesa e Ligjit mbi financimin e partive politike, që në Parlament e ka kaluar leximin e parë dhe është në procedurë. Gjithashtu, përmendet mungesa e Ligjit mbi Institutin e Mjekësisë Ligjore, i cili kohë më parë ka kaluar në Parlament dhe Instituti si i tillë apo Departamenti i Mjekësisë Ligjore tanimë i takon Ministrisë së Drejtësisë, e jo si ka qenë deri më tani në kuadrin e Ministrisë së Shëndetësisë. Është e vërtetë që neve ende na mungon Ligji mbi autopsinë.

Bordi i RTK-së, po ashtu është themeluar në ndërkohë. Çështja e demarkacionit të kufirit me Republikën e Maqedonisë, marrëveshje e cila është nënshkruar dhe Parlamenti e ka ratifikuar atë marrëveshje. Mirëpo, neve na mbeten edhe shumë çka për të bërë më tutje. Çështje e cila e meriton të trajtohet më vëmendje, mendoj se është krimi i organizuar, sidomos ai në Veri, që është identifikuar si problem serioz, sado që EULEX-i e bën regjistrimin e hyrjeve të mallrave nga Serbia në Kosovë. Sa i përket korrupsionit, në raport përmendet një përparim, mirëpo gjithsesi korrupsioni mbetet një çështje që prek shumë fusha të veprimtarisë në Kosovë dhe vazhdon të jetë çështje mjaft serioze shqetësuese dhe neve na mbetet për të krijuar një strategji për ta luftuar atë. Është e qartë se një korrupsion i krijuar për vite të tëra do të jetë mjaft e vështirë të luftohet për një periudhë kaq të shkurtër. Mendoj se kjo e kërkon një vëmendje të posaçme dhe një punë mjaft të vullnetshme. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka Lutfi Haziri, le të përgatitet Kaqusha Jashari.

LUTFI HAZIRI: Ju faleminderit, Kryetar!

Zëvendëskryeministra,

Ministra të Kabinetit,

U dhanë shumë shpjegime nga zëvendëskryeministri, sepse shumica e deputetëve po flasin për dokumentin kryesor apo për dokumentin që e njohin më mirë, që e kanë pritur gjatë këtij viti, Raportin e progresit për këtë vit. Ajo që këtë vit e dallon Kosovën prej viteve të tjera ka të bëjë ëme dy dokumente plotësuese që u përmendën këtu. Nuk dua t' i përmend, por lista e bardhë apo rruga në të cilën Kosova do të kalojë në liberalizim të vizave është sfida kryesore që do ta ketë Kosova dhe që Kosovën e dallon nga shtetet e Ballkanit Perëndimor. Natyrisht, që Islanda dhe Maqedonia janë duke pritur për datë anëtarësim, është dallim shumë i madh, por në kuadër të procesit të integritimeve, përfshirja bëhet sipas kriterëve që tashmë organi më i lartë ekzekutiv i popujve të Evropës e përcakton, ndërsa Kosovën e dallon edhe nga Bosnja e Hercegovina dhe Shqipëria. Çështja e listës së bardhë, Kosovën e ka vendosur për momentin në kategorinë e shteteve si Afganistani, në kuptimin e shfrytëzimit të drejtës për viza. Ajo që duhet përballuar Qeveria jonë si organ kryesor i cili menaxhon, koordinon dhe udhëheq politikat për integrim, ka të bëjë me koordinim më të mirë ndër-institucional nën udhëheqjen e Qeverisë, që përfshin edhe zyrat, organet, shoqërinë civile dhe kategoritë tjera që duhet të jenë të përfshira në këtë proces. Duhet që kapaciteti plotësues të ketë në Ambasadën tonë në Bruksel, sepse ambasadori, sekretari i parë dhe stafi diplomatik nuk do të kenë mundësi për të ndihmuar apo për të ndikuar procesin e lobimit për detyra apo për agjenda të caktuara politike që lëshohen nga këtu, nga Prishtina, në

mënyrë që sfida që u përmend nga zëvendëskryeministri nga 5 shtete që nuk e kanë njohur Kosovën si shtet të pavarur, të arrijmë ta zbusim edhe në çështjen apo në kërkesën e listës së bardhë për çështje të agjendës së liberalizimit të vizave. Edhe tek dokumenti tjetër, Studimi i fizibilitetit, përkundër sponsorëve shumë të mëdhenj që Kosova i ka pasur, këtë studim u pa që legalisht ka probleme, edhe pse dokumenti është përballur, është nxjerrë edhe përcakton qartë rrugën në të cilën Kosova do të kalojë. Unë jam pro një koordinimi më të mirë, shumë më të mirë, i cili do të angazhonte edhe ekipe plotësuese për të ndihmuar përmes mbështetjes buxhetore dhe përmes gjetjes së formave që Brukseli si kryeqytet kryesor, do ta arrinte gradualisht të kuptojë dhe të gjejë forma, mekanizma që Kosovën mos ta largojë nga agjenda e shteteve të BE-së, apo për të mos ta dallojë nga agjenda e shteteve të BE-së që i përkasin Ballkanit Perëndimor. Nëse ne nuk e përballojmë këtë dallim, mendoj që rruga jonë do të jetë pak më sfiduese, më e gjatë edhe me vështirësi më të mëdha, mbesim komunitet i mbyllur dhe mandej problemet që mund të reflektohen në këtë kuptim, më shumë të natyrës së nevojave të përditshme që kanë qytetarët se sa vetë ne që mund t'i shohim. Një stimulim më i madh në kuadër të angazhimeve, por Komisioni Parlamentar është munduar sinqerisht ta bëjë punën e vet. Unë e mbështes planin e veprimit. Ai plan i veprimit numerikisht, përmes mjeteve formale nuk domethënë që i ka arritur qëllimet e veta. Nëse nuk arrijmë t' i largojmë nga rendi i punës veprimet me përmbushje të detyrave, çdo ditë, në këtë agjendë ne jemi të mangët. Besoj se ky koordinim mes ekzekutivit dhe legjislativit, do të duhej të jetë më i mirë në përmbushjen e të gjitha detyrave.

Një plan dinamik i madh, i cili Kosovën do ta detyronte për të punuar në këtë rrafsh me një agjendë të ngjeshur dhe realizim të detyrave permanente, do të bënte që studimi i tashmë të avancohet apo Kosova t' i ofrohet një hap më shumë realizimit të objektivave. U përmend legjislacioni, dëshiroj veç edhe një herë të konfirmoj për shkak të korrektesisë. Në mbledhjen e kaluar kur kemi debatuar për buxhet, anëtari i Kryesisë, kolegu ynë profesor Sabri Hamiti, i ka përmendur dy ligje që janë pjesë, pjesë edhe progresit të raportit, Ligji për Qeverinë dhe Ligji për qytetin e Prishtinës, janë pjesë e agjendës tonë. Ai në emër të Grupit Parlamentar, herën e kaluar e ka përmendur si pjesë të angazhimeve konkrete që duhet me pasur na. Andaj, edhe kjo duhet t' i shtohet 4 ligjeve që u përmenden për punën e sundimit të ligjit. Duhet të sillen, në mënyrë që formalisht të kemi mundësi ne t' i ndajmë angazhimet tona, me ligj t' i rregullojmë punët tona, veprimet e tona edhe në punë edhe në angazhim edhe në rregullimin e jetës institucionale për vetë institucionet dhe për vetë shtetin për të cilin po punojmë. Ju faleminderit shumë.

KRYTARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka, deputetja Kaqusha Jashari, le të përgatitet deputeti Naser Rugova.

KAQUSHA JASHARI: Ju faleminderit, Kryetar!

Të nderuar të gjithë të pranishëm,

Edhe unë jam përcaktuar më shumë për raportin e Komisionit evropian, jo se i kemi dhënë më shumë kujdes këtij dokumenti, por është bazë për një punë e cila kërkohet nga ne. Prandaj, ky raport i cili është bërë në atë mënyrë që është dhënë vlerësimi për çdo sektor dhe resor të jetës, institucioneve tona, prandaj kemi një pasqyrë dhe një mundësi t' i propozojmë edhe masat konkrete për evitimin e dobësive. Pra, në raport gjithashtu është dhënë edhe progresi në të cilat këto segmente është arritur diçka, po sugjerimi i këtij raporti edhe shqyrtim, vërtet shqyrtimi i këtij nga ne mund të jetë edhe nga këndi prej të cilës ne po e shikojmë atë. Në qoftë se e shikojmë nga këndi i opozitës edhe me paragjykime, atëherë është, kurrë nuk është bërë, a në qoftë se e shikojmë

nga këndi i pozitës, është bërë më tepër se çka është e vërtetë. Prandaj, unë do të përpiqem, në qoftë se mund vetë ta shikoj, në tjetër mënyrë të vlerësimin real, se unë mendoj se ky moment në të cilin na gjendemi, është momenti ku duhet seriozisht ta shikojmë raportin me syrin real dhe e kemi formimin e shtetit, fillimi i formimit të shtetit. E kemi gjithashtu kërkesën për veprime funksionale të institucioneve dhe zbatimin e ligjeve e gjithashtu edhe Kushtetutës.

Prandaj, do të përpiqem në këtë drejtim ta shikoj edhe i kam nxjerrë sipas vlerësimit tim një 6 pika. Prioritet është sikur që thashë forcimi dhe funksionimi i shtetit. Prandaj, nuk e shoh të arsyeshme të përmend progresin se është dhënë në raport, duke filluar prej doganave edhe sektorëve tjerë, por këto 6 pika unë mendoj se janë këto. Nën një, për mua është shumë e rëndësishme që është dhënë vlerësimi për kapacitetin e administratës publike të Kosovës, ku janë dhënë vlerësimet se ende nuk ka transparencë për emërimet publike, gjithashtu është dhënë ai vlerësim i cili që me vite, po thonë, që është, që ka ndikime politike në zgjedhjen e njerëzve që po punojnë në administratë, a këtu e kemi kërkesën që prioritet i cili është për partneritetin evropian, është profesionalizëm dhe llogaridhënie. Shumë është problem për t'ia filluar kësaj pune, vetëm unë mendoj se është rendi, në qoftë se duam funksionimin e institucioneve, të shohim kapacitetin njerëzor a është profesional edhe a është nën nivelin e detyrës?

Nën dy, e kemi drejtësinë, nuk do t'i përmend krejt këto çka kam shënuar, vetëm këtu po theksohet korrupsioni në gjykata dhe nuk janë hetuar si duhet. Prandaj, sistemi i gjyqësisë mbetet i dobët, i cenueshëm nga intervenimi politik dhe jo efikas. Intervenimin politik, unë nuk e konsideroj në qoftë se Ministria e Drejtësisë e ka këtë resor edhe ajo e ka përgjegjësinë për gjykatat. Prandaj, unë nuk e konsideroj angazhimin e tyre në ligjshmërinë edhe në funksionimin e gjyqeve dhe këtu duhet patjetër të ndërmerret se e kemi, sidomos tash po shohim momentin në të cilin në po kalojmë që kemi shumë problem në funksionimin e drejtësisë.

Nën tre, politikat kundër korrupsionit. Këtu është dhënë vlerësimi i mirë për mbështetjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, po jepet edhe një vlerësim që është bërë pak në këtë drejtim. Unë mendoj se pos përkrahjes së agjencisë ne nuk kemi krijuar në opinion një atmosferë asisoj që ndihmohet në luftë kundër korrupsionit në çdo hap edhe në çdo moment edhe prej çdo individi. Nuk është vetëm agjencia e cila duhet ta luftojë këtë.

Nën katër, mendoj se sistemi ligjor është një vlerësim shqetësues për mua ku thuhet që metodat informate dhe sektori informal është mbushur nga dobësitë prandaj, domethënë, mosrespektimi i ligjit edhe ne në këtë drejtim, mendoj se duhet të jemi qenë shumë syçelë edhe ta kërkojmë prej institucioneve përkatëse zbatimin e ligjeve të cilat ne këtu i aprovojmë.

Nën 5, e kemi, deri tash në diskutim nuk ka qenë kjo lëmi, punësimi dhe politikat sociale, vetëm këtu përmendet Ligji për punë, që ende nuk e kemi aprovuar, prandaj, domethënë, sugjerimi edhe i këtij raporti është Ligji për punë edhe përmendet kontrata kolektive që nuk zbatohet, sidomos për rroga minimale. Por, kontrata kolektive duhet të jetë rezultat i Ligjit për punë. Unë mendoj se në këtë drejtim, gjithashtu është një obligim. Unë e kisha shtuar edhe Ligjin për sigurimin pensional.

Nën 6, edhe e fundit që unë e kam shënuar, është vlerësimi për Ministrinë e Transportit. E lexoni mirë, zoti ministër, këtu po shkruan se Ministria është së tepërmi e angazhuar në çështjet e menaxhimit ditor të rrugëve, në vend të përqendrimit në strategji dhe

politikat zhvillimore. Këtë drejtim disa herë e kam diskutuar këtu në Kuvend. Unë mendoj se Ministria me riorganizimin duhet ta ndajë pjesën edhe merret me politikat zhvillimore edhe ta ndajë pjesën e implementimit se është konflikt interesash. Për ekonomi nuk them asgjë se shumë është raporti i detalizuar, ka një pjesë për buxhetin, tash jemi në diskutim të buxhetit. Në qoftë se ka diçka që duhet plotësojmë edhe harmonizojmë me kërkesat e këtij raporti, e kemi rastin. Edhe në fund e kam propozimin të bëhet një plan operativ për çdo institucion. Ne e kemi këtu këtë dokumentin, Plani i veprimit të Kuvendit, por e kam një përshtypje të ky plan, vetëm është dhënë dinamika e shqyrtimit e jo angazhimi për të ndërruar diçka. Prandaj, unë mendoj se çdo institucion, duke filluar prej neve në Kuvend edhe komisionet tona, deri te Qeveria edhe çdo ministri duhet ta vlerësojë këtë raport edhe të ndërmarrë masa konkrete e jo ta bëjë një orar çka në muajin, treshin e parë, çka në pjesën e tretë, dytën ose tretën, prandaj, mendoj se këtu nuk është vetëm ta shqyrtojmë, por të ndërmarrim masa. Edhe është një vlerësim që ne, nganjëherë bllokojmë edhe funksionimin me veprimet tona. Që, shembull, është këtu i cekur në raport që është bllokuar funksionimi i Agjencisë të Pronës, sepse bordi nuk është kompletuar, ndërkombëtarë janë zgjedhur e dy anëtarë vendor jo. Faji i kujt është, i joni, prandaj duhet pasur kujdes edhe në veprimet tona të cilat duhet të jenë të shpejta edhe jo t'i lëmë, që nganjëherë edhe nuk ne bëhet vonë kurrë

për disa veprime që janë shumë të rëndësishme. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka, deputeti Naser Rugova, le të përgatitet deputetja Besa Gaxherri.

NASER RUGOVA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Po diskutojmë sot për Raportin e progresit të Komisionit Evropian, i cili është një skanim i gjendjes që analizon në përgjithësi tërë sektorët e funksionimit të shtetit, sundimit të rendit dhe të ligjit, demokracisë, por edhe politikat sektoriale, që nga institucionet më të larta deri te ato të qeverisjes lokale. Nganjëherë në këtë Kuvend janë dëgjuar edhe fjalë që nuk përkojnë me rendin e ditës, sepse ne po diskutojmë sot për Raportin e progresit të Komisionit Evropian, njëkohësisht edhe për deklaratën për perspektivën evropiane të Kosovës, por edhe për planin e veprimit të Kuvendit si përgjigje tani ndaj këtyre sfidave. Dhe, konsideroj se kolegët deputetë, sidomos kryetarët e komisioneve funksionale, të cilët mund të japin kontributin e tyre të çmuar, duhet të jenë më konkret dhe të jenë të angazhuar, sidomos sa i takon punës së Kuvendit në raport me sfidat që dalin nga Raporti i progresit.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, nga raporti i parafundit, jo i fundit, i sfidave do të thotë, kemi evidentuar 110 sfida dhe duhet të jemi edhe vetëkritik, zoti kryetar nga 110 sfida kemi përmbushur pjesërisht vetëm 55. Ne tani si Kuvend i kemi marrë disa vendime, njëri nga ato është që secili komision funksional, në çdo mbledhje të tij ta ketë nga një pikë të veçantë- çështjet që kanë të bëjnë me procesin e integriteteve dhe me agjendën evropiane për Kosovën. Nëse i analizojmë me vëmendje të gjeturat, unë jam kundër shabllonit bardh e zi, do të thotë, sepse ka pasur edhe nga pozita edhe nga opozita nganjëherë vlerësime ad-hoc, paqartësi të deklaratave dhe nganjëherë edhe deklaratat që u kanë shërbyer koloritit politik dhe fushatës elektorale, por, vërtetë janë disa sektorë që raporti i fundit i progresit të Komisionit Evropian i nënvizon me të zeza, ku institucionet e Republikës së Kosovës duhet të marrin hapa urgjentisht, qoftë në aspektin legjislativ, qoftë në aspektin ekzekutiv, qoftë edhe në planifikimin e

mëttutjeshëm. Te puna e Kuvendit, sigurisht që këto dy vjet ka avancim punës së Kuvendit, ka funksionalizim më të madh të komisioneve funksionale të Kuvendit, por në vërejtjet, unë jam kryetar i një komisioni dhe nuk kem mbështetje as ekspertizë, sidomos për politikat sektoriale të fushave të caktuara. Besoj, zoti Kryetar, që ju personalisht duhet të angazhoheni dhe të fillohet që puna e Kuvendit, filluar nga kryetari dhe Kryesia dhe raportet me komisionet funksionale të intensifikohet korrelacioni i hallkave i hierarkisë dhe të bashkëpunimit në mes të Kryetarit të Kryesisë, komisioneve funksionale që do të kishte mpakte direkt dhe një presion pozitiv pse jo mbi panënën e ekzekutivit të vendit.

Paramendoni, janë në disa komisione ku janë sfidat nga ana e Raportit të fundit të Progresit të Komisionit Evropian, pse ministrat nuk paskan raportuar me shkrim për dytri çështje. Ju lutem, secili ministër, kemi pasur ministra dhe që nuk na kanë ardhur në komisione edhe kjo duhet të nënvizohet, duhet t'i kuptojmë këto çështje, si objektiv nacional i shtetit i institucioneve dhe i qytetarëve të Kosovës, sepse të gjitha këto të cilat mund të kryhen pa ndonjë mund të madh dhe nuk ka implikime financiare, me përjashtim të mbështetjes profesionale dhe mbështetjes së nevojshme logjistike dhe administrative, që vërtet është nevojë e domosdoshme për trupat funksionale të Kuvendit të Republikës Kosovës. Te Administrata Publike, te vërejtjet që jepen për emërimet politike e tjera. Është ministri i Administratës Publike këtu, por janë edhe ministrat tjerë. Këto janë vërejtje drejtuar në mënyrë konkrete dhe në qoftë se në Raportin e fundit të progresit, në raportin e ardhshëm më falni, progresit të Komisionit Evropian evidentohen, atëherë adresa është e qartë, janë ministratë gjegjëse. Ky raport edhe pse me tone kritike dhe me vërejtje serioze, e ka një të mirë, i ka precizuar adresat e përgjegjësive institucionale dhe ne si Kuvend tani edhe ne do ta shohim vitin tjetër se si jemi sjell dhe sa kemi punuar në evitimin e këtyre sfidave. Te liria e shprehjes dhe ndikimi i politikës në media, edhe këtu adresat janë të qarta, nuk dua të jap vlerësime ad-hoc dhe supozime edhe këtu do të shihet në raportin e ardhshëm. Tani jemi shtet, jemi shtetas dhe duhet të logjikojmë me logjikën e përfaqësuesve të një shteti të pavarur. Tek sistemi gjyqësor, thotë që sistemi gjyqësor është i korruptuar dhe ka ndikim të politikës në sistemin gjyqësor. Ta kryejmë punën tonë ne si Kuvend, me infrastrukturën e nevojshme ligjore, t'i mbështesim mekanizmat institucional, të cilët tek e fundit edhe paguhen nga taksapaguesit, nga qytetarët e Kosovës dhe të shohim se si do të shkoj se si do të shkoj puna tutje. Me një gjyqësi çfarë e kemi sot, nuk ka ecje tutje në Evropë dhe këtë duet ta kemi të qartë edhe ne si organi më i lartë legjislativ i vendit se kemi përgjegjësi që të prodhojmë ligje të nevojshme. Besoni, se disa ligje që i kemi kaluar këtu dhe që janë nënshkruar dhe kanë hyrë në fuqi, do të obligohemi që pas dy tri vite edhe një herë t'i plotësojmë dhe t'i rishqyrtojmë dhe kjo nuk na falet nëse jemi Parlament i një shteti të pavarur.

Te çështjet rajonale dhe obligimet ndërkombëtare, CEFTA dhe mekanizmat tjerë, zoti zëvendëskryeministër si njeriu kyç i Qeverisë, duhet të ndikoni, duhet të jeni më energjik dhe duhet të flisni si zëvendëskryeministër i Qeverisë duhet të ndikoni, duhet të jeni më energjik dhe duhet të flisni si zëvendëskryeministër i Qeverisë së një shteti. Nuk mund UNMIK-u, pothuaj se në prag të shënimit të dyvjetorit të pavarësisë të na përfaqësoj në këta mekanizma kaq të rëndësishëm. Dhe, te e fundit, ta shikojmë aspektin e marrëdhënieve bilaterale me shtetet që e pengojnë Kosovën në këtë organizëm jashtëzakonisht të rëndësishëm dhe t'i shikojmë edhe politikat e mundshme të parimit të reciprocitetit.

Te kriteret ekonomike, ka pasur mungesë të planifikimit të mirë buxhetor, në prioritete buxhetore, ndarje buxhetore të gabueshme, diskrepancë mes KASH-it dhe ligjet që i kem proceduar këtu që nuk janë në akordancë me implementimin e atyre ligjeve, dhe atëherë po del që nuk po funksionon ligji në Kosovë, sepse po bëjmë ligje të pa analizuara mirë, me kostot financiare dhe të cilat po hasin në pengesë tek ata që duhet t'i zbatojnë.

Te prokurimi publik, duhet të marrim masa emergjente në ndryshimin e Ligjit për prokurimin publik, por edhe të gjithë mekanizmat tjerë, disa që janë votuar edhe nga ky Kuvend, duhet ta rishqyrtojnë mirë punën dhe pozicionin e tyre.

Te punësimi dhe politika sociale dhe të shëndetësia, edhe këtu duhet të avancojmë, me legjislacion të nevojshëm dhe të bëjmë reforma të nevojshme. Këtu është ministri i Shëndetësisë, nuk qenka Ministri i Punës dhe i Mirëqenies Sociale, edhe këtu është një vërejtje serioze, sepse janë dy sektorë tejet të rëndësishëm që prekin pothuaj se çdo qytetar të Republikës së Kosovës.

Te bujqësia dhe mjedisi, janë disa veprime, zoti ministër i Mjedisit dhe i Planifikimit Hapësinor, i Bujqësisë nuk qenka këtu dhe do të duhej të ishte. Janë dy shtylla me të cilat Kosova mund të krenohet që mund t'i konkurrojë tregut evropian dhe mund të jetë pjesë e partneritetit konkurrues me shtetet, jo vetëm të Ballkanit Perëndimor, por edhe shtetet tjera. Janë bërë disa hapa pozitiv. Pritet një pako ligjore që duhet besoj, që deri në qershor të vitit 2010, duhet t'i përmbyllim të gjitha këto sfida që janë evidencuar në këtë raport. Luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit është sfidë që do të na përcjell, jo vetëm në këtë raport, por mbase edhe shumë vite të tjera. Adresa dihet. Është përgjegjësi institucionale e atyre që udhëheqin me Qeverinë dhe institucionet e shtetit të Kosovës. Si emërues i përbashkët i të gjitha këtyre kriterëve politike, ekonomike, standardeve evropiane, do të jetë testi i ardhshëm, qasja e Bashkimit Evropian ndaj liberalizimit të vizave. Nuk duhet të jem shumë euforik këtu, kemi shumë punë për të bërë. Janë mbi 50 kriterë teknike dhe dua të besoj që, nëse Qeveria, ekzekutivi i vendit dhe institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës e kanë kuptuar integrimin e Kosovës në Bashkimin Evropian, si objektiv nacional, do të arrijnë që me kriteret teknike të ecim krahas shteteve të tjera, duke i përmbushur edhe kriteret politike. Ju faleminderit për vëmendje.

KRYTEARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë dhe anëtarë të Qeverisë, të Kabinetit qeveritar, Realisht, kjo pikë tashmë është shtjerrë kisha menduar, megjithatë unë para se të filloj të flas pak për Raportin, ngul këmbë se vërtet ne kemi ardhur në seancë me pikën e rendit të ditës - Debat për Raportin e Komisionit Evropian për progresin në Kosovë për vitin 2009, sipas kërkesës së Komisionit për Integrim Evropian dhe të Grupit Parlamentar të LDD-së, e protokolluar dhe e marr për pikë të rendit të ditës. Dikush po pretendon që kemi tri dokumente, por ne edhe si Grup Parlamentar kemi kërkuar këtë pikë të rendit të ditës e cila është protokolluar kërkesa para një muaj e gjysmë, që dikush pretendon të thotë se po përdoret ky raport për fushatë. Për mua është ky shqetësim se dikush pretendon ose Qeveria pretendon të hedhë tek opozita akuzën se po përdoret raporti për fushatë, ndërsa dikush pretendon të jetë këtu më shqiptar e dikush më pak kur pretendohet të preken pika të cilat atakohen qytetarët e Kosovës çdo ditë me probleme të shumta dhe natyrisht të pa tolerueshme.

Tenderuar kolegë deputetë,

Ne jemi të vetëdijshëm se edhe pas, ndoshta pas disa viteve do të kemi performancë, dikush do të tentojë të na vlerësoj dhe kjo është krejt e ditur, por realisht ky raport flet për vitin 2009, domethënë, nga gjysma e vitit 2008 deri në korrik të vitit 2009, dhe shqetësuese është se ka ngecje, ka kthim mbrapa, nuk është, domethënë është raport, quhet Raport i progresit, por vërtet fatkeqësisht Lidhja Demokratike e Dardanisë nuk është e kënaqur që ka regres, por është realitet. Ne po i referohemi një raporti të cilin e ka hartuar një institucion shumë i rëndësishëm, siç është Komisioni Evropian për Parlament dhe Këshillin Evropian. Sa i përket këtij raporti, unë kam pas menduar të ndalëm në kriteret politike, ekzistimi i një ekonomisë funksionale të orientuar në treg, prokurimin publik, punësimin dhe politikat sociale, mjedisi, energjia, drejtësia, liria dhe siguria dhe shpëlarja e parave. Janë prekur këto pika nga kolegët e mi disa, por shumë shkarazi do të mundohem edhe unë ta mendimin tim lidhur me këto fusha. Realisht ky raport, ka vlerësuar 35 fusha të funksionimit të jetës në Kosovë dhe realisht që të 35-ta janë të përformuara negativisht dhe ne, mu më shqetëson edhe fakti që vërtet nuk jemi korrekt, nuk jemi të sinqertë, në radhë të parë institucionet siç është Qeveria, që duhet t'i marrë shumë seriozisht këto vërejtje dhe duhet të japë plane konkrete me afate të caktuara për përmirësimin e performancës në Kosovë dhe jo të hidhet topi herë pozitiv, herë opozitë, dhe herë ma shqiptar e herë më tradhtar, jo është e papranueshme dhe e turpshme për ne.

Mendoj, në qoftë se flasim në pika të shkurta për kriteret politike, te Kuvendi përfshihet, domethënë demokracia dhe sundimi i ligjit, Parlamenti dhe Qeveria. Për Parlamentin nuk dua të flas shumë, vetëm një fjali po e lexoj: “Kërkohet nga ky raport mbikëqyrja parlamentare e Qeverisë pra duhet të rritet”, gati në çdo seancë Lidhja Demokratike e Dardanisë ka tërhequr vërejtjen që Parlamenti është organi më i lartë, i cili duhet të kërkojë llogari nga Qeveria e jo Qeveria të kërkojë llogari dhe ta kthejë Parlamentin në një vegël ashtu siç është e kthyer deri sot. Qeveria, do t'i flasë dy-tri fjalë për qeverisjen lokale, pastaj edhe për Qeverinë qendrore thotë: Kapaciteti i qeverisë lokale mbetet i dobët. E dimë. Ligji mbi qytetin e Prishtinës ende nuk është aprovuar, ende mungon mekanizmi efektiv për të monitoruar dhe vlerësuar kualitetin e shërbimeve nga komunat, dhe mos të harrojmë të nderuar kolegë dhe ju Qeveri e nderuar se progresi nuk duhet të diskutohet, sepse atë e keni marrë ose kemi marr obligim nga vota e qytetarit që duhet të ketë progres, por natyrisht që duhet të diskutohen ngecjet të cilat vërtetë janë shumë të mëdha, janë të pa tolerueshme. Situata e sigurisë në veri mbetet shqetësuese, mbetet natyrisht, e dimë që të gjithë dhe asnjë hap nuk ka lëvizje në atë drejtim. Ka pasur ndërhyrje politike në emërimin e dy zyrtarëve të lartë në pozitat kyçe të Shërbimit civil. Po të nderuar kolegë dhe ju qeveritarë, ka ndërhyrje të papranueshme. Të gjitha bordet e pavarura që kërkohen këtu edhe nga vetë qeveritarët me plotë gojë që duhet të jenë të pavarura, ato janë të varura, ato janë të zgjedhura, jo vetëm nga anëtarët e partive politike që janë në pushtet, militantë të tyre, por jo profesionalist dhe të kontrolluar totalisht, prandaj nuk funksionon asnjë agjenci, asnjë bord dhe as nuk ka përgjegjësi, as nuk i jep llogari Kuvendit, sepse ato i kanë zgjedhur Qeveria për vete.

Ndërhyrjet politike në emërtime të larta, mbetet çështje shqetësuese dhe thotë: “Kapacitetet e Administratës Publike të Kosovës, mbesin të dobëta, nevojitet përpjekje substanciale për të siguruar transparencë për emërimet publike”. Kjo është, unë uroj që të jetë ndoshta thirrja e fundit që vërtet raporti tjetër mos të zë vend kjo performancë çfarë sot po e shohim.

Sistemi gjyqësor, çfarë të flasim. Raporti thotë kështu: “Akuzat për korrupsion dhe keqpërdorimet në gjykata nuk janë hetuar si duhet, zyra për masa disiplinore përgjegjëse për këto aktivitete, nuk është plotësuar, nuk është plotësisht funksionale. Komiteti për

provimin e jurisprudencës nuk është funksional, gjë që ka ngushtuar pjesëmarrjen në proces.” Tjetër thotë: Dhoma Speciale e Gjykatës Supreme përgjegjëse për rastet që lidhen me privatizimin, është paralizuar për shkak të mungesës së gjyqtarëve lokal, sa e pa pranueshme. Kjo është një çështje me shqetësim të veçantë. Bashkëpunimi në mes të Zyrës së Prokurorit dhe Policisë, është i kufizuar. Këtë, ne çdo qytetar sot ballafaqohet me këtë realitet çfarë thotë ky raport. Trajtimi i rasteve penale në këtë kontest vazhdon të jetë i komplikuar me një numër çështjesh sikur që është zhdukja e dëshmive dhe e deklaratave të dëshmitarëve, zhvendosja e njerëzve, refuzimi i disa policëve të Policisë së Kosovës të bashkëpunojnë sikurse edhe kërcënimi i dëshmitarëve, gjykatësve dhe prokurorëve. Gjykata në Mitrovicën Veriore përbëhet nga një gjykatë dhe prokurorë të EULEKS-it dhe punon me kapacitetet e kufizuara, sundimi i ligjit në Kosovën Veriore nuk është i garantuar. Domethënë ne këtu i kemi dy probleme, pjesën Veriore të Kosovës, por realisht edhe për Kosovën që vërtet sundimi i ligjit nuk funksionon dhe kjo është më se shqetësuese. Sistemi i drejtësisë mbetet i dobët, i cenueshëm nga intervenimi politik dhe joefikas. Ka një numër të madh të rasteve të pazgjedhura, problemet strukturore të shërbimeve të prokurorive të Kosovës, duhet të adresohen, KGJK nuk funksionon me efikasitet. Gjyqësori i Kosovës ende ka nevojë për reforma të mëdha dhe Qeveria duhet të sigurojë pjesëmarrjen e komunitetit serb në Kosovë në këtë proces.

Politikat kundër korrupsionit. Fillon me këtë pasus. Kosova ka shënuar progres të kufizuar në luftimin e korrupsionit.

Të nderuar kolegë,

Ne jemi dëshmitarë, që përveç anës deklarative të kësaj Qeverive për t’i shpallur luftën zero tolerancë ndaj korrupsionit, asnjë hap tjetër nuk është ndërmarrë. Raporti e thekson fare mirë dhe është shqetësuese, ju lutem kolegë të nderuar, korrupsion nuk bëjnë qytetarët e varfër që i kemi mbi 50 – 60% të pa punë. Korrupsion bën Qeveria, korrupsion ka në institucione siç janë gjykata, policia, Qeveria dhe biznesmenët. Këtu është korrupsioni, këtu bëhet korrupsioni dhe këtu bëhen shkeljet e ligjit çdo ditë, andaj ne nuk duhet të dalim me deklarata të themi se zero luftë kundër korrupsionit, por duhet t’i përvishemi seriozisht dhe ta luftojmë korrupsionin me strategji konkrete.

Tjetër, për kriteret ekonomike do të flas shumë pak, sepse folën kolegët, vetëm po e them një fjali. Thotë- stabiliteti makro-ekonomik. Me këtë mendoj se them shumë. Investimet e sektorit privat kanë pësuar rënie për 10.2%, është fjala për gjysmën e vitit 2008/2009. Ta keni parasysh, e mos të flasim për raporte tjera.

Dhe, ju lutem shumë, e potencuat që ne po pretendojmë ta përdorim këtë raport për fushatë. Raporti thotë, buxheti 2009 ka qenë i ndikuar nga agjenda elektorale. Buxheti i propozuar nga Qeveria dhe i aprovuar nga ky Kuvend thotë ka qenë i ndikuar nga agjenda elektorale. As buxheti dhe as korniza afatmesme e shpenzimeve nuk janë zhvilluar në instrumente efektive të politikave. Në vend të kësaj të fundit ato vazhduan të përgjigjen me kërkesa ad-hoc të presioneve të shpenzimeve. Kjo është e patoleruar. Për këtë ne jemi të gjithë dëshmitarë se buxheti shpenzohet....

KRYETARI: Edhe një minutë.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Vetëm edhe dy-tri fjalë për punësimin dhe politikat sociale. Më duket kolegja Jashari e theksoi fare mirë atë çfarë thotë raporti. Dhe, unë për ta përmbyllur këtë nga praktika dhe

përvoja e jetës që kemi ne sot me qytetarët tonë shumë të varfër, me probleme shumë të mëdha sociale, mua në adresën, në postën time më ka ardhur një letër nga zotëri Ruzhdi Hajdini, ish i burgosur politik 15 vjet në burg dhe kërkon ndihmë nga unë. Realisht unë nuk jam Qeveri, nuk mund t'i realizoj kërkesat e tij shumë të drejta për të pasur ushqim fëmijët e vet dhe unë kam fotokopjuar këtë letër në dy kopje dhe dy qeverive edhe LDK-së edhe PDK-së dhe ua dorëzoj sot dhe të merreni me këtë rast konkret se vërtet është në hall.

Drejtimin e seancës e merr Xhavit Haliti, anëtar i Kryesisë

DREJTUESI: Fjalën e ka deputeti dhe Kryetari i Parlamentit, Jakup Krasniqi.

JAKUP KRASNIQI: Të nderuar deputetë dhe deputete,
Para se të hyj në temë, vërtet kisha dëshiruar që t'i lus të gjithë deputetët që janë anëtarë të partive politike t'i përgjigjen, jo mua, por vetvetes- a i kanë plotësuar në partitë e tyre politike kriteret për të qenë të kënaqur me standardet që i kërkon Raporti i Komisionit të Evropës?

Dhe, si çështje e dytë, mendoj që secili nga deputetët duhet ta pyesim veten me punët dhe angazhimet tona, në kontributin tonë- a i plotësojnë kriteret, siç po kërkojmë t'i plotësojë Qeveria në këtë mandat?

Gjithashtu mendoj që edhe këtë s'po kërkoj të më përgjigjeni mua, se unë e di, po është mirë t'i përgjigjeni secili vetvetes.

Ne sot po debatojmë Raportin e progresit të Komisionit Evropian për Kosovën. Realisht, është dashur të diskutojmë edhe studimin e fizibilitetit që gati pak kush e përmendi dhe natyrisht dokumentin e Komisionit tonë parlamentar të cilin s'e përmendi askush.

Unë dua të them, t'ia filloj me Parlamentin. Unë jam më se i kënaqur me atë që thuhet për Kuvendin e Republikës së Kosovës në Raportin e Progresit. Mendoj që është një vlerësim real, po ne i dimë edhe disa mangësi tona që nuk janë thënë në Raportin e progresit dhe kontrollin e Qeverisë dhe të institucioneve të pavarura nuk e bën vetëm Kryetari i Kuvendit dhe Kryesia, po e bëjnë pozita dhe opozita dhe në këtë rrafsh çka do që të themi duhet ta themi edhe për veten tonë, që nganjëherë nuk e themi.

Unë jam i bindur se Raporti ka dhënë një pasqyrë reale për gjendjen e përgjithshme në Kosovë. Dhe, kur them këtë kam parasysh se këto kapacitete të institucionit të Kosovës nuk janë ndërtuar vetëm gjatë dy vjetëve dhe për dy vjet s'kanë mund të arrihen kapacitete që ne do të dëshironim ose kapacitete që do t'i dëshironte Komisioni Evropian.

Prandaj mendoj që nëse dikush ka të drejtë pak a shumë të na kritikojë në këtë Kuvend, ta kritikojë Qeverinë ndoshta e drejta është vetëm e Grupit Parlamentar të AKR-së se të gjitha grupet tjera parlamentare gjatë gjithë këtyre viteve kanë dhënë kontributin e tyre, të mirë apo të keq, në qeverisjen e këtij vendi dhe s'mund të amnistohen nga ndërtimet e dobëta të administratës së Kosovës. Dhe, unë e kam cekur disa herë në këtë Kuvend se gjatë gjithë këtyre viteve nuk kemi arritur të ndërtojmë kapacitete administrative, po them sot, nuk jemi të kënaqur as me nivelin e kapaciteteve qeverisëse që janë krijuar gjatë gjithë këtyre viteve në Kosovë.

Vërejtjet që i thatë, unë nuk dua të merrem me to, por dua t'i them se janë disa çështje që nuk pajtohem e që thuhën në Raportin e progresit për Kosovën. Kur është fjala, sundimi i ligjit, gjatë gjithë këtyre viteve për sundimin e ligjit përgjegjësia më tepër ka qenë e ndërkombëtarëve sa e vendorëve. Unë mendoj që në shumë raste janë penguar institucionet vendore për t'i kryer detyrat e tyre të cilat i obligojnë ligjet, sidomos sistemin e drejtësisë. Mos kontrollimi i kufijve shtetërorë realisht nuk është krejt përgjegjësi e Kosovës, ne e dimë se kjo përgjegjësi është edhe e atyre që na i dhënë vërejtjet.

Sistemi i drejtësisë, vërtet është një sistem që është përcjell me të gjitha dobësitë gjatë gjithë këtyre viteve dhe do të përcillet edhe për një kohë me dobësi për arsye të shumta. Unë arsyet nuk do t'i cek se mendoj që secili nga ne i di.

Raporti me fqinjët. Realisht nuk është... Institucionet e Kosovës, politika në Kosovë është pak përgjegjëse për raportin me fqinjët dhe jemi munduar ta tejkalojmë vetveten dhe jemi përpjekur që të ndërtojmë raporte fqinjësore me gjithë fqinjët, por nuk ka qenë gatishmëria e të tjerëve. Ne kemi pasur gatishmëri, kemi pasur vullnet dhe mendoj se kjo si vërejtje nuk mund t'u shkojë institucioneve të Kosovës, se janë disa fusha që vërtet institucionet e Kosovës as në të kaluarën e as sot nuk kanë pasur kompetenca të plota, ndonëse nga shpallja e pavarësisë dhe këndej kemi një shtim të përgjegjësive dhe të kompetencave, por natyrisht për dy vjet sigurisht se s'ka qenë lehtë të arrihen të gjitha këto kapacitete.

Sa i përket Ligjit të prokurimit publik dhe të korrupsionit që lidhet shumë me Ligjin e prokurimit publik, ne si institucione, vërtet, edhe Qeveria edhe Parlamenti, duhet t'i marrin të gjitha masat për ta ndryshuar ligjin dhe për të krijuar hapësira dhe mundësi të reja që korrupsionin si dukuri, si fenomen i shoqërisë së lirë të tregut, realisht ta zvogëlojmë. Është shumë vështirë ta eliminojmë se në fund të fundit si dukuri ekziston edhe në shtetet që kanë traditë të madhe të sundimit të ligjit dhe të demokracisë. Megjithatë, mendoj se institucionet e Kosovës duhet të përgatiten për t'i ndryshuar disa praktika negative që janë shfaqur në praktikën e deritashme të qeverisjes.

Dhe, për mos t'ju marrë kohë më shumë unë po e mbylli fjalën time me një kërkesë që vërtet në dokumentet e tilla, përveç dobësive, përveç detyrave dhe përgjegjësive që duhet të nxjerrim, të shohim edhe sukseset tona, se në fund të fundit sukseset që janë arritur në Kosovë vërtet janë të mëdha dhe janë suksese që vërtet po i gëzohen edhe shumë vende dhe miq që kanë ndihmuar Kosovën gjatë këtyre proceseve dhe nuk është mirë që ne me gojën tonë t'i mohojmë të arriturat që i kemi pasur gjatë gjithë këtyre dhjetë vjetëve, por në mënyrë të veçantë edhe gjatë këtyre dy vjetëve nga shpallja e pavarësisë dhe këndej, në fund të fundit, vetë shpallja e pavarësisë, vetë konsolidimi i institucioneve të pavarura të shtetit dhe përmbyllja e këtyre institucioneve është një sukses që duhet t'i gëzohemi. Natyrisht, Kosova ka probleme, qytetarët e saj kanë probleme dhe sigurisht asnjëri nga ne nuk mund të jetë i kënaqur me këto probleme që i ka, por ne do të jemi ata që i ndryshojmë këto rrjedha. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Memli Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeverisës,

Të nderuar deputetë,

Duket se ka humbur tashmë interesimi në një farë forme edhe është shterur tema për të cilën kemi debatuar që dy seanca të ndryshme, por do të mundohem që shkurtimisht t'i them edhe unë disa fjalë për dokumentet për të cilat po diskutojmë sot.

Raporti i progresit është një dokument i Komisionit Evropian që, siç e dimë, e vlerëson progresin, të arriturat, por gjithsesi i liston edhe sfidat për shtetet të cilat janë candidate ose janë candidate potenciale për aderim në të ardhmen në Bashkimin Evropian.

Ajo që për ne si Kosovë e veçon këtë vit, këtë raportim është edhe një dokument i bashkëngjitur, bashkë me Raportin e progresit që është studimi i fizibilitetit. Besoj se e dimë që studimi i fizibilitetit zakonisht bëhet vetëm për shtete të pavarura dhe në radhë të parë kjo duhet të shihet si një e arritur, si diçka shumë pozitive, përkundër mosnjohjes së pavarësisë së Kosovës ende nga pesë vende të Bashkimit Evropian.

Siç e thotë vetë emërtimi i tij, Raporti i progresit është raport i progresit dhe nëse e kemi lexuar të gjithë këtu bashkë raportin e njëjtë, atëherë ma merr mendja se është shumë e qartë që kemi të bëjmë me progres, pa marrë parasysh nëse e matim këtë progres me standardë të ndryshëm. Ky është raport që flet për progresin, por që flet për të arriturat, por që padyshim i liston edhe një sërë sfidash me të cilat ne të gjithë ballafaqohemi si Kosovë dhe që është normale, sepse Kosova është një shtet i ri, i cili ende është në fazën e shtet ndërtimit dhe padyshim është krejt e kuptueshme dhe normale që një klub ekskluziv, siç është Bashkimi Evropian, në vlerësimet dhe në kërkesat e tij të ketë pritje edhe më të mëdha prej Kosovës.

Një gjë tjetër ndoshta që duhet theksuar edhe një herë është se ky raport nuk është raport për Qeverinë e Kosovës ose për qeverisjen e Kosovës, por është një raport i cili përfshinë punën e të gjitha institucioneve dhe të gjitha pushteteve, të them ashtu, në vendin tonë.

U përmendën shumica e sfidave, u përmendën shumica e fushave problematike, fushave ku duhet të ketë vazhdim të përkushtimeve për të arritur një standard dhe një nivel edhe më të lartë, por që ta zëmë shembull një fushë, në të cilën ka sfida edhe vitin e kaluar edhe këtë vit, është fusha e gjyqësorit dhe pa dyshim që është jo parimore që ta zëmë në kritikën e kujt do qoftë të adresohen përgjegjësi ose të kërkohen përgjegjësi nga ana e Qeverisë për problemet që ekzistojnë në fushën e sistemit të drejtësisë dhe gjyqësorit, meqenëse në Kosovën demokratike e dimë që pushtetet janë të ndara dhe duhet të funksionojnë si të tilla.

Ajo që është e evidente nga Raporti i progresit, pa dyshim është se sfidat e përmendura, si prioritet për të ardhmen, në këtë raport, janë edhe prioritet të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të cilat janë shprehur në vazhdimësi dhe për të cilat përkushtimet janë evidente edhe rezultatet edhe të arriturat. Unë mendoj se më e rëndësishme për Kosovën në kontekstin, veçanërisht në kontekstin politik, më i rëndësishëm se Raporti i progresit këtë vit është studimi i fizibilitetit, i cili padyshim se hap një kapitull të ri për Republikën e Kosovës në marrëdhëniet e saj me Bashkimin Evropian.

Veçanërisht konfirmimi i kapacitetit kontraktual në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian është një fakt të cilin duhet ta vlerësojmë të gjithë bashkërisht, sepse është një e arritur e vendit tonë, pa dallime partiake, politike apo tjera. Konkluzionet e këtij studimi, pa dyshim se janë tepër të rëndësishme, sepse shënojnë tri momente të reja për Kosovën. E para është fillimi i një procesi për liberalizimin e vizave, e dyta shqyrtimi i mundësisë për marrëveshje tregtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe

Bashkimit Evropian dhe e treta perspektiva konkrete për procesin e asocim-stabilizimit. Këto tri çështje që janë shumë pozitive për Kosovën dhe për qytetarët e saj, besoj se peshojnë më shumë nëse duhet veç të bëjmë një krahasim se sa një numër sfidash që janë të listuar në Raportin e progresit dhe që padyshim duhet t'i adresojmë secili nga përgjegjësitë dhe pozicionet që mbajmë. Normalisht për sa i përket listës së Schengenit të bardhë apo procesit të liberalizimit të vizave ne të gjithë jemi të shqetësuar ose të pa kënaqur që Kosova dhe dy shtete tjera në rajon kanë mbetur mbrapa në këtë proces, por nëse duhet ta bëjmë një analizë komparative apo një krahasim në procesin e Kosovës, procesin integruar në drejtim të Bashkimit Evropian, ne kemi bërë arritje dhe progres shumë më të shpejtë se sa shumica apo të gjitha vendet e rajonit, sepse ato procese integruuese të tyre i kanë filluar para së paku 10 – 15 apo 20 vitesh, ndërsa Kosova është shtet i pavarur që më pak se dy vjet. Do të thotë, atyre iu kanë dashur 15 vjet për të mbërri deri diku ku ne pretendojmë që të jemi, shpresojmë pas një viti.

Andaj, për ta përfunduar, në vend se ta shikojmë këtë situatë apo këtë raport si dhe raportet tjera vetëm bardh ose vetëm zi, unë besoj se ne duhet t'i analizojmë dhe t'i vlerësojmë realisht, ashtu siç është vlerësuar si real ky raport. Dhe, nëse duhet t'i ndihmojmë institucionet në tejkalimin e këtyre sfidave është me rëndësi për ta dhënë atë kontribut, jo, do të thotë, vetëm në kuptimin kritikues, por edhe në kuptimin ndihmues, korrektues, sepse nëse duhet, nëse procesi evropian është interes i të gjithë qytetarëve jo vetëm i partive në pushtet ose i partive në opozitë, atëherë besoj se koordinimi dhe bashkëpunimi duhet të jetë i gjitha institucioneve dhe i të gjithë pjesëmarrësve në procesin politik. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka, dy minutë, Hajredin Kuçi.

HAJREDIN KUÇI: Faleminderit! Jo replikë! Faleminderit, zonja Gaxherri për letrën. Unë e lexova me vëmendje letrën që ma dhatë ju. Duhet të them se Zyra ime menjëherë ka vënë kontakt me personin që e përmendët ju, s'dua t'ia përmend emrin. Nesër në orën 9 do ta takoj. Ju ftoj edhe juve që të vini në atë takim, por unë jam ithtar i asaj që të zgjidhet çështja e ish- të burgosurve politikë me ligj, por gjithsesi edhe në rastin konkret do të bëjmë zgjidhje institucionale. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Driton Tali, le të përgatitet deputetja Edita Tahiri.

DRITON TALI: Faleminderit!

Të nderuar të pranishëm këtu në Kuvend që keni mbetur dhe ju të nderuar qytetarë që na përcillni në televizion.

Ndonëse u thanë shumë gjëra, por unë do të ndalem këtu në pjesën ku ky raport flet për korrupsionin, me theks të posaçëm korrupsioni, që ka të bëjë me institucionet publike, sepse edhe më tutje në Kosovë, siç dihet, Qeveria, ashtu siç u tha, është punëdhënësi kryesor, është po ashtu edhe investuesi kryesor apo edhe punë krijuesi më i madh. Prandaj, ky raport 52 faqesh, të nderuar, është vazhdimësi e raporteve të mëparshme të Komisionit të Unionit Evropian, ndonëse dorën në zemër, sivjet është edhe më i keq, siç mund të shihet, aty, sa për hir të argumenteve, ceket se vlera e dhënieve të tenderëve njëburimor është rritur nga 50 milionë në 164 milionë euro, domethënë, është trefish, që thënë të drejtën apo të flasim kah na del shpirti, është tepër edhe për standardet kosovare. Por, sa për t'ua freskuar memorien atyre që e kanë harruar Raportin e progresit të vjetëm, domethënë, që mbulonte periudhën tetor 2007 – tetor 2008 edhe ai raport në veti pati një

mal kritika për Qeverinë lidhur me korrupsionin. U kritikua Qeveria për ndërhyrje politike në caktimin e posteve kyçe në shërbimin civil. Po ashtu u kritikua ashpër edhe gjyqësia dhe sistemi i drejtësisë. U tha se liria e shprehjes ishte e pa garantuar, se kishte ndërhyrje politike në media. Me fjalë të tjera, ishin kritika identike që hasen edhe në këtë Raportin e progresit që po e diskutojmë sot, por me një masë më të përkeqësuar.

Edhe atëherë pati afëra korrupsioni. Sa për hir argumentit të përmendet rasti kur punëtorët e Postë-Telekomit të Kosovës nënshkruan peticionin kundër nënshkrimit të marrëveshjes së PTK-së me operatorin virtual të telefonisë mobile Dardafon. Por ajo iniciativë u hesht shumë shpejt nga presionet politike, u mor vesh. Pra, rast konkret që ilustron korrupsionin dhe presionin në të njëjtën kohë, domethënë, që atë që ky raport i fundit e cek, po citoj : “Korrupsioni bëhet dominues në shumë fusha në Kosovë dhe vazhdon të jetë çështje për shqetësim serioz” dhe se citoj përsëri: ” ka ndërhyrje politike, domethënë, presion politik në të gjitha fushat e në veçanti në media” Gjithashtu edhe vjet sikurse sivjet norma e çmimit të mitos që bizneset jepnin për të fituar një tender në njërën nga ministritë e Qeverisë kapte vlerën deri 15%, madje edhe mbi 15%, varësisht nga shuma sipas hulumtimeve dhe raporteve të shumta që bëjnë organizatat dhe institucionet e ndryshme. Prandaj, shtrohet pyetja pse ky raport i sivjetmë të jetë më i veçantë. Sigurisht se jo për shkak se PTK-ja sivjet, në mes të tjerash, vendosi që një garë private të kuajve ta sponsorojë me 45.000 euro para publike, kjo mbase mund të tregojë se udhëheqësit e PTK-së sivjet janë më të kultivuar se vjet, a, e kanë sotifikuar stilin, kush e di, tentojnë të bëjnë ndonjë Rojal- askot, alla-PTK-qe. Po ashtu ky raport nuk është më i veçantë për faktin se sivjet kjo Qeveri emëroi Lulzim Kurtajn përsëri në Bordin e ATR-së, pra personin përgjegjës për 16 milionë e 200 mijë euro të humbura të garancionit bankar nga Kosmocel, pa dhënë shpjegime se çka ndodhën me ato 16 milionë e 200 mijë euro, sepse në Kosovë janë humbur, për të mos thënë janë vjedhur edhe më shumë se 16 milionë e 200 mijë euro e nami nuk është bërë. Ose se edhe sivjet kosovarët, si qytetarët më të varfër të Evropës i paguajnë, po them ndryshe, ia falin Feronikelit më shumë se 30 milionë euro, Alferonit, pra, pronarët e së cilës kompani Patokçodievev, Aleksandër Mashkeviq dhe Alijan Ibragimov, janë ndër miliarderët më të mëdhenj të Evropës. Apo se edhe sivjet KEK-u blen rrymë elektrike me çmim edhe më shumë se dyfish se sa korporatat fqinje, si për shembull 2.34 fish më shtrenjtë se Korporata Energjetike Shqiptare, pra KESH-i, nga i njëjti furnizues apo pse KEK-u jep tender një burimor që sivjet kap vlerën 21 milionë euro, sepse ky marifet zgjat shumë vite në KEK. Ose së pati ndërhyrje politike në caktimin e posteve kyçe në shërbimet civile, sidomos në prokurimin publik dhe në bordet e ndërmarrjeve publike, ashtu siç tha edhe zoti Kryeministër, në fund të fundit ato ndërhyrje i ka aprovuar edhe vetë zoti Piter Feit, domethënë se ky raport i Komisionit të Unionit Evropian, aq sa e kritikon punën e Qeverisë e kritikon edhe punën e përfaqësuesit të vet, zotit Piter Feit. Apo se vazhdoi punësimi në bazë të partisë partiake, gjithmonë pra me bekimin e zotit Piter Feit, sepse të gjitha këto janë vazhdimësi apo siç thuhet në frëngjishte *espri de co*. Por, veçantia e këtij raporti është sipas mendimit tim, është EULEX-i, është së bashku me zotin Iv de Kermabo dhe pjesën evropiane të personalitetit apo përgjegjësisë së zotit Piter Feit, sepse jo vetëm që ky raport siç dihet është shkruar nga Komisioni i Unionit Evropian, siç u tha këtu – Komisioni i Unionit Evropian është organ ekzekutiv, por është edhe pjesë e Këshillit të Unionit Evropian, pra të vetë institucionit i cili e krijoi apo e lindi EULEX-in, pikërisht për ta luftuar korrupsionin në Kosovë, që domethënë, se është dokument zyrtar, i cili konfirmon faktin se në Kosovë ka korrupsion dhe kjo më nuk mund të injorohet. Zaten, këtë konkludim e dhanë, siç e ceka më lartë, edhe raporti i vjetër, sikurse edhe Konferenca Rajonale për luftimin e korrupsionit që u mbajt tash në Prishtinë, para disa ditësh. Pra,

për më tepër ky raport, për nivelin e lartë të korrupsionit në Kosovë e bën përgjegjëse edhe EULEX-in edhe përfaqësuesin e saj special të Unionit Evropian në Kosovë.

Po ashtu duhet theksuar patjetër se EULEX-i nuk mund të arsyetohet më me argumente se i duhet kohë më tepër, sepse ka më se një vit që është në Kosovë, andaj zoti Iv de Kermabo, ose duhet diçka së shpejti të bëjë konkretisht kundër korrupsionit ose ai duhet përjashtuar nga ajo detyrë si i paaftë për të kryer detyrën për çka paguhet. Kjo njëjtë vlen edhe për zotin Piter Feit. Deri tani nuk kanë treguar asgjë. Ngjashëm kjo vlen edhe për kryeprokurorin Theo Jakobs, ndonëse ky i fundit më 3 nëntor e dha një deklaratë shpresëdhënëse të cilën po e citoj, tha se janë kah hetohen "peshqit e mëdhenj" dhe se së shpejti do të ketë rezultate konkrete. Ai me të vërtetë duhet ta mbajë këtë premtim, se përndryshe i tërë misioni e humb kuptimin dhe dështon. Ngjashëm, gjithashtu, më falni, EULEX-i nuk mund të arsyetohet se nuk ka material, sepse vetëm Agjencia Antikorrupsion në periudhën 2007 dhe 2008 i ka dorëzuar rreth 100 dosje Prokurorisë. Pastaj, le ta marrim edhe raportin e fundit të Auditorit të Përgjithshëm, zotit Lars Olofson dhe aty do të gjejmë sa të dom fakte konkrete për keqpërdorimin e posteve dhe parasë publike.

Unë, siç e dini, të nderuar, ka disa muaj që kërkoj nga EULEX-i që ta kryejë punën për çka është krijuar dhe për çka paguhet dhe për çka ka ardhur në Kosovë, sepse në gjyqësorin e Kosovës, ashtu sikurse edhe shumë qytetarë të Kosovës mjerisht e kam humbur shpresën se mund të bëjnë diçka. Këtu u përmend edhe shifra se janë 300 mijë raste të paprekura që presin në gjyqësor.

I thashë të gjitha këto duke pasur parasysh se shumë gjëra tjera u thanë dhe gjithmonë duke pasur parasysh edhe deklaratën shpresëdhënëse të kryeprokurorit Jakobs, por disi zëdhënësja e EULEX-it të nesërmen e zbehu atë deklaratë si dhe këto gjërat e fundit që po ndodhin në Kosovë. Shpresoj se është koha e fundit që EULEX-i të zgjohet nga gjumi dhe t'i arsyetojnë pagat që i marrin. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Edita Tahiri, le të përgatitet deputeti Bahri Hyseni.

EDITA TAHIRI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Deputetë të nderuar,

Qeveri e nderuar,

Do të filloj diskutimin tim duke thënë se janë dy momente të rëndësishme që e bëjnë diskutimin e sotëm me peshë për faktin se ne po e diskutojmë këtë raport në kohën kur Traktati i Lisbonës tashmë është në fuqi, i cili praktikisht, Kosovës dhe Ballkanit Perëndimor ia qartëson edhe më shumë perspektivën e integrimeve evropiane, si dhe momenti i dytë është Plani amerikano-grek i cili sugjeron që deri në vitin 2014 i gjithë Ballkani Perëndimor duhet të bëhet pjesë e Bashkimit Evropian.

Po ashtu është me rëndësi të thuhet se Kosova dhe institucionet e saj kanë bërë një hap përpara me faktin se u është ofruar studimi i fizibilitetit, sepse me këtë rast Kosova po qe se lëviz më shpejt përpara, natyrisht që do të mund të hapë perspektivën për Marrëveshjen e stabilizim-asocimit. Mirëpo, unë mendoj se për t'i arritur këto qëllime të mëdha është me rëndësi që tek ne, së pari në elitën politike, por edhe në të gjithë shtresat tjera të shoqërisë të forcohet filozofia politike e integritetit evropian, që në radhë të parë nënkupton një qeverisje efikase dhe efektive, pa ndërhyrje nga politika, por edhe nënkupton atë për çka ne jemi marrë vesh, pra si spektër politik që për integrime

evropiane do të kemi një konsensus politik, prandaj edhe diskutimet për raportet e progresit duhet të reflektojnë një angazhim gjithëpërfshirës të gjithëve që t'i çojmë punët përpara.

Unë do të veçoja nga ky raport rëndësinë se përmenden strukturat paralele dhe ekzistenca e tyre. Ne të gjithë e dimë se kemi nevojë që të forcojmë sovranitetin dhe ta shtrijmë në veri që mendoj se është mirë që Bashkimi Evropian me këtë rast po ashtu jep sinjale se do të na ndihmojë në realizimin, pra vënien e kontrollit në veri të Kosovës. Po ashtu është me rëndësi të theksohet se ky raport përmend qartë arritjet që janë bërë në këtë periudhë, por sigurisht se e jep edhe një listë të gjatë të sfidave që i kemi përpara dhe unë do të ndalem në disa nga këto.

Së pari, te sundimi i ligjit, nuk dua të konstatoj se të gjithë e dimë që kemi një gjyqësi të brishtë, mirëpo është puna se si do ta kishim fuqizua tutje dhe unë kisha dashur që të shoh një bashkëpunim më të madh midis Parlamentit dhe gjyqësisë dhe policisë. Në këtë kuadër mendoj se Parlamenti i Kosovës duhet të rrisë mbikëqyrjen. Nga këto dy vjet sa jam deputete, nuk e kam parë që gjykata apo gjyqësori ka ardhur këtu të raportojë për punët e bëra dhe për sfidat që i ka, por as shefin e Policisë nuk e kemi parë këtu, prandaj mendoj se është një rast i mirë që të hapim debate dhe të shohim së bashku si mund të ecim përpara.

Për sa i takon korrupsionit, këtu u tha shumë, unë do të propozoj edhe dy çështje tjera. E para, ende nuk e kemi Ligjin për sekuestrimin e pasurive. Janë pasuruar shumë njerëz për këto 10 vjet dhe dihet se pasurimi brenda natës e ka emrin korrupsion, prandaj unë mendoj se është me rëndësi të kemi edhe një ligj të tillë, sepse korrupsioni nuk është një sport, e luan lojën i fiton parat dhe më nuk jep përgjegjësi. Është e kundërta, i fiton parat, e shkel ligjin dhe duhesh ta kthesh pasurinë që ia ke marrë qytetarëve.

Dhe, e dyta, është çështja e prokurimit ku unë përkrah idetë që u dhanë këtu dhe që po zhvillohen rreth forcimit të prokurimit transparent, por unë dua të propozoj që të bëjmë një lloj skanimi, të shohim një relacion që është një prej burimeve të korrupsionit dhe ai relacion është udhëheqësi politik i institucionit dhe shefi i prokurimit – çfarë marrëdhëniesh kanë. Në bazë të analizës së shteteve të dështuara, një prej burimeve del nga ky kurriz, pra, kush është shefi politik dhe kush është shefi i prokurimit? Në të kaluarën na ka pas ndodhur që ministri i Financave e ka pasur vëlla shefin e prokurimit në Presidencë, nuk e di tash qysh është puna, do të shohim.

Po ashtu, më lejoni të them se reformat në administratën publike duhet të forcohen. Më vjen mirë që po ec procesi, por duhet të forcohet më shumë, sepse ne kemi ende ndërhyrje të politikës në administratë, madje kemi ndërhyrje politike dhe sot, këto ditë, do tua përmend një ndërhyrje politike. Unë kam takuar një delegacion të Këshillit për Trashëgiminë i cili është formuar këtë vit me insistimet e Parlamentit, por edhe të Raportit të progresit, mirëpo ky këshill ende s'e ka filluar punën dhe menjëherë ka hasur në ndërhyrje politike nga Ministria e Kulturës, e cila, pra, ka bërë ndërhyrje në këtë çështjen e konkursit dhe pengesat tjera. Unë kërkoj që ky këshill të fillojë punën, ende nuk i kanë marrë paratë, e nde nuk e kanë ndërtesën dhe dua që politika të rri anash, sepse Këshilli për Trashëgimi është një autoritet rregullator i pavarur dhe nuk do të duhej të lejoheshin ndërhyrjet.

E mora për shembull këtë, por ka kesi ndërhyrje edhe më shumë dhe më lejoni në fund të ju them se ne do të bëhemi pjesë e Evropës në qoftë se Evropën e bëjmë në Kosovë, nëse

vlerat e Evropës i forcojmë, i promovojmë dhe praktikisht ne bëjmë Evropën në mendje dhe në punën tonë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Mendoj se duhet deputetët ta kenë të qartë, edhe deputetët, pas krijimit të Ministrisë së Rendit dhe Ministrisë së Forcës së Sigurisë as komandanti i Forcës së Sigurisë dhe as drejtori i Policisë nuk vjen të raportojë më në Kuvend. Do të thotë raportimet i bëjnë ministrat, ata që i kemi zgjedhur.

(Ndërhyrje e deputetes)

Kjo është, nuk ka nevojë për t' u përgjigjur. Unë po dua t' ju njoftoj që ata s' mund të vijnë të raportojnë në Kuvend. Ata janë trupa profesionale dhe nuk mund të vijnë në Kuvend dhe unë sa të jam, nuk kam për t' i ftuar kurrë. Vazhdojmë. Fjalën e ka Bahri Hyseni, le të përgatitet Nait Hasani.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Mendoj që jemi në përfundim të debatit dhe shumëçka është thënë prej deputetëve, por personalisht, si deputet i Parlamentit të Kosovës për mua Raporti i progresit për Kosovën nuk ka qenë shqetësues, ka qenë diçka e pritur nga vetë fakti duke marrë parasysh që Kosova ende nuk i ka dy vjet të plota të pavarësisë dhe nuk e di se kush ka menduar që brenda dy vjetëve Kosova të mos ketë asnjë sfidë dhe t' i ketë realizuar të gjitha detyrat që dalin nga plani i progresit.

Për mua shqetësuese ka qenë që shumica jonë, një pjesë dërmuese e deputetëve po mundohen që dokumentit që e kemi para vetes t' i japim karakter akuzues, t' i japim një karakter me të cilin dëshirojmë që institucionet në Kosovë t' i njollosim, dëshirojmë që t' i zmadhojmë gjërat në atë masë sa që nuk i shkon për shtati askujt e më së paku ne si deputetë të Parlamentit të Kosovës të cilët kemi mandat që të punojmë për të forcuar, për t' i demokratizuar, për t' i zgjedhur sfidat që i kemi para vetes e aq më pak kemi mandat për të njollosur, për të sharë apo për të tentuar që këto institucione t' i qesim së të palara, si të padijshme e kështu me radhë.

Unë do të prek vetëm sistemin gjyqësor dhe mandej do të kaloj në planin e veprimit. Natyrisht që s' kemi pritur as për sistemin gjyqësor që plani i progresit do të flet diçka të mirë, sepse e dimë situatën aktuale. Po nuk kemi pritur dhe nuk do të presim as në vitin 2010 që do t' i zgjidhim problemet në gjyqësor. Edhe sot kur ne po bisedojmë për sistemin në drejtësi, ne e kuptojmë drejt që ky sistem nuk menaxhohet nga vendorët. Dhe, do ta kisha ndërlidhur me situatën. Sot po ndodh emërimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve në institucionet më të larta, në Gjykatën Supreme të Kosovës. Dhe, po pyes, a është në dijeni dikush nga Kuvendi i Kosovës apo nga Qeveria kush i ka shpallur konkurset për gjyqtarë dhe prokurorë. Absolut jo. Nëse dëshirojmë ta dimë i ka shpall një organ, Këshilli i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial në Kosovë që nuk ka në përbërje asnjë vendor. Dhe, për të konkurrua gjyqtari i Gjykatës Supreme të Kosovës është kërkuar së paku me i pas 10 vjet përvojë pune. A do të kemi reforma, absolutisht, jo? Prandaj e kemi këtë situatë si e kemi dhe do ta kemi këtë situatë. Ajo që ka qenë në kompetencë të vendorëve, po shihet se ka pasur lëvizje, sepse diku 13-14 ligje bazike për organet e drejtësisë i kemi bërë: Ligjin për noterinë, Ndërmjetësimin, Jurisprudencën, Ligjin për detyrimet, Ligjin për mjekësinë ligjore e të mos i përmend të gjithë. Prandaj, këtu është esenca e problemit.

Raportin duhet ta marrim si inkurajues, Raportin duhet ta marrim si obligim për ne për t' i kryer detyrat.

Këtu e keni parë, është politika kundër korrupsionit dhe nëse e lexoni me vëmendje, natyrisht që nuk kanë faj ata të raportit, por kemi pak faj ne, sepse plani i veprimit dhe strategjia Antikorrupsion është aprovuar, e këtu shkruan që nuk është aprovuar. Të gjitha ligjet që ndërlidhen me korrupsionin janë në përfundim, disa po presin vetëm dekretimin nga Presidenti, kurse të tjerët janë amendamentuar dhe të gjitha janë konform standardeve evropiane.

Unë nuk do të ndalem shumë rreth Raportit, sepse ai është diskutuar. Për mua sfida e mëvetësjeshme do të jetë plani i veprimit, planin e veprimit të cilin e kemi para vetes. Ne e respektojmë një punë që është bërë nga Komisioni për Integritet Evropian, por natyrisht kisha kërkuar, zoti Kryetar që të ftoni një takim dhe ju me qenë udhëheqës ku do të marrin pjesë të gjithë kryetarët e komisioneve parlamentare. Detyrat që i kemi në planin e veprimit janë pak sa të paqarta, degëzohen në shumë komisione dhe nuk dimë kush do ta përfundojë punën.

Unë po i përmendi vetëm disa që t' ju marrë kohë. Po e marr për shembull detyrën prej p.14. Ka pasur ndërhyrje politike në emërime të zyrtarëve në pozita kyçe në shërbimin civil, që u përmend. Dhe, shikoni tash, obligohet Komisioni për legjislacion, Komisioni për shërbime publike, Komisioni për integritet evropian dhe çka obligohemi, detyra e parë është: krijimi i kornizës ligjore me miratimin e ligjeve për shërbimin civil që e kemi edhe detyrën p.15 – kjo çështje nuk është, fundi i fundit, punë e komisioneve, a janë lexuar. Nën 2, thotë – organizimi i dëgjimit parlamentar me komitetin për emërime të larta publike dhe bordin e pavarur mbikëqyrës për shqyrtimin e procedurave për emërimin dhe shkarkimin e zyrtarëve të lartë publikë. Unë po pyes, ku është autoriteti i komisioneve parlamentare me ftua komisionin për emërime të larta publike të cilin e udhëheq Kryeministri dhe disa ministra. Është një çështje. Nuk është detyrë, nuk di qysh e realizojmë. Dhe, e treta, thotë: përgatitja e rekomandimeve për miratim nga ana e seancës plenare. Prandaj, këtu janë problemet.

Unë mendoj që duhet të fokusohemi në planin e veprimit, t'i marrim obligimet konkrete dhe të mos ndodhë vetëm përshkrim, apo shkon më poshtë, p.15-shi vazhdon prapë për ligjet e shërbimit civil dhe shikoni çfarë obligime dalin. Thotë, Kryesia, pas konsultimit me grupet parlamentare duhet të vendosë në rend dite në seancë plenare leximin e parë të propozim ligjit, çështje teknike, çështje që në desh shkruaje në plan të veprimit, kjo ka me ndodhë, ka ndodhë. Dhe dy, seanca plenare cakton komisionet funksionale dhe komisionet e përhershme. Nuk është detyrë...nuk është... Kjo është diçka rutinore që e bën patjetër, Kryetar, se s'ka rrugë tjetër dhe vetvetiu dihet se kush janë komisionet funksionale dhe komisionet e përhershme.

Komisioni për Integritet të shqyrtojë përputhshmërinë e leximit të parë dhe leximi i dytë i propozim-ligjeve të kryhet në afatin e paraparë ligjor që e ka paraparë Rregullorja e Punës. Ju kisha lutur, nuk dua t' ju marrë kohë tash si deputet, por të gjitha detyrat që janë dhënë në plan të veprimit janë përshkrim i njëjtë, në çdo përshkrim i detyrave është edhe Komisioni im, diku pa nevojë. Për shembull thotë, nevoja, mandej detyra p.16 – nevoja të ketë një dallim të qartë ndërmjet shërbimit civil dhe pjesës politike. Është shumë mirë në ligj, shërbimi civil, bile – bile ka qenë edhe në Rregulloren 2001/36, shumë mirë dallohet çka është shërbimi civil dhe çka është stafi politik. Është tjetër punë

çështja a ka ndërhyrje në shërbimin civil? S'po flas, por a dallohet shërbimi civil dhe pjesa politike, ka qenë e rregulluar mirë dhe është e rregulluar edhe me ligjin që e kemi lexuar në parim e shumë detyra tjera për të cilat nuk dua t'ju lodh. Në pjesën më të madhe të detyrave thotë, Kryesia e Kuvendit duhet t'i thërrasë grupet parlamentare për të vendosur për ta dërguar në lexim të parë ligjin, i cili vjen nga Qeveria. Po ajo është detyrë, na obligon Rregullorja, na obligon Rregullorja e Punës. Prandaj, zoti Kryetar, për të mos i lexuar edhe disa detyra të cilat Komisioni për Integritet Evropian duhet fuqimisht të kërkojë që të mos të përshkruhen në raportet e ardhshme të progresit. Për shembull, po e përmend vetëm përbërjen e përkohshme të Këshillit Gjyqësor. Nuk ka mundësi asnjë komision parlamentar ta ndryshojë përbërjen e përkohshme të Këshillit Gjyqësor, sepse është e paraparë në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. A është me standarde a s'është me standarde ka qenë dashur intervenua në Kushtetutë, po në Kushtetutë e kemi dhe nuk kemi çka të bëjmë. Ne nuk kemi mundësi ta ndryshojmë atë përbërje, sepse ligji vetëm e ka përshkruar atë që është në Kushtetutë, bile-bile, po them, ia ka humbur edhe kuptimin, prandaj ju

kisha lutur, zoti Kryetar, është interes, meqë edhe afatet, s'u lëshova te afatet, janë paraparë afatet 3 mujori i dytë, i tretë në 2010, edhe për ligjet të cilat i kemi lexuar. Është mirë ta kemi një takim urgjentisht, t'i ftojme të gjitha komisionet parlamentare, ta ftojme administratën e Kuvendit dhe të hartojmë një plan të veprimit konkret dhe me detyra konkrete, t'i ndajmë detyrat si komisione dhe nuk ka nevojë Avokatin e Popullit ta ftojë edhe Komisioni për Administratë Publike edhe Komisioni për Legjislacion për një çështje të njëjtë, për shqyrtim të ankesave, sepse nuk dihet cili komision, çka do të rekomandojë më tutje. Dhe, fundi i fundit, nuk ka edhe kuptim për t'u dhënë detyra për një çështje të njëjtë që ta ftojme 3-4 komisione Avokatin e Popullit. Prandaj, kërkoj që plani i veprimit gjithsesi duhet harmonizuar me detyrat konkrete, natyrisht nga Raporti i progresit dhe si komisione parlamentare

KRYETARI: Faleminderit! Unë jam i gatshëm që ta kemi atë takim, por natyrisht në fund ndoshta deputetja ose kryetarja e Komisionit për Integritet Evropian, ka ndonjë propozim më konkret. Fjalën e ka deputeti Nait Hasani, le të përgatitet deputeti Gani Buçinca. Po, mundësisht t'i rrumbullakoni fjalët, po mendoj, mos ta zgjatni shumë.

NAIT HASANI: Faleminderit, Kryetar!

Përshëndes zëvendëskryeministrin, ministrat dhe kolegët deputetë që janë këtu.

Ne si Komision për Integritet Evropian kemi bërë një propozim, një plan-veprim për Kuvendin. Këtu edhe Kryetari atë ditë i ka prezantuar e mos t'i përsërisim të gjitha ato që i ka thënë, por edhe një dokument që e kemi këtu komunikata nga Komisioni Parlamentar i Këshillit të Evropës, një Raport i progresit, këtu i kemi tri dokumente, të cilat kanë ardhur me vlerësimet, të cilët ne i kemi vlerësuar nga ata. Kemi mbajtur edhe një këshillim me organizatat joqeveritare dhe atë ditë kanë vlerësuar që në Raportin e progresit Kosova ka bërë një progres të limituar, por nuk është i kënaqur ... ne duhet të ecim.

Unë mbështes edhe fjalën e Kryeministrit atë ditë që e dha për Raportin e progresit, të arriturat dhe sfidat dhe sot zëvendëskryeministri që i prezantoi sfidat, 170 sfida për Raportin e progresit, po një çështje që ndoshta është e mirë çështja e sundimit të ligjit apo e së drejtës – drejtësia. Për mua siguri i respektimit të plotë të ligjit është prioritet kyç i partneritetit evropian. Ky vjen nga Raporti i progresit. Për mua është një çështje tjetër që ndoshta është dashur të ngritet pikërisht, sepse gjyqtarët që i kemi ne janë të paaftë

në raport me progresit, prokurorët janë po ashtu të paaftë, nuk kanë mund të integrohen, sepse iu ka bllokuar çipi në kohën e 99-ës, kështu që ata duhet të kthehen prapa dhe të vijnë me gjenerata të reja. Gjeneratat mendoj se ne si shtetet tjera të Ballkanit që e kanë bërë një ligj për lustrimin, edhe ne është dashur ta bëjmë një ligj për ilustrimin dhe që të mos i kemi defektet apo efektet negative që na vijnë në Kuvend.

Mendoj se zgjedhja e gjyqtarëve apo propozimi i gjyqtarëve e prokurorëve që është pikë kyçe edhe në Raportin e progresit po edhe ne si Kosovë për të ardhmen na duhet që atyre gjyqtarëve që nuk e kanë ndërruar çipin t'u themi shkoni te shtëpia në pushim dhe të vijnë me gjeneratën e re e cila është e ndryshueshme në zhvillim dhe në perspektivë.

Unë veç kisha për t'ju përshëndetur dhe falënderuar!

KRYETARI: Faleminderit! Edhe ne të falënderojmë, po realisht unë mund të kërkoj, do të thotë edhe në emrin tuaj, nëse jeni dakord, që Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi le ta bëjë një raport dhe le të debatojmë për këtë çështje. Mendoj se çështja e sistemit të drejtësisë është një pushtet i veçantë po që domosdo për të shkuar shumë punët mirë ai duhet të funksionojë mirë. Fjalën e ka deputeti Gani Buçinca, e tani do ta kenë fjalën dy propozuesit e këtij debati.

GANI BUÇINCA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Ju përshëndes të nderuar kolegë deputetë!

I nderuari zoti Kryetar, nuk do ta zgjas shumë. Do të flas shumë shkurt për arsye se diskutimi juaj pak a shumë i ka artikuluar edhe të gjitha ato çka unë doja t'i thosha, e para, e dyta edhe diskutimi i zëvendëskryeministrit pak a shumë i ka ekzagjeruar të gjitha dhe i ka artikuluar ato që unë ndoshta do t'i thosha në një formë më të dobët, por që unë e përkrah dhe besoj se edhe ju e keni dëgjuar me vëmendje.

Megjithatë, mbasi e mora fjalën do t'i shtoja edhe disa fjalë. Njëra prej dëmeve më të mëdha që i bëhet vendit, i bëhet perspektivës evropiane të integritetit të shtetit tonë është pikërisht krijimi i iluzionit të rrejshëm se për ngecjet në procesin e integriteteve është përgjegjëse kjo qeveri, ajo qeveri apo aq më keq ky apo ai individ. Kolegë të nderuar, procesin e integriteteve nuk duhet kuptuar si një akt dyvjeçar, ose njëvjeçar, ose trevjeçar, ose të një mandati por si një proces shumë sfidues, shumë më të gjatë dhe shumë më brengosës për institucionet e vendit tonë, për institucionet e shtetit tonë të ri për të cilin janë bërë aq shumë sakrifica për të ardhur deri këtu. Iluzionet e disa deputetëve të padijshëm dhe të papërgjegjshëm njëkohësisht se gjëja Kosova do të anëtarësohej në Bashkimin Evropian sikur mos të ishte kjo qeveri ose ky ministër, ose ky kryeministër janë gjithashtu shqetësuese dhe mund të jenë dëshpëruese për qytetarët e Kosovës. Shtetet e rajonit me të cilat neve kemi qenë dikur në të njëjtën bashkësi, edhe pse kanë pasur nga 12 mijë dollarë për kokë banori, prodhimin nacional, të hyrat nacionale për një vit, kanë pritur 15 vjet deri sa janë bërë pjesë e Bashkimit Evropian. Ka nga ato shtete të cilat akoma po bëjnë përpjekje dhe akoma s'i kanë arritur standardet edhe pse 50 vjet kanë qenë republika dhe shtete të konsoliduar me institucione pak a shumë të konsoliduar, qoftë në drejtësi, qoftë në siguri, qoftë në mbrojtje e institucione të tjera. Kosova për një vit e gjysmë nuk mund t'i çojë përpara reformat ekonomike, nuk mund të çojë përpara transformimin e pronës ose privatizimin, së paku nuk mund të çojë përpara me privatizimin me një fytyrë njerëzore, me një fytyrë sociale, siç duhet të ishte, për shkak të mungesës së infrastrukturës ligjore, në njërën anë dhe për shkak të mungesës së vullnetit politik të faktorit ndërkombëtar për të definuar vetë pronën juridikisht pronën e

Kosovës, gjithë ato resurse të Kosovës tonë që nuk mund të privatizohen sot dhe të futen në ofiçiençë për shkak se nuk u është definuar statusi i tyre pronësor dhe juridik.

Ka shumë probleme tjera me të cilat ballafaqohet Kosova. Unë po ju them se një vend i integruar në Bashkimin Evropian do të bëhet atëherë kur do ta ulë papunësinë në 7%, kurse deri në 15% është e tolerueshme papunësia në një vend të Bashkimit Evropian. Kur arrin në 16% ndezën dritat e alarmit dhe i rrokë shqetësimi dhe paniku të gjitha qeveritë aktuale. Ne me një shkallë kaq të lartë të papunësisë, të mos të krijojmë iluzione se Evropa do të na pret duar hapur dhe do t'i mbyllë sytë para të gjithë atyre problemeve që i kemi ne këtu. Qeveria e Kosovës ka bërë një punë të mirë për arsye se ka vlerësuar Raportin si të arsyeshëm, real dhe sfidues për Qeverinë dhe për institucionet e Kosovës. Ne kemi nevojë për mbështetje të madhe nga Bashkimi Evropian, kemi nevojë për solidaritetin e shteteve të Bashkimit Evropian që këto probleme me të cilat ballafaqohet shteti ynë i ri t'i tejkalojmë së bashku, t'i tejkalojmë me sa më pak vështirësi dhe t'i shkurtujmë proceset e integritimeve evropiane. Ne kemi shumë nevojë dhe kemi shumë probleme të trashëguara nga e kaluara. Unë pajtohem me të gjithë ata deputetë që thonë para se gjithash në këtë sallë këtu duhet të evropianizohet mendësia jonë politike, kultura jonë politike që të bartet pastaj edhe në shoqërinë tonë e cila shpeshherë është shumë më e përgjegjshme, më e ndërgjegjshme dhe më e pjekur politikisht se shumë prej ne deputetëve që jemi në këtë sallë.

Kurse krejt në fund, për mos ta zgjatur se kam ende për të thënë, por u thanë ato, para se gjithash u thanë të gjitha ato që duhet të thuheshin, unë e kisha përkrahur kolegun tim Naitin, i cili tha se duhet një legjislacion për lustracionin që të mos krijohet përshtypja në Kosovë se etërit tanë dhe gjyshërit tanë derdhën gjak dhe shumë prej nesh u dënuam nëpër kazamatet e ndryshme dhe vuajtëm dënime dhe torturime të mëdha dhe krijuam një shtet i cili do t'ju shërbejë vetëm udbashëve, spiunëve dhe disa spiunëve ndërkombëtarë që janë këtu, por të dihet kujt do t'i shërbejë ky shtet dhe si duhet të funksionojë ky shtet dhe çfarë përgjegjësie publike duhet të kanë

KRYETARI: Je dal prej rendit të ditës, Gani!

GANI BUÇINCA: E di, baca Jakup! Nuk është hera e parë, kërkoj falje. Ju falënderoj për vëmendjen!

KRYETARI: Faleminderit! Tani radhën e ka propozuesi i debatit, 5 minuta, besoj më shkurt e përmbledh, deputeti Lulzim Zeneli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-ës. Dhe, në fund Zylfije Hundozi, në emër të Komisionit, çka po na thotë.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zotëri Kryetar!

Nëse kemi parasysh raportin, debatin i cili është zhvilluar që ishte mjaft përmbajtjesor dhe deklaratimet zyrtare të Brukselit atëherë mund të vij në përfundim se shanset që janë ofruar nga komuniteti evropian për ndryshimin e jetës së qytetarëve të Kosovës dhe promovimin e Kosovës në agjendën evropiane, themi lirisht se janë anashkaluar. Në Raportin e progresit dëshmohej se nuk ishin institucionet ndërkombëtare ato që nuk ofruan shansin për prosperitet, por t'i bindemi faktit se ishte puna jo serioze, jo profesionale dhe kriteret e pa plotësuar që penguan lëvizjen e lirë të qytetarëve dhe promovimin e mëtejshëm të agjendës evropiane.

Ajo çka mund të përfundojmë dhe duhet një gjë ta kemi parasysh se ky Kuvend i Kosovës dhe qytetarët e Kosovës tashmë e kanë të qartë se ajo çka është thënë dhe nuk

po i përsëritës nga parafolësit, korrupsioni, regresi ekonomik, mirëpo janë edhe aspekte tjera që ndikuan dhe reflektuan negativisht dhe që janë shumë të rëndësishëm që nuk u morën seriozisht nga ana e institucioneve të Kosovës dhe ato janë si: institucionet qeveritare jo profesionale që merren me procesin e integrimit evropian; puna jo rezultateve e Kuvendit të Kosovës në mbikëqyrjen e Qeverisë; koordinim, do të thosha jo efikas, për mos të thënë mos koordinim ndërministror; mungesa e vullnetit politik të Qeverisë dhe mungesa e politikave operacionale në aspektin e integritimeve evropiane. Dhe, ajo çka duhet të theksohet se mos përmbushja e kriterëve që dalin nga plani i punës së partneritetit evropian, siç janë kriteret politike, ekonomike dhe agjenda evropiane, po e vështirëson rrugën e Kosovës drejt BE-së prandaj këto kriterë duhet parë si momentum më i rëndësishëm për institucionet e Kosovës tani.

Çështja tjetër që duhet të precizohet ka të bëjë me ndërtimin e kapaciteteve dhe efikasiteti institucional. Gjersa institucionet e Kosovës nuk janë në gjendje të krijojnë kapacitete dhe efikasitet institucional dhe të njëjtën kohë të krijojnë kapitalin human dhe resurset njerëzore, atëherë rruga e Kosovës drejt BE-së do të jetë e vështirë, prandaj ndërtimi i mekanizmave institucionalë që merren me integrim, koordinim është sot më se i nevojshëm.

Çështja tjetër që duhet të kihet parasysh nga ky raport është qëndrueshmëria ekonomike. Orientimi ynë në rrugën drejt integritimeve evropiane kërkon definim të qartë të programit ekonomik dhe social, me qëllim të krijimit të një ekonomie funksionale të tregut, si dhe të kapaciteteve për të përballuar presionin e konkurrencës dhe trendëve ekonomik brenda BE-së.

Çështja tjetër që duhet të kihet parasysh ka të bëjë me marrëdhëniet rajonale dhe paqartësisë rreth perspektivës evropiane. Ka një problem të dukshëm në përfaqësimin e Kosovës në marrëdhëniet rajonale. Problemi nuk duhet adresuar gjithnjë si i jashtëm, por problemi qëndron edhe në përfaqësimin jo serioz, jo profesional të autoriteteve kosovare, prandaj duhet krijuar një mekanizëm profesional që të përfaqësojë Kosovën në këto institucione duke vepruar në koordinim do të thosha që është aq i nevojshëm edhe me autoritetet ndërkombëtare dhe jo përfaqësim në baza ad-hoc.

Dhe, çështja tjetër që duhet të kihet parasysh nga ky raport dhe duhet të merret seriozisht nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës është funksionalizimi dhe shfrytëzimi i fondeve të IPA-s. Duke pasur parasysh se IPA është instrument për asistencë, ju jepet vendeve kandidate dhe atyre potenciale për anëtarësim në BE, prandaj konsiderojmë se institucionet e Kosovës duhet t'i kushtojnë rëndësi shumë të madhe mundësisë së absorbimit të këtyre fondeve në mënyrë që të krijojnë efekte pozitive të cilat do të shfaqen konkretisht në praktikë. Duke përfunduar, ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Urdhëro një minutë, zëvendëskryeministër!

ZËVENDESKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti Zeneli dhe të gjithë ata që kanë dhënë kontribut, por unë mendoj që fjalimi yt i fundit është dashur të lexohet ditën e parë. Qëllimi i debatit kudo që bëhet në botën demokratike në kuvende nuk ka qëllim që ta thoni mendimin tuaj në fund. Në fillim e keni thënë mendimin tuaj, në fund duhet ta thoni qëndrimin e përbashkët që ka dalë nga debati dhe unë mendoj që këtu mos i jepni kahe, mendimet tuaja s'besoj se mbështeten nga shumica. Faleminderit!

KRYETARI: Të faleminderit! Urdhëro, Lulzim, dy minuta i ke, po shfrytëzoje vetëm një.

LULZIM ZENELI: Zëvendëskryeministri duhet ta ketë të qartë një gjë. Si propozues i debatit e kemi të drejtën që në 5 minutshin e fundit të debatit t'i shfaqim rekomandimet dhe atë vizionin tonë si Grup Parlamentar në tejkalimin e këtyre sfidave dhe t'i qartësojmë pozicionet rreth mos punës së Qeverisë në këtë konkluzë. Prandaj, unë do të thosha qëndrimet tona janë shfaqur fillimisht në hyrje të debatit në ekspozitë që e kemi dhënë, ndërsa këto ishin përmbylljet që do të duhej të merren seriozisht nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, një minutë!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Zoti Zeneli, besoj se kemi dallim në konceptin se si e kuptojmë debatin. Në fillim është e drejtë e juaja që ta thoni atë e më shumë, por në fund debati ka për qëllim që ta thotë gjendjen e përbashkët, as krejt çka kam thënë unë as krejt çka keni thënë ju për gjendjen e përbashkët. Cili është qëllimi i debatit? Nëse ju e keni mendimin e njëjtë që në fillim dhe në fund, mund ta mbani një konferencë për shtyp, s'keni nevojë të mundoni ne tjerëve.

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja dhe kryetarja e Komisionit për Integritet Evropian Zylfije Hundozi.

ZYLFIJE HUNDOZI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zotëri zëvendëskryeministër, ministra prezentë,

Kolegë deputetë,

Unë i dëgjova të gjitha diskutimet edhe në seancën e 26-it, edhe të sodit dhe është e qartë se të gjitha grupet politike në Kuvend e kanë një qëllim të njëjtë, e ai është anëtarësimi i Kosovës në Bashkimin Evropian. Këtë qëllim e ka pasur edhe Komisioni për Integritet Evropian në mbledhjet e veta të mbajtura dhe në dëgjimin publik që e ka mbajtur me shoqërinë civile në punëtorinë dyditore ku kanë qenë të ftuar edhe të gjithë kryetarët e komisioneve, por në punëtorinë dyditore dhe në mbledhjet e Komisionin planin e veprimit e kemi hartuar për këtë qëllim, domethënë për t' i ndihmuar proceseve të integritetit evropian të Kosovës. Edhe Komisioni Evropian kur e qet Raportin e progresit, qëllimi i tij me anë të atyre kritikave është në realitet për t' ia hapur sytë Kosovës se në të cilat veprime duhet përqendruar për t' i plotësuar kushtet për anëtarësim në Bashkim Evropian. Gjatë punëtorisë dy ditore na i kemi ftuar të gjithë anëtarët, edhe anëtarët e komisioneve edhe kryetarët e komisioneve të këtij Parlamenti, por i kemi ftuar edhe ekspertët ndërkombëtarë për integritet evropian dhe vendorët, kështu që në punën dhe hartimin e planeve të veprimit kanë qenë ekspertë për integritet evropian të Qeverisë, kanë qenë ekspertë për integritet evropian të Presidencës, kanë qenë përfaqësues të integritetit evropian të OSBE-së dhe eksperti që i është dhënë Komisionit tonë nga ana e Komisionit Evropian. Kështu që është hartuar me shumë kujdes dhe pra e ka qëllimin e mirë që Kuvendi ta tregojë përkushtimin e vet sa i përket anëtarësimit dhe ta luajë atë rol të vetin për të cilin jepet vërejtje në Raportin e progresit, pra ta bëjë mbikëqyrjen sa më të mirë dhe ta avancojë legjislacionin dhe mbikëqyrjen, implementimin e tij. Unë po shoh se ka pasur rezistencë edhe në herën e kaluar gjatë hartimit dhe zbatimit të planit të veprimit dhe sidomos nga kryetari i Komisionit për Legjislacion se këtu qartë po shihet se është një numër i vogël i personave i cili po e pengon punën, i cili po e pengon punën e Kuvendit sa i përket procesit të integritetit evropian. Komisioni për Integritet Evropian është vetëm një trup i Kuvendit dhe ai vetë s'mund të bëjë kurrgjë pa përkrahjen e gjitha trupave të Kuvendit të Kosovës, se në Raport të progresit shkruan – Kuvendi i Kosovës e ka arritur këtë, e këtë. Nuk po shkruan

që Komisioni për Integritet Evropian e ka bërë strategjinë dhe planin e veprimit po Kuvendi i Kosovës. Domethënë, ne vlerësohemi si një tërësi, e jo si një komision, një komision s'mundet të bëjë kurrgjë. Për këtë arsye ato që i thatë ju, rekomandimet ekzistojnë. Është propozuar edhe në mbledhjen e përbashkët të Komisionit për Integritet Evropian edhe kryetarëve të komisioneve që ju ta udhëhiqni këtë zbatimin e planit të veprimit dhe unë jam dakord dhe nëse të gjitha komisionet nuk e qesin në rendin e ditës një pikë- agjendën evropiane atëherë ne në fund nuk kemi edhe të drejtë të hidhërohemi kur na kritikon edhe shoqëria civile edhe Komisioni Evropian se faktikisht nuk e kemi zbatuar as planin e veprimit tonin.

Atë çka u tha për Ligjin për shërbyesit civilë, Komisioni e ka hartuar këtë plan të veprimit dy ditë pasi ka dalë raporti zyrtar i progresit. Më 14 ka dalë raporti i progresit, më 18-19 ne kemi mbajtur dëgjime publike, kemi mbajtur punëtori dy ditore, kështu që kur i kemi shkruar ne ai ka qenë ende si vërejtje në Raportin e progresit dhe krejt plani i veprimit i referohet sfidave, ne s'i kemi qitur prej veti këto. Kemi shkua pikë për pikë dhe kemi këqyrë ajo çka është strategjike për Kosovën, çka është më e nevojshme për të punuar që t'i arrijmë qëllimet tona. Nuk e kemi pasur qëllimin ta shtimë askënd me zor të punojë, kjo është çështje vullnetare, na vetë kemi deklaruar që dëshirojmë të integrohemi në Bashkimin Evropian, por edhe Komisioni Evropian, qysh në vitin 2003, në Samitin e Selanikut ka thënë që agjenda evropiane i përfshinë të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor, por edhe Kosovën. Domethënë Komisioni evropian po na e shtrinë dorën, po na ndihmon, duhet edhe ne t'i ndihmojmë vetvetes. Faleminderit! Dhe kisha për ta lutur zotin Kryetar, kisha për t'ju lutur, sot ndoshta nuk ka forum të votohet plani i veprimit dhe rekomandimet që janë dhënë prej Komisionit. Me këto Kuvendi do ta tregojë përkushtimin e vet për agjendën e integriteteve evropiane. Kaq. Kjo nuk është personale, nuk është e Komisionit. Kjo është prej krejt Kuvendin. Nëse do Kuvendi shkojmë më tutje, nëse jo, Komisioni e kryen punën e vet ashtu-kështu. Faleminderit!

KRYETARI: Jo, mendoj se e kemi kryer. Po këto i kishim diskutimet e fundit. Mirë, po e tejkalojmë, fjalën e ka në fillim Sabri Hamiti pastaj Bahri Hyseni dhe u krye për sot.

SABRI HAMITI: Katër veta ma kanë përmendur emrin, nga dy minuta do t'i shfrytëzoja, s'kam dashur as s'dua t'i shfrytëzoj.

Unë dola të sqaroj. Ndoshta është hutuar zonja e Komisionit, por zonja e Komisionit është dashur të thotë – jo vullnetar, por programi i veprimit të Komisionit të saj ka ardhur në Kuvend që të bëhet program i votuar i Kuvendit, ku do të hyjnë edhe propozimet konkrete, disa prej të cilave ia kam dhënë unë dhe unë prita që kështu do ta formulojë. Ndoshta ajo ka menduar, por s'e ka formuluar. Kaq! Nuk është punë vullnetarizmi, është program që del për këtë qëllim para Kuvendit dhe bëhet obligativ për Kuvendin. Faleminderit! Kaq kisha.

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Tash Bahri Hyseni e ka fjalën.

BAHRI HYSENI: Faleminderit! Shumë unë mendoj që kryetarja e keqkuptoi... Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi nuk është duke e pritur asnjë ligj dhe është ndër komisionet që punon më së shumti në Kuvend të Kosovës dhe nuk ka nevojë të dalim me konstatime të tilla, por ne po pyesim – në agjendën që e kemi mbajtur në Gjakovë, a bën ta dimë cilët nga kryetarët e komisioneve kanë qenë prezentë? Asnjë! Sepse, ke përcaktuar një agjendë në Gjakovë pa e konsultuar asnjë kryetar të komisioneve dhe ne kemi pas agjenda permanente në komisione tona, gjithë këtë plan të veprimit e ke bërë pa

i konsultuar shumicën e kryetarëve të komisioneve, prandaj këtu po të themi – me qëllim që ne të veprojmë, të mos kemi vetëm një dokument sa për sy e faqe, duhet ftuar kryetarët e komisioneve, t' i përcaktojnë detyrat qartë, mos të shkosh vetë në Gjakovë, nuk e di me kë kënd shkua. Ti mundesh me i marrë 100 ekspertë tjerë, por s' i ke marrë njerëzit që duhet me krye punën, prandaj këtu është problemi, kryetare. Dhe unë propozova, me qëllim që me pas të qartë planin e veprimit me i ftua të gjithë kryetarët e komisioneve dhe kryetarët që tani janë zgjedhur, t' i marrën detyrat, sepse të gjithë jemi të interesuar të punojmë dhe nuk është çështje e vullnetit, çështja e aprovimit të ligjit nuk është çështje e vullnetit, çështja e raportit të Avokatit të Popullit nuk është çështje e vullnetit. Është detyrë dhe obligim që dalin nga Rregullorja e Punës, nga ligjet.

KRYETARI: Urdhëro, Zylfije, shkurt, 2 minuta.

ZYLFIJE HUNDOZI: Unë desha vetëm t' i përgjigjem zotëri Sabri Hamitit, se për kryetarin e Komisionit për Legjislacion ai vetë u shpalua. Po, fakt që unë ndoshta s' u shpreha mirë. Mendova që procesi i integriteteve evropiane për një shtet është proces vullnetar. Nuk po na shtinë me zor, nuk mendova planin e veprimit. Ky është proces vullnetar i një shteti, a po do ti të hysh në Bashkësinë Evropiane? Ka shtete të cilat kanë dal në referendum dhe kanë thënë jo. Ne kemi thënë po, të gjitha institucionet, prandaj është edhe rendi me punua. Kaq, këtë kam dashur për ta shpjeguar.

Diskutim i dorëzuar me shkrim

MYRVETE PANTINA: Raporti i Komisionit Evropian për progresin në Kosovë për vitin 2009, të cilin po e shqyrtojmë sot, për ne ka rëndësi të madhe, pasi që vërejtjet që dalin nga ky dokument duhet të jenë udhërrëfyes për atë se çka duhet të ndërmarim në të ardhmen për një funksionim më të mirë të shtetit tonë në tërësi. Ne vazhdimisht deklarohemi se synimi ynë është të jemi pjesë e Evropës në një të ardhme të afërt, por nga raporti i Komisionit Evropian kuptohet se përkushtimi ynë për të realizuar këtë synim mungon, apo nuk është në masë të duhur. Padyshim, periudha për të cilin raportohet, në Kosovë ka pasur edhe të arritura pozitive, por, mendoj që fokusimi ynë duhet të jenë dobësitë, apo vërejtjet që janë dhënë për periudhën e raportuar, prandaj, nuk duhet të kënaqemi me rezultatet e arritura, por të rrisim angazhimin tonë për t' i eliminuar dobësitë për të cilat flitet në raport.

Raporti i Komisionit është një raport gjithëpërfshirës, i cili mbulon të gjitha sferat e shoqërisë kosovare, por unë do të ndalem vetëm në pjesën që ka të bëjë me zhvillimin ekonomik të Kosovës. Do të citoj konkluzionet e Këshillit Evropian të Kopenhagës të qershorit të 1993, ku thuhet: "Anëtarësimi në Bashkimin Evropian kërkon një ekonomi funksionale dhe të orientuar nga tregu, e aftë për t' u ballafaquar me kapacitetet konkurruese dhe me forcat e tregut në kuadër të Bashkimit Evropian". Andaj, duke u nisur nga këto kritere, në raport konstatohet se sundimi i dobët i ligjit vazhdon të mbetet pengesë kryesore për zhvillimin shoqëror-ekonomik të Kosovës. Tregun e punës, sipas raportit, e karakterizon mungesa e të dhënave të mjaftueshme dhe të besueshme, që pengojnë analizimin e zhvillimit të këtij tregu. Vlerësohet që papunësia të jetë rreth 40%, dmth. nuk ka ndryshim në krahasim me periudhën e mëparshme, dhe çka është më e keqja, për shkak të mos ekzistimit të mundësive për punësim në vend një numër i madh i të papunëve vazhdojnë të kërkojnë punësim jashtë Kosovës, por mungojnë të dhënat zyrtare statistikore për migrimin e fuqisë punëtore.

Ekonomia joformale, sipas raportit, ende mbetet një sfidë e madhe, pasi që zvogëlon bazën tatimore dhe të hyrat buxhetore. Madje, krahasuar me nëntëmujorin e vitit 2008 të

hyrat e ATK-së në nëntëmujorin e vitit 2009 ishin më të ulëta për 5%, prandaj, mbetet për të punuar shumë për të luftuar ekonominë joformale.

Sundimi i dobët i ligjit dhe pasiguria lidhur me të drejtat e pronësisë po ashtu paraqesin pengesë të madhe për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe për tërheqjen e investimeve, kurse zbatimi i vështirë dhe i kushtueshëm i kontratave ligjore, pengon mjedisin e biznesit. Sipas raportit, ndërmarrjet e sektorit privat ballafaqohen me procedura jo transparente të prokurimit dhe të tenderimit. Ndërsa, sa i përket furnizimit me rrymë, është evidente se ka pasur përmirësim në furnizimin me rrymë elektrike, por ky përmirësim ka kushtuar me ngarkesën buxhetore për shkak të rritjes së subvencioneve KEK-ut, ndërsa rreth 50% të rrymës që prodhohet vazhdon të mos paguhet. Dua të theksoj edhe një dukuri shumë të përfolur te ne. Fjala është për prokurimin publik, ku, sipas konstatimit të raportit, vlerësohet se situata është përkeqësuar, posaçërisht, theksohet se duhet t'i kushtohet rëndësi monitorimit dhe implementimit të kontratave të prokurimit për të reduktuar mundësinë për korrupsion.

Në fund dua të theksoj se, sipas mendimit, Plani i veprimit i Kuvendit të Kosovës për Integrim Evropian, i hartuar nga Komisioni për Integrim Evropian, i cili parasheh një varg masash dhe veprimesh që duhet të ndërmerren nga Kuvendi dhe institucionet tjera të Kosovës gjatë periudhës kohore 2009-2010, duhet të miratohet së bashku me rekomandimet e dhëna nga ky komision parlamentar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Unë po përpiqem ta përmbyll krejt këtë çështje. Unë mendoj se pasi pat vërejtje nga kryetarët e komisioneve, unë kërkoj që në një takim të përbashkët kryetarët e komisioneve, duke përfshirë edhe kryetarin e Komisionit për Integrim, në një takim të përbashkët ta bëjmë një dokument të përbashkët dhe pastaj ta votojmë, se ky është një dokument që duhet ta votojmë. Unë mendoj që duhet një takim i përbashkët për t'i harmonizuar të gjitha çështjet dhe pastaj për ta votuar në një mbledhje të ardhshme. Ju faleminderit dhe mirë u pafshim në seancën e nesërme.

Përgatiti: Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale